



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim**

# **Raporti i Progresit 2008**

Nëntor 2009

Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive  
dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

# **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim**

**Raporti i Progresit 2008**

**Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe  
Koordinimit të Ndhmës së Huaj**

Nëntor 2009



# Pasqyra e lëndës

HYRJE .....	6
1. INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN DHE NË NATO .....	8
1.1 Integrimi në Bashkimin European .....	9
1.2 Integrimi në NATO .....	12
1.3 Punët e jashtme .....	14
2. DEMOKRATIZIMI DHE SHTETI I SË DREJTËS .....	16
2.1 Drejtësia .....	17
2.2 Të drejtat e pronës .....	19
2.3 Anti-korrupsioni .....	21
2.4 Krimi i organizuar .....	23
2.5 Rendi publik .....	25
2.6 Administrata publike .....	26
2.7 Decentralizimi .....	27
3. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SOCIAL .....	29
3.1 Infrastruktura .....	30
3.1.1 Transporti .....	30
3.1.2 Energjetika .....	35
3.1.3 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet .....	37
3.1.4 Mjedisi .....	39
3.2 Ekonomia e tregut .....	41
3.2.1 Financat publike .....	43
3.2.2 Ekonomia .....	45
3.2.3 Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbikëqyrja e tregut .....	48
3.2.4 Teknologjia e informacionit dhe komunikimit .....	48
3.3 Politika sociale .....	51
3.3.1 Punësimi .....	51
3.3.2 Barazia gjinore .....	53
3.3.3 Mbrojtja sociale .....	54
3.3.4 Përfshirja sociale .....	55
3.3.5 Sigurimet shoqërore .....	56
3.3.6 Shëndetësia .....	58
3.3.7 Arsimi parauniversitar .....	60
3.3.8 Arsimi i lartë .....	61
3.4 Zhvillimi urban, rural dhe rajonal .....	63
3.4.1 Planifikimi hapësinor .....	63
3.4.2 Zhvillimi rajonal .....	65
3.4.3 Zhvillimi rural .....	65
3.4.4 Bujqësia .....	67
3.4.5 Turizmi .....	69
4. SHTOJCA I: Tabela e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale dhe statusi i tyre deri në fund të tetorit 2009 .....	72
5. SHTOJCA II: Raport mbi rishikimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit .....	73

# Lista e Shkurtimeve

AKKP	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BSH	Banka e Shqipërisë
DEBASKON	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
EJL	Evropa Juglindore
EMIS	Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Arsimit
EOD	Toga e Asgjësimit të Municioneve
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
ITAP	Instituti i Trajnimit të Administratës Publike
KE	Komisioni Europian
KM	Këshilli i Ministrave
LSMS	Anketa për Matjen e Standardeve të Jetesës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
PVA	Plani i Veprimit të Anëtarësimit
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OZHM	Objektiva të Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PIP	Programi Individual i Partneritetit
PKZMSA	Plani Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

PRPP	Procesi i Rishikimit të Planit të Partneritetit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara i Emergjencës për Fëmijët
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Raporti i Progresit 2008 paraqet ecurinë dhe rezultatet e politikave themelore të qeverisë për vitin 2008, bazuar në treguesit e nivelit të lartë të paraqitur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013 (SKZHI). Raporti fokusohet në ecurinë afatshkurtër të treguesve të nivelit të lartë, të cilët reflektojnë objektivat madhore të politikave të qeverisë, duke u përpjekur të japë edhe disa orientime për politikën më efektive në periudhën afatmesme. Ky raport është hartuar nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON), në Këshillin e Ministrave, si pjesë e procesit të monitorimit-vlerësimit të zbatimit të SKZHI-së.

Raporti i Progresit përmbledh performancën e sektorëve themelorë gjatë vitit 2008 dhe paraqet disa nga hapat më të rëndësishëm në mbështetje të realizimit të objektivave të SKZHI-së. Qëllimi kryesor i këtij raporti është paraqitja e ecurisë së zbatimit të politikave kyçe sektoriale për vitin 2008 si dhe identifikimi i sfidave për t'u përballuar nga institucionet zbatuese.

Raport Progresi 2008 synon: (i) monitorimin dhe vlerësimin e progresit të bërë në drejtim të arritjes së objektivave të SKZHI-së; (ii) krahasimin e ecurisë së reformave në Shqipëri me ato të vendeve të tjera në rajon; (iii) nxitjen e debatit për orientimin dhe efektivitetin e politikave strategjike të qeverisë.

Raporti është i organizuar në 3 kapituj kryesorë, sipas shtyllave të politikave prioritare të SKZHI-së: Integrimi në Bashkimin Europian dhe në NATO; Demokratizimi dhe Shteti i së Drejtës; si dhe, Zhvillimi Ekonomik dhe Shoqëror. Çdo kapitull përmban raporte të veçanta për ecurinë e çdo treguesi të SKZHI-së. Duke u mbështetur në një analizë të përmbledhur të sektorit përkatës, raporti përpiqet të japë orientim edhe për çështje kritike lidhur me masat që duhen ndërmarrë, me qëllim përballimin e sfidave të integritetit të vendit. Gjithashtu, në raport analizohen edhe prirjet afatgjata, duke e krahasuar Shqipërinë me vendet e tjera të rajonit.

Kapitulli i parë paraqet ecurinë në lidhje me procesin e integritetit në BE dhe NATO. Raporti jep një përmbledhje të disa prej masave në kuadër të integritetit, si dhe rendit arritjet madhore në këtë drejtim, duke paraqitur dhe sfidat e mëtejshme. Kapitulli i dytë fokusohet në ecurinë e reformave në kuadër të zhvillimit dhe konsolidimit të shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve, si dhe qeverisjes së mirë e luftës ndaj korrupsionit. Analiza për secilin sektor bazohet në të dhënat e siguruar nga institucionet qendrore, si edhe të dhëna nga raportet e përgatitura nga institucionet ndërkombëtare. Kapitulli i tretë trajton rezultatet e masave të ndërmarrura në infrastrukturë, si dhe ecurinë e politikave ekonomike, fiskale dhe shoqërore. Në këtë kapitull jepet gjithashtu një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë të vendit.

Raporti përmban edhe një listë me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara deri në kohën e botimit të këtij raporti. Në pjesën e fundit të raportit është përmbledhja e rishikimit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, e cila u përgatit gjatë periudhës prill – shtator 2009 nga DEBASKON mbështetur nga PNUD-i.

## METODOLOGJIA DHE PROCESI

Raporti bazohet mbi të dhënat statistikore kryesisht të INSTAT, ministrive të linjës, të dhënave të institucioneve të tjera qendrore, BSH, etj., si dhe të dhëna nga raporte të institucioneve e organizmave ndërkombëtarë. Këto të dhëna janë përpunuar dhe analizuar kryesisht nga pikëpamja e rezultateve dhe ndikimeve të politikave, në funksion të paraqitjes së ecurisë së 44 treguesve të përcaktuar në SKZHI.

Raporti bazohet gjithashtu edhe në Raportet Vjetore të Rezultateve për vitin 2008, të hartuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 nga ministrinë e linjës me asistencën e DEBASKON-it. Raporti jep gjithashtu një pasqyrë të ecurisë së miratimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale, si edhe një pasqyrë të treguesve kryesorë makro-ekonomikë. Në kuadrin e standardizimit të mjeteve të monitorimit dhe vlerësimit të SKZHI-së është punuar për organizimin e të dhënave në një format unik dhe standard, me qëllim paraqitjen e informacionit në një formë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kuptuar. Për këtë qëllim, çdo treguesi i është kushtuar një hapësirë e veçantë, shoqëruar dhe me grafik ilustrues.

Raporti ka marrë në konsideratë në disa raste jo vetëm të dhëna statistikore për vitin 2008, por ka përfshirë edhe informacione kyçe për vitin 2009. Duke pasur parasysh procesin dhe kohën e hartimit, raporti ka si qëllim të kompletisë tablonë për ecurinë e sektorëve, duke u kujdesur të mos shterojë analizën e ecurisë për vitin 2009.



Procesi për hartimin e raportit ka filluar në prill të vitit 2009 dhe ka kaluar nëpër tre etapa që kanë konsistuar në : (i) përgatitjen e draftit të parë bazuar në Raportet Vjetore të Rezultateve, të dhënat e INSTAT-it dhe raporte e studime të tjera; (ii) marrjen e komenteve nga ministritë e linjës dhe institucionet dhe reflektimin e tyre, (iii) sigurimin e harmonizimit dhe përputhshmërisë së të dhënave nga burime të ndryshme informacioni.

# 1

## Integrimi në Bashkimin European dhe në NATO

Procesi i anëtarësimit të vendit në Bashkimin European dhe NATO ka shënuar progres të rëndësishëm gjatë viteve 2008 -2009, ku u mundësua:

- **Anëtarësimi në NATO** u bë në 4 prill 2009 në Samitin e Strasburgut, duke përmbushur një nga aspiratat kombëtare dhe një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013;
- Përfundimi i **procesit të ratifikimit të MSA-së** nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së (shkurt 2009);
- **Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit** (1 prill 2009);
- **Aplikimi për marrjen e statusit të vendit kandidat** (28 prill 2009);
- Hyrja në fuqi e **Marrëveshjes për Lehtësimin e Vizave dhe Marrëveshjes së Ripranimit** (2008). Këto dy marrëveshje shënojnë mundësi dhe sfida të reja në kuadër të procesit të integritimit evropian. Tashmë është më e lehtë që disa kategori të shoqërisë shqiptare të udhëtojnë për në vendet e BE-së për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, ndërkohë që hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Ripranimit kërkon, por edhe dëshmon për një stad të rritur të kapaciteteve administrative të vendit;
- Në mars 2008 ka filluar dialogu për liberalizimin e lëvizjes me BE-në, i cili vazhdon me intensitet;
- Është përditësuar dhe miratuar Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i cili përcakton hapat dhe kostot e procesit të integritimit evropian duke u shndërruar në instrumentin kryesor të monitorimit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ky proces;
- Në kuadrin e zbatimit të MSA-së, Shqipëria ka marrë masa për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit European. Në vitin 2008 filloi kontrolli dhe monitorimi i plotë i të gjitha nismave legjislative për shkallën e përputhshmërisë së tyre me “acquis communautaire”;
- Në drejtim të informimit dhe komunikimit me publikun për procesin e integritimit është hartuar strategjia dhe plani i veprimit për komunikimin si dhe janë ndërmarrë iniciativa që synojnë informimin e grupeve të ndryshme të popullsisë mbi këtë proces. Nëpërmjet sondazheve janë evidentuar perceptimet e shqiptarëve për çështje të rëndësishme të integritimit si përfitimet, kostot, kohëzgjatja e procesit, njohuritë për BE-në;
- Në drejtim të procesit të decentralizimit të menaxhimit të asistencës komunitare (Instrumentit të Para-Aderimit IPA), janë forcuar më tej kapacitetet administrative. Ky proces do të rrisë pronësinë e autoriteteve kombëtare në menaxhimin e asistencës së Bashkimit European për Shqipërinë.

## 1.1 Integrimi në Bashkimin Evropian

Depozitimi i aplikimit për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE në 28 prill 2009 pranë Presidencës Çeke të BE-së, kurorëzoi një proces të gjatë bashkëpunimi dhe dialogu konstruktiv me vendet partnere anëtare të BE-së dhe me Komisionin Evropian. Plotësimi i kushteve për mundësimin e marrjes së këtij statusi është sfida më e madhe për qeverinë shqiptare në periudhën afatmesme. Bazuar në Raportin Vjetor 2008 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, por edhe në raportet e përgatitura nga Qeveria Shqiptare, treguesit kryesorë të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, në lidhje me kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në BE paraqiten si vijon:

Situata politike	
Demokracia dhe shteti ligjor	<p>Janë ndërmarrë ndryshimet kushtetuese në realizimin e reformës zgjedhore dhe reformës së sistemit gjyqësor.</p> <p>Nga ana e qeverisë u ndërmorën të gjitha masat për zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare në përputhje me standardet e kërkuara, duke përfshirë përgatitjen e listave zgjedhore, pajisjen e votuesve me letërnjoftim sipas regjistrimit elektronik të shtetasve, përdorimin e sistemeve të IT-së dhe kamerave në Vendet e Numërimit të Votave. Si pasojë, Raporti i OSBE/ODIHR u shpreh për progres të zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009, sidomos në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe procesin e identifikimit, kuadrin ligjor të miratuar në mënyrë konsensuale nga dy partitë kryesore në vend, votimin, numërimin dhe gjykimin e konflikteve zgjedhore. Megjithatë, raporti orienton për nevojën për përmirësime të aspekteve teknike të procesit përsa i përket numërimit të votave dhe hartimit të tabelave të rezultateve.</p> <p>Lidhur me reformën në drejtësi ka pasur progres përsa i përket hartimit dhe miratimit të një sërë aktesh ligjore të rëndësishme, në sajë edhe të marrëveshjes mes forcave politike për çështjeve kyçe. Përmendim ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; ligjin “Për Avokaturnë e Shtetit”; ligjin “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”; ligjin “Për policinë e burgjeve” etj. Ndërkohë është ndryshuar ligji për ekzekutimin e vendimeve penale, që së bashku me ndryshimin përkatës në Kodin penal dhe aktet nënligjore të tij, pritet të japë efekte si në drejtim të rehabilitimit dhe integritetit të të dënuarit (duke bërë të mundur zbatimin efektiv të dënimeve alternative), ashtu dhe në uljen e mbipopullimit në burgje.</p> <p>Për luftën kundër korrupsionit, ashtu siç evidentohet dhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, si dhe në një sërë raportesh të organizatave të ndryshme ndërkombëtare të përfshira, Shqipëria ka bërë hapa të qenësishme përpara. Qeveria ka ndërmarrë masa për uljen e korrupsionit, kryesisht në shërbimet tatimore dhe doganore, të cilat ishin më problematike. Ndërkohë, sistemi elektronik i prokurimeve, reforma për pranimitet në universitete, forcimi i kapaciteteve të Qendrës për Regjistrimin e Biznesit, etj, kanë qenë masa efektive në drejtim të uljes së ndjeshme të praktikave korruptive.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve specifike, është i dukshëm. Për t’u përballur me sfidat e integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, tashmë janë miratuar ndryshimet ligjore për forcimin e mëtejshëm dhe vënien në funksion të plotë të strukturave administrative të Integritetit evropian në të gjitha ministritë e linjës. Është kryer standardizimi i funksionimit të këtyre strukturave dhe plotësimi me stafin e nevojshëm, në nivel drejtorie. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha nivelet janë plotësuar me struktura koordinuese për t’iu përgjigjur hyrjes në fuqi të MSA-së në 1 prill 2009.</p> <p>Progres është arritur në fushat e luftës së krimit të organizuar dhe terrorizmit, nëpërmjet hartimit të legjislationit modern dhe anëtarësimit në të gjitha konventat ndërkombëtare në këtë fushë. Përmendim miratimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën kundër Terrorizmit, të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Krimit të Organizuar si dhe të Strategjisë për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Trafikut të Fëmijëve, që janë tashmë në proces zbatimi. Është ratifikuar Konventa e Këshillit të Evropës kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Janë rritur në mënyrë të ndjeshme kapacitetet institucionale dhe strukturore për goditjen e krimit në fushën financiare, korrupsionit e pastrimit të parave, etj. Gjatë vitit 2008 ka filluar procesi për ngritjen e Njësitë të Përbashkëta Hetimore, në bashkëpunim me programin e Sfidës së Mijëvjeçarit. Është rritur numri i personave të kërkuar të kapur dhe është përmirësuar bashkëpunimi me Interpolin, çka është reflektuar në ekzekutimin e një sërë mandat-arrestimesh ndërkombëtare. Në fushën e luftës kundër drogës, janë shtuar ndjekjet penale në lidhje me drogën dhe është rritur bashkëpunimi ndër-institucional dhe ai ndërkombëtar. Ka rënë ndjeshëm sasia e drogës heroinë që tranzitohet nëpërmjet Shqipërisë në drejtim të Italisë dhe Greqisë, gjë që konfirmohet edhe nga statistikat e dërguara zyrtarisht nga pala italiane.</p> <p>Është realizuar projektimi dhe ndërtimi i një sërë institucioneve të burgimit dhe paraburgimit, duke respektuar të gjitha rekomandimet e BE-së në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për MSA-në; zbatimi i një sistemi të veçantë për punësimin e të burgosurve; si dhe shtrirja e arsimit 9-vjeçar në të gjitha institucionet e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të standardeve në sistemin e paraburgimit. Progresin e kryer në situatën e paraburgimeve e dëshmon edhe Raporti i Komitetit të Anti-torturës i Këshillit të Evropës (CPT), qershor 2008. Raporti shprehet për një sërë përmirësimesh krahasuar me raportin paraardhës të vitit 2006, sidomos në lidhje me kushtet e paraburgimit, ku progresi është mjaft i dukshëm. Në lidhje me përmirësimin e trajtimit shëndetësor të të dënuarve dhe të paraburgosurve, mbetet ende mjaft për t’u bërë.</p>

Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve	<p>Të drejtat e njeriut dhe minoriteteve janë përmirësuar më tej, nëpërmjet miratimit të legjislacionit më të përparuar në këtë fushë dhe angazhimit për zbatimin e tij.</p> <p>Vazhdon zbatimi i Strategjisë Kombëtare për përmirësimin e kushteve të minoritetit rom. Në kuadër të monitorimit në nivel lokal për ecurinë e kësaj strategjie, janë kryer vizita në terren nga organet e pushtetit lokal dhe organizatat rome lokale, në qytete të ndryshme të vendit.</p> <p>Janë marrë një sërë masash që synojnë përfshirjen e komunitetit rom në programet e punësimit dhe të zbutjes së varfërisë. Janë marrë masa për krijimin e kushteve lehtësuese për formimin profesional të të papunëve rom dhe hartimin e bazës ligjore që nxit dhe lehtëson formimin profesional për romët punëkërkues.</p> <p>Shqipëria duke qenë tashmë pjesë e “Dekadës së Përfshirjes së Romëve” është duke punuar për të përmbushur kushtet e nevojshme të anëtarësimit.</p>
Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar	<p>Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar shihet në katër drejtime: (i) me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, (ii) me vendet e BE-së, (iii) me vende të tjera (me peshë në arenën ndërkombëtare dhe partnerë strategjikë, etj.), (iv) dhe me organizatat/forumet shumëpalëshe rajonale, ndërkombëtare. Përgjithësisht, Shqipëria ka vazhduar të zhvillojë marrëdhënie pozitive e tepër të veçanta me partnerët e saj rajonale, si dhe me vendet e BE dhe SHBA, qoftë në nivelin shumëpalësh, ashtu edhe në atë dypalësh. Qëndrimi i vazhdueshëm konstruktiv i Shqipërisë për njohjen e pavarësisë së Kosovës ka kontribuar në stabilitetin e rajonit.</p> <p>Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në një numër forumesh dhe iniciativash, përfshirë këtu edhe kalimin nga Pakti i Stabilitetit në një kuadër më rajonal në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) si dhe Këshillin Rajonal të Bashkëpunimit (RCC).</p> <p>Është punuar për konkretizimin e Tregut Rajonal Energjetik. Gjithashtu, Shqipëria ka pasur kryesinë e Nismës së Bashkëpunimit të Detit të Zi (BEDZ maj-tetor 2008).</p>
Situata ekonomike	
Ekonomia e tregut të lirë, reformat strukturore dhe menaxhimi publik financiar	<p>Rritja ekonomike reale gjatë vitit 2008 vlerësohet të ketë qenë rreth 8%, ku kontribuuesit kryesorë janë sektorët e transportit dhe telekomunikacionit, tregtisë, hotelerisë e restoranteve, si dhe ai i industrisë. Norma mesatare e inflacionit vjetor për vitin 2008 rezultoi 3.4%, duke qenë në përputhje me objektivat e qeverisë për një inflacion midis 3-4%. Borxhi publik për vitin 2008 ka pësuar rritje në segmentin e borxhit të jashtëm me 2,9% krahasuar me një vit më parë, ndërsa borxhi i brendshëm është ulur me 0,90%. Në krahasim me vitin 2007, deficiti regjistroi një rritje prej rreth 489 milionë eurosh, nga 831 milionë euro në 2007. Deficiti i tregtisë së mallrave u thellua me 327 milionë euro gjatë vitit 2008, duke arritur në 2,431 milionë Euro nga 2,104 milionë euro.</p> <p>Fluksi neto i investimeve të huaja direkte (IHD) gjatë vitit 2008 ka pësuar një rritje të ndjeshme. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, nga 647.4 milionë dollarë në vitin 2007, në vitin 2008 fluksi neto i IHD-ve ka arritur në mbi 843 milionë dollarë, duke shënuar një rritje mëse 30%. Përsa i përket fluksit hyrës të IHD-ve në vend, rritja ka qenë akoma më e lartë (rreth 42%), duke arritur në shifrën 937 milionë dollarë. Në vitin 2008 fluksi hyrës ka arritur në 6.8 % të PBB-së, kurse në vitin 2007 ishte vetëm 6 %. Në vitin 2008 eksportet janë rritur me rreth 15.6 % krahasuar me 2007, ku eksportet nga 97,400 milionë lekë për vitin 2007 kanë arritur 112,638 milionë lekë për vitin 2008. Për zbatimin efektiv të angazhimeve që rrjedhin nga MSA-ja, Shqipëria ka reformuar plotësisht sistemin e regjistrimit të bizneseve, si dhe po punon për reformimin tërësor të sistemit të licencimit nëpërmjet ofrimit të këtij shërbimi në një sportel të vetëm. Ndërkohë, gjatë vitit 2008 janë hedhur hapa të rëndësishëm në reformimin e sistemit të licencimit të biznesit, dhe për ngritjen e Qendrës së Licencimit të Biznesit.</p>

Të gjitha arritjet e mësipërme përmbushin angazhimet dhe janë në përputhje të plotë me vizionin, përparësitë dhe qëllimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Me përmbushjen e plotë të gjithë këtyre hapave, zbatimi me sukses i MSA-së mbetet prioriteti kryesor në vitet e ardhshme.

## 1.2 Integrimi në NATO

Me anëtarësimin e vendit në NATO, në 4 prill 2009, përmbushet një nga synimet më të rëndësishme të politikës së jashtme të vendit, të shprehura në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, në Strategjinë Ushtarake dhe Planin e Zhvillimit Afatgjatë të Forcave të Armatosura 2007–2020. Samiti i NATO-s në Bukuresht ftoi Shqipërinë për t'iu bashkuar vendeve të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Gjatë vitit 2008, fokusi kryesor ka qenë zbatimi i reformave dhe marrja e masave të gjithanshme në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim dhe Kalendarit të Reformave të Mbrojtjes, ku sipas çështjeve kryesore politike dhe ushtarake të anëtarësimit në NATO, vlen të renditen:

Çështjet politike	
<b>Konsolidimi i kontrollit civil demokratik në FARSH</b>	Gjatë vitit 2008 Ministria e Mbrojtjes është angazhuar maksimalisht në organizimin, transformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH) në funksion të integritit të plotë të vendit në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe në Bashkimin Europian. Falë përgatitjes, reformave të kryera dhe transformimit të vazhdueshëm, Forcat e Armatosura u bënë një faktor i rëndësishëm dhe përcaktues në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO në 4 Prill 2009.
<b>Kontributi i Shqipërisë në misionet paqeruajtëse dhe pjesëmarrja e vendit tonë në aktivitetet e NATO-s.</b>	<p>Pjesëmarrje aktive në programet PfP me NATO-n si: PVA (MAP), PRPP (PARP), PIP (IPP) si dhe realizimi me sukses i konsultimeve me NATO-n për ciklet 7, 8, 9, dhe 10 të PVA. Gjatë vitit 2008, ekspertët e Ministrisë së Mbrojtjes morën pjesë aktivisht në dy raundet e bisedimeve për anëtarësim të zhvilluara me Aleancën dhe në përgatitjen e Program-kalendarit për reformat. Pjesëmarrja e oficerëve shqiptarë në strukturat e NATO-s për 2008 është rritur, duke çuar në 11 numrin e oficerëve të Shtabit të Partneritetit.</p> <p>Në vitin 2008 është nënshkruar Marrëveshja për pjesëmarrjen në operacionin Active Endeavour, operacion i NATO-s në detin Mesdhe.</p> <p>Vijoi ndërkaq pjesëmarrja në misionin “ISAF” të udhëhequr nga NATO në Afganistan, me 22 trupa në Kabul, në përbërje të kontingjentit turk; 112 trupa në Herat, në përbërje të kontingjentit italian. Gjithashtu është dërguar personel në një OMLT në misionin ISAF në Afganistan. Në kuadrin e Kartës së Adriatikut “US-A3”, ka vijuar dislokimi i Ekipit të Përbashkët Mjekësor pranë Aeroportit ndërkombëtar të Kabulit në Afganistan, i angazhuar në mision që prej vitit 2005.</p> <p>Shqipëria nënshkroi marrëveshjen në korrik 2008 për bashkëpunimin me 62 forca ushtarake në operacionet ushtarake të misionit të BE-së në Çad dhe Afrikën Qendrore. Në vijim të zbatimit të marrëveshjes, në kuadrin e misionit EUFOR, u dislokua një kompani prej 62 vetësh, personel i FARSH-it në Çad. Në misionin ALTHEA të BE-së në Bosnje - Hercegovinë janë dislokuar 12 vetë të Togës për Asgjësimin e Municioneve (EOD) si dhe një oficer në shtabin e EUFOR-it. Vijon prezenca e 3 vëzhguesve ushtarakë në misionin “UNOMIG” në Gjeorgji. Në misionin “Lufta e Irakut” në Irak u dislokua një kompani shtesë, që iu shtua kontingjentit prej 120 trupash në Mosul. Ky mision ka përfunduar në dhjetor 2008. Në Komandën Qendrore Amerikane në Tampa, Florida, vazhdojmë të kontribuojmë me 2 përfaqësues shqiptarë.</p> <p>Numri i përgjithshëm i personelit të FARSH-it në operacione jashtë vendit në vitin 2008 arriti në 428 vetë, ose 5.6% e komponentit të forcës tokësore.</p> <p>Pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO janë bërë planifikimet e nevojshme për pjesëmarrje në aktivitetet e Komiteteve dhe Grupeve të Punës të NATO-s, ku Shqipëria do të jetë me statusin e vendit anëtar të NATO-s.</p> <p>Në kuadrin e PIP(IPP) u zhvillua veçanërisht roli i vendit pritës për aktivitetet e NATO-s. Kështu, për herë të parë, u zhvilluan nga NATO në Shqipëri aktivitete të tilla si: Takimi i komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s dhe vendeve partnere (tetor 2008); Konferenca e Aleancës për Transformim për Partneritetin me pjesëmarrjen e SHSHP dhe oficerëve të tjerë të lartë nga rreth 40 vende (Nëntor 2008).</p> <p>Për vitin 2009 janë planifikuar të zhvillohen aktivitete të rëndësishme me Komandat Strategjike të Aleancës. Në këtë kuadër NATO ka caktuar Komandën e Aleancës për Transformim për të asistuar vendin tonë në procesin e integritit në nivel strategjik. Po kështu Komanda e Forcës së Bashkuar e NATO-s në Napoli, është caktuar të asistojë vendin tonë për integrim në nivel operacional dhe taktik. Në këtë kuadër janë intensifikuar takimet e nivelit të lartë për integrimin në NATO dhe të bashkëpunimit bilateral me të gjitha vendet e NATO-s.</p> <p>Implementimi i plotë dhe në kohën e duhur i objektivave të forcës përbën një nga mundësitë më të mira për të vlerësuar dhe ruajtur drejtimin e duhur, ritmin dhe parametrat e reformave në FARSH, për arritjen e synimit final të anëtarësimit të plotë dhe vijimin e masave për plotësimin e detyrimeve pas anëtarësimit në Aleancë.</p>

Çështjet ushtarake	
Reforma e mbrojtjes dhe realizimi i objektivave për anëtarësim në NATO	<p>Në maj 2008 Shqipëria pranoi paketën e re me 49 Objektiva të Partneritetit 2008, të cilat pas datës 1 korrik 2008 u kthyen në një paketë me Objektiva të Forcës.</p> <p>Në qendër të vëmendjes kanë qenë Plani i Reformave të Mbrojtjes, Pyetëtori i Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s, Plani i Veprimit me dy Komandat Strategjike të NATO-s. Mbas dy takimeve të zhvilluara në Shqipëri dhe NATO janë pranuar 49 Objektiva Force dhe janë përcaktuar detyrimet, afatet dhe strukturat përgjegjëse për implementimin e tyre. Në nivel operacional është bashkëpunuar për përgatitjen e Programit të Punës për Integrim (IWP) me Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli. Kjo paketë do të shërbejë si bosht orientues për të gjithë reformën në FA si për vitin 2009 ashtu dhe për dhjetë vitet e ardhshme.</p> <p>Në kuadrin e zhvillimeve të reja si vend anëtar, bazuar në mjedisin e ri të sigurisë pritet dhe po vazhdon puna për rishikimin e dokumenteve kryesore si Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FARSH, etj.</p> <p>Drejtimet kryesore të punës për të ardhmen janë vazhdimi i krijimit të një force të plotë profesionale deri në fund të 2010, modernizimi me sisteme dhe pajisje të reja, kontributi me plotësimin e vendeve organike në strukturat e NATO-s, përmirësimi i kapaciteteve operacionale në repartet prioritare.</p> <p>Në drejtim të plotësimit të kapaciteteve operacionale pritet të përfundojë në tremujorin e I-rë 2009 Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Detare.</p>
Zbatimi i Sistemit të Planifikimit, Programimit, Buxhetimit dhe Ekzekutimit në menaxhimin e burimeve të mbrojtjes	Në këtë kuadër, buxheti prej 2% të GDP-së i miratuar nga Qeveria u orientua drejt modernizimit të FARSH-it në plotësim dhe mbështetje të Objektivave të Forcës
Shkatërrimi i armëve të vogla dhe të lehta	U hartua një plan veprimi i detajuar për asgjësimin e municioneve të tepërta. Vazhdon procesi i demilitarizimit në tri fabrika të specializuara dhe në 8 poligone të miratuara nga qeveria.

Në mënyrë të përmbledhur, ecuria e anëtarësimit dhe integritit në NATO për vitin 2008 përfshin këto faza:

- **Faza e parë, para marrjes së ftesës për anëtarësim (Pre-Invitation)**, përfundoi me marrjen e ftesës për në NATO gjatë Samitit të Bukureshtit në Prill 2008, proces i cili ka filluar në vitin 1994 si Vend i Pfp.
- **Faza e dytë, para pranimit (Pre-Accession)** filloi me marrjen e ftesës për anëtarësim dhe përfundoi me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në NATO, në samitin e NATO-s Strasburg-Kehl. Kjo fazë është shoqëruar me takime në të gjitha nivelet (politike, strategjike, operacionale dhe taktike), përgatitje të dokumenteve kryesore dhe angazhime konkrete në kuadrin e mbrojtjes kolektive. Gjatë kësaj faze, Shqipëria nënshkroi Protokollin e Anëtarësimit në Aleancën e Atlantikut të Veriut (9 korrik 2008), i cili u ratifikua në një kohë rekord prej 26 vendeve anëtare të Aleancës, duke bërë që Shqipëria të jetë formalisht anëtare e NATO-s.
- **Faza e tretë, pas pranimit (Integration)** përfshin fazën më të rëndësishme, për të cilën janë planifikuar masat të rëndësishme për integrimin në NATO që përfshijnë: zbatimin e procedurave, standardeve, doktrinave të njëjta; përmbushjen e objektivave të forcës; konsolidimin e strukturave, arsimimit dhe trajnimit; implementimin e projekteve me sisteme dhe pajisje të reja; çertifikimin dhe arritjen e kapaciteteve operacionale për pjesëmarrje në operacionet me NATO-n.



## 1.3 Punët e jashtme

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë një pjesë thelbësore e procesit të afrimit të Shqipërisë me BE-në. Në marrëdhëniet me Bashkimin Evropian, i cili përbën njëkohësisht modelin, synimin dhe partnerin tonë të gjithanshëm e të pazëvendësueshëm, Shqipëria ka një bilanc të pasur dhe të dukshëm:

- Që prej 1 janarit 2008 është në zbatim Marrëveshja e Lehtësimit të Vizave (përfshirë edhe me vendet si Danimarka, Norvegjia, Islanda dhe Zvicra).
- Në mars 2008 ka filluar dialogu për liberalizimin e lëvizjes me BE-në, i cili vazhdon me intensitet.
- Në 1 prill 2009, hyri në fuqi MSA-ja, e pasuar me ngritjen e mekanizmave të dialogut të ndërsjellë të Këshillit të Stabilizim Asociimit, Komitetit të Stabilizim Asociimit, dhe nënkomitetet.
- Pas konsultimeve intensive dhe bashkëpunimit të ngushtë me presidencën e BE-së, Komisionin evropian dhe vendet anëtare, në 28 prill 2009 Shqipëria ka paraqitur kërkesën formale për anëtarësim në BE. Gjithashtu, është forcuar, zgjeruar dhe intensifikuar dialogu politik me Bashkimin evropian dhe vendet anëtare të tij në të gjitha sferat e zhvillimit.
- Është forcuar në mënyrë të gjithanshme spektri i marrëdhënieve dypalëshe, që ka çuar edhe në zgjerimin e përfaqësimit diplomatik në Evropë me 6 përfaqësi të reja. Gjatë vitit 2009 pritet të hapet ambasada në Sllovaki, çka mbyll në tërësi procesin e zgjerimit diplomatik në hapësirën evropiane.
- Me planin e marrëdhënieve në fushën e sigurisë, më 13 korrik 2008 u nënshkrua Marrëveshja për dërgimin e trupave shqiptare në kuadër të operacioneve ushtarake të BE-së (EUFOR Tchad/RCA) për menaxhimin e krizave në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore.

Janë zhvilluar dhe zgjeruar marrëdhëniet me të gjitha vendet anëtare të BE-së dhe është plotësuar më tej kuadri i marrëveshjeve kontraktuale dypalëshe. Është konsoliduar dhe thelluar më tej dialogu politik me partnerët tanë strategjik si Italia, Greqia dhe Turqia, përmes realizimit të vizitave në nivelet më të larta si dhe është zgjeruar dhe forcuar kuadri ligjor me këto vende. Shqipëria do të vazhdojë t'i konsiderojë si parësore dhe të një rëndësie të veçantë marrëdhëniet me vendet fqinje si, Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, si dhe vendet e tjera të Ballkanit perëndimor. Po ashtu janë forcuar marrëdhëniet me aktorë të tjerë të mëdhenj, me fuqitë në rritje si India dhe Brazili, ku janë hapur përfaqësitë diplomatike. Janë në përfundim procedurat për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me rreth 30 vende të Azisë, Afrikës, Amerikës Latine dhe Oqeanisë me të cilat vendi ynë nuk kishte marrëdhënie diplomatike.

Në kuadër të përpjekjeve për një rol ndërkombëtar më aktiv, Shqipëria i ka kushtuar vëmendjen e duhur pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit në Organizatat ndërkombëtare. Plotësimi i kuadrit ligjor ndërkombëtar për çështje e fusha që kanë të bëjnë me demokracinë, shtetin e së drejtës, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, funksionimin e ekonomisë së tregut, etj., ka vazhduar me ritme të përshpejtuara.

Shërbimi konsullor është ndër aspektet e shërbimit publik që ka pësuar ndryshim rrënjësor. Legalizimi në Shqipëri dhe shërbimet konsullore në përfaqësitë diplomatike kryesore kryhen në bashkëpunim me shërbimin postar, që e ka transformuar këtë proces në një sistem modern, të shpejtë dhe efikas. Ndërtimi dhe funksionimi i Qendrës së Vizave në MPJ po sjell afrimin e praktikave tona me ato në vendet e BE-së në trajtimin dhe dhënien e vizave. Nga Qeveria Shqiptare është realizuar në mënyrë të njëanshme heqja e vizave afatshkurtra me një sërë vendesh përgjithësisht të listave pozitive të BE-së, vende të Ballkanit perëndimor, Amerikës Latine dhe lehtësime procedurash vizash me vende të Gjirit Persik. Gjithashtu, është përgatitur kuadri ligjor për lehtësimin e mëtejshëm të hyrjes së të huajve në Shqipëri dhe në këtë kuadër të gjithë shtetasit e vendeve të tjera që kanë vizë Shengen hyjnë në Shqipëri pa vizë. Janë përgatitur marrëveshjet për ngritjen e pikave të përbashkëta kufitare me Maqedoninë dhe Malin e Zi (Muriqan, Xhepish-Trebisht).

Prezantimi i një imazhi sa më realist për vendin, shoqërinë dhe mundësitë që ekzistojnë në Shqipëri, kulturën, vlerat dhe traditën e pasur shqiptare, rrënjët e saj të hershme e të pashkëputura evropiane, lehtësitë e krijuara për investimet e huaja direkte, bërja e njohur jashtë vendit e strategjisë së zhvillimit të turizmit dhe e potencialeve të tij, etj., kanë qenë pjesë e përhershme e agjendës së veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm. Për më tepër, ndryshimi i strukturës së MPJ-së në gjysmën e dytë të vitit 2008 është bërë



pikërisht për të reflektuar më së miri këtë aspekt gjithnjë e më të pranishëm. Në këtë kuadër, është rritur e përmirësuar rrjeti i konsujve të nderit në botë, si edhe është zgjeruar roli dhe veprimtaria e Akademisë Diplomatike për formimin profesional të nëpunësve të rinj, si komponent i rëndësishëm në ecurinë për karrierën diplomatike.

## 2 Demokratizimi dhe shteti i së drejtës

Përparim real ka njohur në Shqipëri konsolidimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor, si kusht përcaktues për funksionimin e shtetit ligjor. Shqipëria sot ka një nivel të lartë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të krahasueshëm me atë të shumë vendeve të Evropës juglindore. Megjithatë, nevojitet një orientim i reformës drejt forcimit të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, si prioritetet e Partneritetit European.

Një nga objektivat më madhore të qeverisë ka qenë dhe mbetet lufta kundër korrupsionit. Ndër reformat kryesore të ndërmarra përmenden: nxjerrja e administratës jashtë konfliktit të interesit dhe amendimi i ligjit të konfliktit të interesit, transparenca në të gjitha vendimet dhe shpenzimet publike, reformimi i sistemit të prokurimeve, krijimi i “ombudsmenit” të prokurimeve, liberalizimi i ekonomisë, rishikimi i procedurave të licencimit, privatizimi i korporatave të mëdha, mbështetja e plotë ndaj prokurorisë në luftën kundër korrupsionit. Sipas Raportit të Komisionit European për vitin 2008, Shqipëria ka bërë progres në luftën kundër korrupsionit, megjithatë angazhimi i autoriteteve në këtë luftë duhet të mbështetet në zbatimin e politikave përkatëse. Më tej, gjatë vitit 2008 janë përmbushur 11 nga 13 rekomandimet e GRECO-s. Këto rezultate shënohen edhe në Raportin ‘Transparency International’ të këtij viti, i cili e vlerësoi Shqipërinë në grupin e dhjetë vendeve me suksesin më të madh për vitin 2008, për sa i përket përmirësimit të perceptimit të luftës kundër korrupsionit.

Me miratimin e ligjit të ri për ‘Policinë e Shtetit’, si dhe zbatimin e sistemit të ri të gradave në polici, po realizohet transformimi i saj në një forcë policore që bashkëpunon me komunitetin. Në funksion të kësaj është përmirësuar legjislacioni dhe janë adoptuar teknika të reja investiguese, si dhe është thelluar bashkëpunimi policor me vendet e rajonit dhe vende të tjera. Gjatë këtij viti, një vëmendje e posaçme është treguar në drejtim të përmirësimit të administrimit të pasurive të konfiskuara dhe sekuestruara nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, si dhe të hetimit të krimit financiar dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Për të koordinuar punën në luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore është ngritur Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, pranë të cilit vepron njësia antitrafik. Po kështu, është miratuar Plani i Integruar i Menaxhimit të Kufirit. Në luftën kundër drogës, janë arritur rezultate të mira në drejtim të goditjes së rrjeteve kriminale të trafikut të lëndëve narkotike, dhe sipas Raportit të Zyrës për Drogën dhe Krimin të Kombeve të Bashkuara (UNODC) të marsit 2008, në të gjithë rajonin e Evropës juglindore ka një reduktim të formave të ndryshme të krimit të organizuar që ishin shumë më të zhvilluara gjatë viteve të tranzicionit.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2008 thekson se Qeveria shqiptare ka bërë një progres të dukshëm në përpjekjet e saj për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, qysh prej daljes së Raportit 2008. Veçanërisht, ka demonstruar përmirësime rrënjësore në identifikimin e viktimave të trafikimit.

## 2.1 Drejtësia


### Treguesi: Shteti i së drejtës, krahasuar me vendet e EJL-së

Reforma në drejtësi është mbështetur në marrjen e masave me karakter ligjor, institucional dhe administrativ, të cilat synojnë në forcimin e shtetit ligjor, rikthimin e besimit të qytetarëve të drejtësia, luftën pa kompromis kundër korrupsionit dhe transparencën e punës së organeve të drejtësisë. Kjo reformë ka përfshirë tre komponentë: (i) përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të gjykatave; (ii) përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të operatorëve pjesëmarrës në gjykim; dhe (iii) përmirësimin e procedurave, organizimit dhe funksionimit të operatorëve në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Me qëllim përmirësimin e sistemit gjyqësor është realizuar: (1) standardizimi i dosjeve gjyqësore; (2) përcaktimi i statusit të administratës gjyqësore; (3) rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në gjykata dhe forcimi i miradministrimit të drejtësisë; (4) zgjerimi dhe automatizimi i sistemit të administrimit të çështjeve në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit; (5) përfundimi i bazës ligjore për gjykatat administrative me hartimin e projektligjit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe organizimin e drejtësisë, si dhe parashikon bazën ligjore për krijimin, kompetencat, procedurën dhe emërimin e gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjet administrative në këto gjykata. Gjithashtu, është miratuar ndryshimi i ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë, i cili detajon dhe përmirëson kriteret e rekrutimit dhe të promovimit të prokurorëve, reflekton ndryshimet kushtetuese për detyrimin e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend dhe për mandatin e qëndrimit në detyrë të tij, për të drejtat dhe garancitë e prokurorëve (duke përfshirë edhe çështjen e imunitetit të prokurorëve).

Është përmirësuar kuadri ligjor që normon veprimtarinë e operatorëve të sistemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, duke miratuar ligjin për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat, qëllimi i të cilit konsiston në operimin në treg edhe të operatorëve privatë përmbartues. Më tej, janë kryer disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, që konsistojnë në reformimin e sistemit përmbartimor për përmirësimin e procedurave përmbartimore në harmoni me parashikimet e reja të ligjit për përmbartimin privat.

Gjatë vitit 2008 i është kushtuar rëndësi e veçantë rritjes dhe forcimit të kapaciteteve institucionale dhe administrative të sistemit penitenciar. Kapacitetet e akomodimit në sistemin penitenciar janë rritur, përmes ngritjes, vënies në funksionim dhe rikonstruktimit të një sërë ambientesh dhe hapësirash të reja, si: institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Fushë-Krujë, Korçë; spitali me mjekim të detyruar dhe paraburgimi i ri në Durrës; rikonstruksioni i burgut Rrogozhinë, rikonstruksioni i burgut Burrel; ngritja e institutit të të miturve në qytetin e Kavajës. Vihet re një rënie e mbipopullimit në këto ambiente, duke bërë të mundur në këtë mënyrë arritjen e raportit (mbipopullim/kapacitet) në nivelet më të pranueshme të mundshme.



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore

Në figurën 1 paraqitet ecuria në lidhje me shtetin e së drejtës për periudhën 2000-2008, sipas Treguesve të Qeverisjes<sup>1</sup> të matur çdo vit nga Banka Botërore për 212 vende. Treguesi i Shtetit të së drejtës lidhet me besimin dhe nënshkrimin e aktorëve të ndryshëm ndaj ligjeve të shoqërisë, dhe në veçanti cilësinë e zbatimit të kontratës, të drejtat e pronës, policia, gjyqësori, si edhe mundësia e kryerjes së krimit dhe dhunës. Shqipëria ka një pozicionim<sup>2</sup> mes 25-50% të vendeve të tjera që kanë një performancë mesatare për treguesin. Për vitin 2008, ka një rritje cilësore prej 4.4% krahasuar me vitin 2007, e cila lidhet edhe me ecurinë e demokratizimit dhe të shtetit të së drejtës.

Për stabilitetin politik, nga të gjitha vendet ballkanike, vetëm Mali i Zi ka patur një tregues më të mirë. Po ashtu, edhe treguesi i Cilësisë Rregullatore e rendit Shqipërinë në gjysmën e parë të vendeve me nivel më të mirë, ndërkohë që përmirësime të dukshme, janë vënë re edhe në treguesin e Lirisë së Fjalës dhe Përgjegjshmërisë. Por këtu, ndonëse është futur sërish në gjysmën e parë të vendeve me nivel më të lartë, ajo është disi prapa nga fqinjët dhe nën mesataren rajonale. Shqipëria ka patur përmirësim edhe në treguesin për efikasitetin e qeverisë, por ajo është nën mesataren e Evropës lindore apo vendeve të Balltikut e po ashtu edhe pas Malit të Zi, Maqedonisë e Serbisë.

Për të pasur një funksionim të drejtë të shtetit juridik, është domosdoshmëri krijimi i kushteve dhe mekanizmave për departizimin dhe depolitizimin e organeve të administratës shtetërore, për një zbatim efikas dhe të plotë të kushtetutës dhe të ligjeve. Për këtë do të ndërmerren nisma në lidhje me pjesëmarrjen më aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, me çështjen e ndikimit të politikës në procesin e demokratizimit dhe integritetit në BE.

---

1 Treguesit e tjerë të qeverisjes janë: përgjegjshmëria, qëndrueshmëria politike dhe mungesa e dhunës/terrorizmit, efektiviteti i qeverisë, cilësia rregullatore, shteti i së drejtës dhe kontrolli i korrupsionit.

2 Maksimumi dhe vlerësimi më i mirë për treguesin është 100%.

## 2.2 Të drejtat e pronës

### Treguesi: Numri i pronave që kanë marrë një certifikatë legalizimi

Sipas Raportit të Progresit për 2008 të Komisionit European, ka patur progres në konsolidimin e të drejtave të pronësisë, si prioritete themelore të Partneritetit European. Megjithatë, nevojitet të përshpejtohet procesi i kthimit dhe komisionit të pronave, si edhe të forcohet siguria mbi të drejtat e pronësisë. Aktualisht, reforma për të drejtat e pronësisë është udhëhequr nga vizioni i reformës për rregullimin e tregut të tokës, i cili do të jetë një faktor nxitës për zhvillimin ekonomik.

Në lidhje me procesin e legalizimit, janë përfshirë në proces 350,000 objekte informale, të cilat po i nënshtrohen procedurave të kualifikimit për legalizim, dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor, për pajisjen me leje legalizimi.

Sipas ALUIZNI-t, legalizimi dhe transformimi në pasuri formale të rreth 200,000 objekteve informale, që zënë një sipërfaqe prej 4,000 hektarësh, llogaritet të gjenerojë në treg një sasi mjaft të konsiderueshme kapitali të bllokuar. Bazuar në koston mesatare vjetore të ndërtimit, të publikuar nga Enti Kombëtar i Banesave, ky kapital pritet të arrijë vlerën 8 miliardë euro.

Gjatë vitit 2006-2008, është kryer evidentimi i rreth 350,000 objekteve informale në të gjithë vendin dhe krijimi i bazës së të dhënave përmes fotografimit ajror. Gjithashtu, ka përfunduar procesi i vetëdeklarimit vullnetar për 270,595 objekte, si dhe përcaktimi dhe miratimi i 127 vendbanimeve me ndërtime informale në territorin e Shqipërisë nga KRRTRSH-ja. Nga statistikat e përfuara nga përpunimi i të dhënave të pronësisë rezulton se 29% e ndërtimeve informale janë në pronën e pronarëve të ligjshëm, 24% në pronë publike dhe 35% ndërtuesi e ka truallin pronë të vetën. Ndërsa për rreth 14% nuk disponohet informacion.

Gjatë vitit 2008-2009 është kryer përditësimi i gjendjes ndërtimore dhe dixhitalizimi i të dhënave për 60% të ndërtimeve informale të përfshira në procesin e legalizimit. Gjithashtu, është kryer përfundimi i procedurave për kompensimin financiar të 873 pronarëve të ligjshëm, prona e të cilëve është zënë nga ndërtimet informale. Është dhënë “Leja e Legalizimit” dhe ka filluar përgatitja e dokumentacionit për regjistrim pranë Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), për 1300 objekte (pasuri) informale, nga të gjitha qarqet e vendit dhe kanë nisur procedurat e regjistrimit pranë ZRPP-ve vendore. Ndërkohë, po vijon përmbyllja e procedurave administrative për pajisjen me “Leje Legalizimi” edhe për 12 297 objekte. Aktualisht, ka përfunduar dhe është miratuar me VKM-të përkatëse harta e vlerës për të gjithë territorin, prandaj dhe shpërndarja e fondit prej 500 milion lekësh për vitin 2008 është shtrirë në të dymbëdhjetë qarqet. Për periudhën në vijim, mbetet për t’u përmbyllur procesi për pajisjen me leje legalizimi për pjesën tjetër të pasurive, si edhe përfundimi i dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e pasurive të legalizuara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të tokës, gjatë vitit 2008 janë ndërmarrë 5000 vendime, nga të cilat 4396 janë vendime përfundimtare të dhëna nga ana e Zyrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Gjithashtu, është përfunduar procedura e pranimit dhe vlerësimit të 740 kërkesave. Ndërkohë, janë miratuar 4 VKM për tokat bujqësore, pyjet e kullotat e lira dhe objektet shtetërore, me qëllim krijimin e fondit fizik të kompensimit. Gjatë 2008 filloi procesi për përgatitjen e hartave të tokave të lira bujqësore që parashikohen për fond kompensimi fizik. Megjithatë ende mungon një inventar i plotë mbi pronat e përcaktuara për kompensimin e ish-pronarëve. Gjatë vitit 2008 ka vijuar reforma në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim përmirësimin e shërbimit, eficiencën dhe transparencën në sistemin e regjistrimit të pasurive, si dhe përfundimi i regjistrimit fillestar. Në këtë kuadër, janë miratuar një sërë aktesh normative për përmirësimin e shërbimit dhe lehtësimin e procedurave të regjistrimit, si dhe është mundësuar instalimi i aplikimit elektronik nga qytetarët. Gjithashtu, ka filluar kompjuterizimi dhe automatizimi i zyrave rajonale, me përparësi Tiranën dhe Durrësin, proces i cili nevojitet të përshpejtohet dhe të përmirësohet.

Sfidë mbetet vijimi i procesit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme, i cili nuk është realizuar për zonat e planifikuara në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Fier. Nevojitet të përshpejtohet dhe të finalizohet procesi, me qëllim regjistrimin fillestar të 120,000 pasurive urbane. Hap me rëndësi në kuadrin e reformës së të drejtave të pronës ka qenë miratimi gjatë vitit 2008 i ligjit “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”<sup>3</sup>. Ky ligj synon konsolidimin e titujve të pronësisë mbi tokën duke

3 Ligji nr. 9948, datë 07.07.2008.


kryer verifikimin e titujve të pronësisë për tokat e ish-kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve bujqësore të dhënë që nga viti 1991. Për këtë janë ngritur Komisionet Vendore të Vlerësimit, nën drejtimin e Prefektit përkatës, që do të kryejnë verifikimin e titujve të pronësisë. Ecuria e procesit të verifikimit nga këto komisione kryhet nga Komisioni Qeveritar i Tokës, i cili merr gjithashtu vendime për zgjidhjen e konflikteve territoriale ndërmjet qarqeve.

Në aspektin e orientimit strategjik të reformave për të drejtat e pronës, gjatë vitit 2008 është punuar për përditësimin dhe konsultimin me të gjitha grupet e interesit të projekt-strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë”, si edhe planit të saj të veprimit. Megjithatë, kjo draft-strategji nevojitet të finalizohet dhe të miratohet, me qëllim përshpejtimin e reformave.

## 2.3 Anti-korrupsioni

### Treguesi: Kontrolli i korrupsionit

Raporti i Progresit i Komisionit Europian vlerëson përpjekjet e ndërmarra, thekson një përmirësim të perceptimit të luftës kundër korrupsionit. Një tregues i rëndësishëm për korrupsionin është edhe Treguesi i Kontrollit të Korrupsionit, që monitorohet çdo vit nga Banka Botërore së bashku me 5 tregues të tjerë të qeverisjes. Në figurën 2 paraqitet ecuria e Shqipërisë në lidhje me treguesin e Kontrollit të Korrupsionit të monitoruar nga Banka Botërore për periudhën 1996-2008, dhe renditja e vendeve të rajonit për vitin 2008. Për vitin 2008 shënohet një rritje prej 3,6%, por megjithatë mbetet ende shumë për t'u bërë, pasi krahasuar me vendet e rajonit Shqipëria renditet në vend të parafundit, pas Serbisë, duke lënë pas Kosovën. Gjithashtu, një tjetër tregues i rëndësishëm për korrupsionin është Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit sipas organizatës ndërkombëtare Transparency International. Në lidhje me këtë tregues, Shqipëria ka njohur progres të ndjeshëm për vitin 2008, pasi u rendit në vend të 85 me 3,4 pikë, ndërkohë që në vitin 2007 renditej në vend të 105 me 2.9 pikë.



Burimi: Treguesit e Qeverisjes, Instituti i Bankës Botërore

Reforma për luftën kundër korrupsionit është orientuar në radhë të parë në marrjen e masave me karakter parandalues. Në këtë kuadër, në legjislacionin e brendshëm janë vendosur standardet e Konventës Penale të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit, si dhe ka filluar dhe po vijon përafrimi i legjislacionit civil me standardet e Konventës Civile kundër Korrupsionit të KE-së. Vlen të përmendet: ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit; miratimi i ndryshimeve në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave; miratimi i ligjit për bashkëpunimin e qytetarëve dhe shpërblimin e atyre që denoncojnë korrupsionin; miratimi i ligjit mbi ndërrmarrjet tregtare në prill 2008 i përafuar me Konventën Civile kundër Korrupsionit të KE-së. Reforma është orientuar drejt reduktimit të korrupsionit në sektorë të tillë si taksat, tatimet, prokurimet, shërbimet ndaj biznesit, pranimet në universitete, etj., ku është arritur përparim i dukshëm. Kështu, është ngritur sistemi i pagimit të taksave on-line për bizneset e mëdha, që ka minimizuar korrupsionin dhe ulur kostot e biznesit në llogaritjen, njohjen dhe pagimin e detyrimeve financiare. Ky sistem po shtrihet gradualisht për të gjitha bizneset.

Është instaluar sistemi i prokurimit elektronik, që eliminon abuzimet me tenderat publikë. Prokurimet elektronike të zhvilluara në vitin 2008 përbëjnë 2% të totalit të vlerës së prokuruar, ndërsa për vitin 2009 të gjitha prokurimet publike do të zhvillohen në rrugë elektronike, duke ndikuar në uljen e kostos së përgjithshme të prokurimeve, rritjen e transparencës dhe uljen e korrupsionit. Është konsoliduar funksioni i Qendrës Kombëtare për Regjistrimin e Biznesit dhe u miratua baza ligjore për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Licencave. Në vijim, parashikohet krijimi i regjistrimit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe ngritja e gjykatave administrative, që do të kontribuojnë më tej në luftën kundër korrupsionit. Është rritur forca goditëse ndaj


korrupsionit në radhët e administratës publike. Gjatë vitit 2008, janë evidentuar 276 vepra penale korrupsioni të nëpunësve publikë, ku janë arrestuar 44 persona. Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër korrupsionit dhe e qeverisjes transparente, si edhe plani përkatës i veprimit për vitin 2009, që u miratua nga qeveria në tetor 2008, përcakton edhe orientimet dhe vizionin për këtë reformë të rëndësishme.



## 2.4 Krimi i organizuar

### Treguesi: Trafikimi i qenieve njerëzore

Në qendër të vëmendjes për vitin 2008 ka qenë parandalimi, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, identifikimi, ndihma dhe mbrojtja e viktimave, apo viktimave të mundshme të trafikimit. Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit, flasin për një ulje të numrit të femrave të trafikuar të pasqyruara në grafikun në figurën 3.



Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit

Gjatë vitit 2008 është bërë informatizimi i 73% të pikave të kalimit të kufirit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, përmes instalimit të Sistemit Total të Menaxhimit të Informacionit (TIMMS) në pikat kryesore të kalimit të kufirit dhe vendosjes së njësisë së lëvizshme të vëzhgimit. Ky modernizim i pajisjeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit ka sjellë shkurtime të kohës së përpunimit të udhëtarëve dhe mjeteve në pikat e kalimit të kufirit, me qëllim rritjen e sigurisë kufitare. Trajnimi i vazhdueshëm i efektivave të Policisë Kufitare dhe Migracionit, dhe nënshkrimi i marrëveshjeve e protokolleve të bashkëpunimit kufitar me vendet fqinje kanë ndihmuar në rritjen e efektivitetit. Ndërsa në drejtim të bashkëpunimit ndërkufitar, gjatë vitit 2008, ka filluar patrullimi i përbashkët me Maqedoninë dhe Malin e Zi; është punuar për hapjen e pikës së kalimit të kufirit të përbashkët Muriqan/Sukobinë me Malin e Zi, e cila u bë funksionale në vitin 2009. Janë kryer patrullime të sinkronizuara me Policinë Kufitare të Kosovës, si dhe janë zhvilluar operacione të përbashkëta me policinë greke në kuadër të sigurisë së kufijve”.

Gjatë këtij viti u unifikua numri i viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit të raportuara nga institucionet shtetërore dhe ato joshtetërore, si dhe u vu, për herë të parë, në funksionim të plotë baza e të dhënave për viktimat e trafikimit, e aksesuar nga autoriteti përgjegjës dhe Zyra e Koordinatorit Kombëtar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Kjo bazë të dhënash, e cila mbledh informacion mbi menaxhimin e rasteve specifike të trafikimit, luan një rol të rëndësishëm në përditësimin e informacionit që prej identifikimit fillestar të një viktime të mundshme deri në riintegrimin e plotë. Gjithashtu, është punuar për përmirësimin e funksionimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat, duke identifikuar të paktën pesë herë më shumë viktime se gjatë vitit të kaluar.

Moratoriumi për bllokimin e plotë të lëvizjes së skafeve në det ka vazhduar sikurse edhe ndjekjet penale dhe dënimet e trafikantëve. Ende mbeten problem veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, siç janë ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve apo shfrytëzimi për prostitucion, si dhe keqtrajtimi i të miturve. Shërbimet për ri-integrimin afatgjatë të viktimave mbeten gjithashtu një problem, për zgjidhjen e mundshme të të cilit, organet kompetente kanë filluar të ndërmarrin hapat e nevojshme. Marrëveshja e bashkëpunimit për krijimin e një mekanizmi kombëtar referues për identifikimin dhe asistencën e përmirësuar për viktimat

e trafikimit të qenieve njerëzore është instrument i vlefshëm për bashkërendimin sa më të mirë të veprimeve për referim, ndihmë dhe rehabilitim.

Gjithashtu, është miratuar ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër terrorizmit dhe aktet përkatëse ligjore, duke përmbyshur në këtë mënyrë rekomandimet e raportit të raundit të tretë reciprok të Komitetit pranë Këshillit të Evropës, MONEYVAL<sup>4</sup> si dhe ato ndërkombëtare të FATF- së (Grupi i Veprimit Financiar). Në zbatim të këtij ligji është ngritur Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP), i cili përcakton drejtimit e politikës në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit.

Në Raportin e Progresit për vitin 2008, Komisioni Europian ka vlerësuar përparimin e bërë në lidhje me zbatimin e masave konkrete kundër krimit të organizuar. KE njeh meritat e Policisë Kufitare dhe Migracionit në përmirësimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit, duke kontribuar dukshëm në luftën ndaj krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe parandalimin e flukseve migratore, si dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj shtetasve, duke bashkëpunuar më mirë me organet homologe të vendeve fqinje.

Megjithatë, përmendet nevoja për të rritur ritmin, numrin dhe cilësinë e ndjekjes ligjore të veprave të krimit të organizuar dhe ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Kjo kërkon një përdorim më intensiv të të dhënave informative dhe përmirësimin e lëvizjes së informacionit ndërmjet agjencive publike edhe me institucionet e huaja të kontrollit të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi i gjyqësorit me policinë e shtetit do t'i përmirësonte më tej rezultatet, ndërkohë që nevojitet të bëhet më shumë në drejtim të hetimit të krimit financiar. Për të parandaluar veprimtaritë e pastrimit të parave është e nevojshme të fuqizohet Njësia Informative Financiare (Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave) dhe të plotësohet kuadri ligjor përkatës.

Për periudhën në vijim do të vazhdojë zbatimi i Strategjisë të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe të Planit të saj të Veprimit dhe do të bëhet përditësimi i këtij plani veprimi në përputhje të plotë me katalogun Shengen. Në qendër të vëmendjes do të jetë institucionalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me agjencitë e specializuara të BE-së (FRONTEX), në drejtim të Menaxhimit të Kufijve. Do të përfundojë instalimi dhe operacionalizimi i sistemeve të integruara të informacionit (MEMEX, TIMS) që i shërbejnë nga njëra anë kontrollit ndërkufitar të njerëzve dhe mallrave, nga ana tjetër luftës kundër krimit të organizuar, trafikut dhe terrorizmit. Sfidë mbetet ngritja e menaxhimit kufitar në disa porte në standardet ndërkombëtare. Për këtë do të ngrihet Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, e cila do të jetë një strukturë ndërinstitucionale koordinative me detyrë organizimin, planifikimin dhe drejtimin e operacioneve të kufirit blu në përputhje me legjislacionin detar vendas dhe atë ndërkombëtar.

---

4 MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave (Committee of Experts for the Evaluation of Measures against)

## 2.5 Rendi publik



### Treguesi: Shkelje penale për 100,000 banorë (përfshirë shkeljet e kundërvajtjeve në trafik) krahasuar me disa vende evropiane të përzgjedhura

Rendi publik ka patur progres në vijimësi, çka është vënë në dukje edhe nga Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2008, i cili thekson sidomos miratimin e Ligjit për Policinë e Shtetit në vitin 2008. Miratimi i Ligjit i ri për Policinë e Shtetit (2008) përcaktoi menaxhimin e përmirësuar të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, duke i kaluar këto funksione nga Ministria e Brendshme tek policia. Ky është një hap i rëndësishëm drejt depolitizimit të policisë.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme, treguesi i shkeljeve penale për 100,000 banorë është 321, bazuar në një përllogaritje që për 4,249,942 banorë të popullsisë së Shqipërisë janë kryer 13,426 vepra penale. Meqenëse “European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics”, i cili shërben si burim të dhënash krahasimore me vendet e tjera, nuk është botuar, vështirësohet krahasimi për këtë tregues.

Evidentimi i veprave penale është rritur për vitin 2008, ku zbulueshmëria e krimeve të veprave penale arriti në masën 81% krahasuar me 79% për vitin 2007. Janë evidentuar 13,426 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 10858, ku në lidhje me vrasjet kriminale janë zbuluar 83% e tyre (të dhënat sipas grafikëve më poshtë). Në luftën kundër trafikëve të paligjshme, (trafik i qenieve njerëzore, trafik i mjeteve motorike, trafik i armëve dhe i veprave të artit me vlerë kombëtare) janë goditur 79 grupeve kriminale dhe janë kapur 177 persona të shpallur në kërkim për krime në fushën e trafikëve. Në vitin 2008 u arrit minimumi i vrasjeve të 18 viteve të fundit, pasi kanë ndodhur 85 vrasje, 18 vrasje më pak se në vitin 2007, dhe 46 vrasje më pak se në vitin 2005. Sipas vlerësimeve, ulja e sasive të drogës të sekuestruara nga autoritetet italiane, tregon për një reduktim të ndjeshëm të trafikimit të drogave që kalojnë tranzit nëpërmjet Shqipërisë për në Itali dhe Bashkimin Evropian. Sasia e kokainës që tranzitohet nga Shqipëria mbetet e papërfillshme, ndërsa drogat sintetike ende nuk përbëjnë një problem për vendin tonë.

Të dhënat e paraqitura në formë grafike në figurat 4 dhe 5 dëshmojnë qartë për një rritje të treguesve kryesorë të ecurisë së punës së policisë dhe rezultatet pozitive të arritura përgjatë vitit 2008.




Burimi: Ministria e Brendshme

## 2.6 Administrata publike

### Treguesi: Numri i ankimeve në lidhje me zbatimin e ligjit mbi Shërbimin Civil, sipas llojit

Duke iu referuar Raportit të Komisionit European për vitin 2008, theksohet “vijimi i stabilitetit në administratën publike”, por më shumë duhet bërë “për të forcuar paanshmërinë e administratës publike dhe për të patur një shërbim civil të pavarur, profesional dhe me bazë meritash”.

Një tregues i stabilitetit të administratës publike gjatë vitit 2008 është edhe rënia e ankesave për zbatimin e ligjit mbi Shërbimin Civil: 193 ankesa nga 354 ankesa të paraqitura gjatë vitit 2007. Nga këto ankesa 69 janë zgjidhur në favor të nëpunësit dhe 75 kundër nëpunësit civil. Siç paraqitet edhe në figurën 6, nga këto ankesa, numrin më të madh e përbëjnë ato me objekt masë disiplinore, që janë 83 ankesa ose 42% të numrit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin 2007, kjo shifër është pothuaj në të njëjtat nivele. Vërehet një ulje e ankesave me objekt ristrukturimin, ku nga 132 janë ulur në 43 ankesa, ose nga 37,4% në 22,3%, dhe sipas KSHC-së, pjesa më e madhe e ankesave është paraqitur nga punonjës të administratës vendore dhe të doganave.



Burimi: Komisioni i Shërbimit Civil

Hapa të mëtejshme janë kryer për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore përmes trajnimeve, sidomos lidhur me përgatitjen e administratës publike për t’u përballur me sfidat e integritetit evropian. Në këtë kuadër vlen të përmendet forcimi i mëtejshëm i ITAP-it përmes krijimit të Qendrës së Trajnimit Fiskal dhe Qendrës së Trajnimit të Pushtetit Vendor, si nevojë për trajnimin e administratës tatimore dhe administratës vendore.


Megjithatë, për orientimin e mëtejshëm të politikave për administratën publike nevojitet të nxitet zbatimi i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike, e cila është miratuar në tetor të vitit 2009, pasi është konsultuar gjerësisht me aktorët e interesit dhe donatorët gjatë vitit 2008. Kjo strategji orienton kah ndryshimeve në ligjin e statusit të nëpunësit civil, me qëllim thellimin e reformës në shërbimin civil dhe zgjerimin e fushës së veprimit të ligjit të shërbimit civil.

## 2.7 Decentralizimi

### Treguesi: Përbushja e parimeve të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore

Gjatë vitit 2008 fokusi ka qenë thellimi dhe zgjerimi i procesit të decentralizimit të pushtetit vendor, përmes forcimit të nivelit të parë të qeverisjes vendore. Në qendër të vëmendjes ka qenë rritja e autonomisë fiskale të njësisë të qeverisjes vendore, përmes rritjes së granteve dhe përmirësimit të formulës për detajimin e transfertës së pakushtëzuar. Në lidhje me nivelin dhe shpërndarjen e grantit të pakushtëzuar është përvijuar një qasje e qëndrueshme dhe me financime në rritje për pushtetin vendor. Për vitin 2008 nga buxheti i shtetit u shpërndanë 123 miliardë lekë ose 3.5% të shpenzimeve totale të buxhetit. Siç paraqitet në figurën 7, grantet e investimeve për njësitë e pushtetit vendor për vitin 2008 janë rritur me 37% dhe kanë arritur vlerën 3.7 miliardë lekë, duke financuar 496 projekte. Vetëm për projektin e rrugëve rurale janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 37 miliardë lekë për vitin 2008.

Figura 7. Granti i investimeve për pushtetin vendor 2005-2009



Burimi: Ministria e Brendshme

Janë finalizuar një sërë nismash ligjore për forcimin e autonomisë fiskale të njësisë të qeverisjes vendore. Në këtë kuadër, është miratuar ligji “Për huamarrjen vendore”, i cili përcakton qartësisht borxhin, përfshirë çdo detyrim fiskal apo financiar të krijuar nga një marrëveshje financiare me palë të treta. Gjithashtu, ligji përcakton kufijtë e borxhit të një njësie vendore, si edhe të borxhit kombëtar. Në përputhje me këtë ligj, udhëzimi përkatës i Ministrisë së Financave shpjegon në detaje procedurat, kushtet dhe mënyrën se si njësitë e pushtetit vendor mund të aplikojnë për hua në tregun kombëtar apo ndërkombëtar. Për vitin 2008, vlen për t’u përmendur gjithashtu, miratimi i ligjit për taksat vendore, si dhe hartimi i “Udhëzuesit për administrimin e taksave vendore”.

Më tej, gjatë vitit 2008, pushteti vendor ka vijuar të administrojë taksën e biznesit të vogël, e cila është transferuar në fillim të vitit 2007 në administrim të organeve të qeverisjes vendore. Megjithatë vështirësitë e hasura, menaxhimi i kësaj takse nga njësitë vendore është një hap pozitiv në drejtim të rritjes së autonomisë fiskale. Ky kuadër fiskal i përmirësuar e fuqizon më tej pushtetin vendor dhe i krijon mundësitë e nevojshme për të rritur të ardhurat vendore dhe për rrjedhojë për t’iu përgjigjur më mirë nevojave për shërbime publike.

Gjatë kësaj kohe është punuar për hartimin e projektligjit “Për financat vendore”, i cili kompletton më tej objektivat e ligjit mbi menaxhimin e buxhetit<sup>5</sup>. Ky ligj synon të përmirësojë kuadrin ligjor në drejtim të rritjes së autonomisë fiskale, duke vendosur (i) rregulla të qarta që përcaktojnë marrëdhëniet fiskale midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore; (ii) kriteret dhe koeficientët për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar; (iii) qartësimin e detyrimeve të dyanshme të çdo niveli të qeverisjes në lidhje me shkëmbimin e informacionit

5 Ligji N. 9936, datë 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

ekonomiko-financiar; (iv) procedura dhe afate kohore të përmirësuara në lidhje me monitorimin dhe auditimin e qeverisjes vendore; (v) qartësimin e përgjegjësive të të zgjedhurve vendor dhe qeverisjes vendore në zbatimin e programeve të zhvillimit dhe përdorimin e fondeve publike.

Procesi i transferimit të pronave publike në varësi të pushtetit vendor ka vijuar të zbatohet gjatë vitit 2008 me ritme të përsheptuara dhe pritet të përfundojë krejtësisht përgjatë vitit 2009. Gjatë vitit 2008, përfundoi procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave ku janë transferuar rreth 630 000 ha pyje dhe rreth 300 000 ha kullota në pronësi të pushtetit vendor. Gjithashtu, ka përfunduar procesi i transferimit të administrimit të konvikteve të shkollave të mesme tek bashkitë dhe komunat. Në fund të vitit 2008 përfundoi inventarizimi i pronave dhe miratimi i listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen brenda juridiksionit territorial për 373 bashki dhe komuna. Gjithashtu, kanë përfunduar miratimet e listave paraprake në rreth 130 njësi të qeverisjes vendore dhe ka përfunduar tërësisht procesi në mjaft njësi të qeverisjes vendore, si Durrësi, Elbasani, Korça, Lezha, Burreli, Pogradeci, Peshkopia, Gramshi, Përrenjasi, janë në përfundim Shkodra, Vlora, Fieri etj. Janë miratuar 400 VKM për kalimin në administrim të pronave të paluajtshme shtetërore institucioneve qendrore. Në lidhje me reformën e decentralizimit të ujësjellës-kanalizimeve, gjatë vitit 2008, nga gjithsej 55 shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve, 46 janë transferuar në varësi të pushtetit vendor.

Sfidat në vijim për procesin e decentralizimit lidhen me (i) forcimin e kapaciteteve profesionale të të zgjedhurve vendorë dhe të stafit të tyre, nëpërmjet trajnimeve për rritjen cilësisë së shërbimeve publike, (ii) përfshirjen e komunitetit në hartimin e prioriteteve të zhvillimit, (iii) luftën kundër korrupsionit, zbatimin e ligjit etj. Gjithashtu, fokusi do të vihet edhe në thjeshtimin e strukturave administrative dhe rritjen e transparencës në vite.

# 3

## Zhvillimi Ekonomik dhe Social

Forcimi i themeleve për zhvillimin ekonomik dhe social përbën një prioritet themelor për Shqipërinë. Me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme rregullatore dhe administrative, me nxitjen e zhvillimit të biznesit dhe iniciativës për investime, do të sigurohen zhvillime të qëndrueshme për sa i përket standardeve të jetesës së qytetarëve, si edhe do të shtrohet rruga për hyrjen në Bashkimin European.

Reformat lidhur me fuqizimin e ekonomisë së tregut dhe rritja e rolit të qytetarit në shoqëri, janë garancia më e mirë për një të ardhme të re me paqe, qëndrueshmëri, dhe begati. Në të njëjtën kohë ato përforcojnë reformat e tjera të ndërmarra, që nga: forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës, rritja e efikasitetit të qeverisjes, mundësitë më të mira për punësim, çelja dhe zgjerimi i bizneseve, mundësitë më të mira për të udhëtuar dhe për transport, për strehim dhe shërbime vendore më efikase, si dhe një administratë më e ndjeshme ndaj nevojave të qytetarëve.

Gjithashtu, iniciativat ekonomike dhe sociale të ndërmarra përfitojnë edhe nga sigurimi i një stabiliteti të lartë makro-ekonomik, nga përmirësimi në mbledhjen e të ardhurave, nga kontrolli rigoroz mbi shpenzimet publike dhe nga struktura administrative efikase. Të gjitha këto reforma të ndërmarra dhe që kanë vazhduar të thellohen edhe gjatë këtij viti, kanë sjellë rritjen e besimit të biznesit duke siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës, ndërmarrjen e veprimeve serioze kundër korrupsionit dhe disiplinimin e sektorit informal.

## 3.1 Infrastruktura

Infrastruktura mbetet një nga prioritetet më të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare, fakt i dëshmuar edhe gjatë vitit 2008 nëpërmjet vazhdimit të investimeve dhe fillimit të projekteve të reja infrastruktururore.

Gjatë periudhës 2005-2009 janë përgatitur projekte rrugore të rëndësisë kombëtare dhe janë alokuar fonde të konsiderueshme për investime në rrjetin kombëtar dhe rajonal të rrugëve me efekte në zhvillimin e rajoneve, duke ofruar mundësi për një zhvillim më të balancuar në të gjithë vendin. Fondet e vëna në dispozicion në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës rrugore flasin qartë për prioritetin e dhënë nga Qeveria Shqiptare, krahasuar me periudhat e mëparshme. Gjatë periudhës 2005-2009 janë investuar në rrugë rreth 2 miliardë dollarë, ndërsa në vitin 2009 krahasuar me vitin 2005 rreth 7 herë më shumë.

Politikat energjetike të ndërmarra gjatë vitit 2008 kanë sjellë progres në reformimin tërësor të sektorit dhe hapjen ndaj tregut privat, ngritjen e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, projektet për lidhjen me rrjetin energjetik rajonal, etj. Është përmirësuar performanca e KESH-it, i cili është ristrukturuar dhe është ndarë në tri kompani të veçanta në bazë të funksioneve. Është përfunduar me sukses privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga kompania çeke CEZ në 2009.

Reformimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka hyrë tashmë në një proces ristrukturimi tërësor, përmes decentralizimit dhe komercializimit të këtyre shërbimeve. Iniciativa ligjore për administrimin e ndërmarrjeve të furnizimit me ujë nga autoritetet lokale, rishikimi i ligjit të rezervave ujore, politikat e qeverisë në miradministrimin e burimeve ujore në tërësi, janë pjesë e një programi dhe strategjie sektoriale në kuadër të menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe kërkesës bazë të Direktivës Evropiane për Ujin. Gjithashtu po zhvillohet një Model Standard për Marrëveshjen e Performancës, me qëllim reduktimin gradual të subvencioneve nga shteti për operimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellës-kanalizimeve.

Në sektorin e mbetjeve të ngurta po punohet për sigurimin e infrastrukturës së administrimit të mbetjeve të ngurta në të gjithë vendin nëpërmjet investimeve të reja për ndërtimin e vend-depozitimeve të reja për administrimin e mbetjeve konform legjislacionit shqiptar dhe atij evropian si dhe mbylljen e vend-depozitimeve ekzistuese me qëllim garantimin e mjedisit dhe shëndetit të popullatës. Në qendër të vëmendjes mbetet përmirësimi i legjislacionit të menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet adoptimit të direktivave të komunitetit evropian. Sfidë mbetet trajtimi në mënyrë të kontrolluar sanitare i mbetjeve të ngurta urbane, nëpërmjet ndërtimit të 12 vend-depozitave rajonale deri në vitin 2020, mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit.


### 3.1.1 TRANSPORTI

#### **Treguesi: Numri i kilometrave të ndërtuara të rrjetit rrugor kombëtar**

Gjatë kësaj periudhe infrastruktura rrugore, është përmirësuar me ritme të paimagjinueshme më parë. Investime të mëdha janë bërë dhe po bëhen në akse të ndryshme rrugore nga veriu në jug e nga lindja në perëndim të Shqipërisë duke sjellë një ndryshim të dukshëm dhe të prekshëm për të gjithë shqiptarët dhe duke bërë kështu që Shqipëria të shndërrohet në një vend me infrastrukturë evropiane. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore ka qenë përparësi e politikave dhe investimeve publike gjatë vitit 2008, ku është synuar integrimi i rrjetit kombëtar të rrugëve në rrjetin e transportit evropian. Figura 8 tregon se numri i kilometrave të rrjetit rrugor nacional ndërtuar gjatë vitit 2008, është thujse dyfishuar, me karakteristika kryesore progresin e bërë për financimin e ndërtimit të rrugëve të standardeve të larta me 2x2 kalime, me tunele dhe vepra arti madhështore.



Figura 8. Kilometrat e rrjetit rrugor kombëtar 2005-2008



Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit, 2009

Siç tregohet në grafik, vetëm për vitin 2008 janë ndërtuar 168.8 km rrugë të reja, nga të cilat 121.5 km me financim të brendshëm dhe 47.3 km me financim të jashtëm. Përparësi gjatë vitit 2008 ka qenë ndërtimi i autostradës Durrës-Prishtinë, si edhe vazhdimi i korridoreve lindje-perëndim dhe veri-jug. Projekti më i madh rrugor, rruga Durrës-Kukës-Morinë, është përfshirë në Rrjetin bazë të Evropës Juglindore (SEETO) dhe është klasifikuar si “route 7”, që lidh Korridorin VIII me korridoret e tjera. Ndërkohë është punuar intensivisht për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve: Korçë-Q. Plloçë, Bulqizë-Bllatë-Ura e Çerenecit-Peshkopi (pjesë e rrugës së Arbërit); dublimin e rrugës Fushë Krujë-Milot; mbikalimi në Plepa, Kavajë-Rrogozhinë; segmenti Dhërmi-Himarë-Qeparo-Sarandë; sistemimin dhe asfaltimin e shumë akseve rrugore dhe të rrugëve hyrëse të qyteteve; realizimin e rrugëve turistike dhe të segmenteve rrugore që ndërlidhin pikat e kalimit kufitar etj. Gjatë vitit 2008 janë investuar nga buxheti i shtetit 60.71 miliardë lekë, pothuaj dyfishi i investimeve për transportin rrugor për vitin 2007.

Në fushën e transportit rrugor një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit rajonal. Dëshmi e kësaj politike janë rritja e marrëdhënieve të bashkëpunimit sidomos me shtetet fqinjë si Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Greqia. Ky bashkëpunim ka konsistuar në liberalizimin e tregut të transportit të udhëtarëve Shqipëri-Greqi; uljen e tarifës së biletës së udhëtimit me rreth 30%; liberalizimin e transportit rrugor të mallrave me Maqedoninë; njohjen e ndërsjellë të konvertimit të lejes së drejtimit Shqipëri-Itali.

Gjatë vitit 2008, Shqipëria ka aderuar dhe ka ratifikuar 6 konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare për transportin rrugor, si dhe janë përfunduar iniciativa ligjore në përputhje me Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, me daljen e akteve ligjore. Në kuadrin e Planit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së (PKZMSA) është realizuar ristrukturimi tërësor i Hekurudhës Shqiptare sha. në bazë të parimeve të përcaktuara në direktivat e BE-së dhe është hartuar plan-veprimi për zbatimin gradual të legjislacionit evropian.


Në rrjetin rrugor të Korridorit 8 u shtuan edhe dy lidhje me Greqinë: Kapshtica dhe Kakavija, ndërsa me nënshkrimin e Memorandumit të Barit në këtë rrjet u përfshinë Portet e Barit, Brindizit dhe Vlorës. Është bërë rehabilitimi i lidhjeve rrugore Durrës-Vlorë paralel me investimet në portin e Durrësit (terminali i pasagjerëve dhe ai i mallrave) dhe të Vlorës. Në kushtet e përqendrimit të fondeve në infrastrukturën rrugore, portuale dhe aeroportuale, po synohet rigjallërimi i rrjetit hekurudhor nëpërmjet tërheqjes së kapitalit privat, si dhe të fondeve të mundshme nga institucione financiare ndërkombëtare e donatorë të ndryshëm.

Transporti hekurudhor ndërkombëtar i mallrave ka patur një rritje të vazhdueshme. Në transportin hekurudhor të mallrave, në vitin 2008, është realizuar një vëllim pune në treguesin ton/km rreth 2 herë më i madh se volumi i punës i realizuar në vitin 2005. Në vitin 2008, në transportin ndërkombëtar hekurudhor janë transportuar rreth 3 herë më shumë mallra se në vitin 2005 dhe është realizuar një vëllim pune në treguesin ton/km 3.3 herë më shumë.

Për periudhën në vijim përparësi do të ketë përfundimi i aksit të rëndësishëm kombëtar Durrës-Morinë, vijimi i segmenteve të rrugës së Arbërit, ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve rurale dhe i rrugëve kombëtare etj. Në qendër të vëmendjes do të jetë përmirësimi dhe zhvillimi i rrugëve që ndërlidhin pikat e kalimit kufitar dhe rrugët turistike, rritja e rendimentit të tyre, si dhe përmirësimi i sistemit të administrimit të mirëmbajtjes së rrjetit kombëtar rrugor; nxitja e ndërtimit të rrugëve të tjera me konçension; përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit kombëtar rrugor nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore (përfshirë urat), privatizimit të plotë të shërbimeve, si dhe dyfishimit të shpenzimeve për mirëmbajtjen.

### Treguesi: Numri i rasteve të vdekjeve në aksidente rrugore për 10,000 mjete

Aksidentet rrugore në Shqipëri konsiderohen shqetësuese megjithë përmirësimin e dukshëm dhe të thellë të infrastrukturës. Shkaku i i tyre rezulton të jetë shpejtësia si dhe mosrespektimi i rregullave të qarkullimit. Deri në vitin 2007 numri i aksidenteve dhe personave të aksidentuar ka ardhur në rritje. Sipas të dhënave të INSTAT-it, në vitin 2008 vihet re një rënie, me 3.6%, e numrit të aksidenteve krahasuar me 2007, përkatësisht 1,254 aksidente në vitin 2007 dhe 1,208 për vitin 2008. Ndërsa numri i personave të aksidentuar ka pësuar një rënie në 2008 me 9.9% kundrejt vitit 2007, 1,344 të plagosur dhe 384 të vdekur për vitin 2007; kurse për vitin 2008 rezultojnë 1,256 të plagosur dhe 303 të vdekur. Në figurën 9 paraqitet situata e aksidenteve për 10,000 mjete në vite, nisur nga viti 1992 deri 2008, duke marrë për bazë numrin e mjeteve automobilistike të regjistruara nga Drejtoria e Përgjithshme Shërbimit të Transportit Rrugor dhe numrin e aksidenteve fatale të regjistruara nga Drejtoria e Policisë Rrugore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.



Burimi: Drejtoria e Policisë Rrugore (Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë)


Ndërmarrja e masave për reduktimin e vazhdueshëm të aksidenteve rrugore është themelore si dhe një detyrim për të gjitha vendet e Bashkimit Europian, të cilat, brenda vitit 2012 duhet të reduktojnë në 50% numrin e aksidenteve.

Kjo kërkon rishikimin e shpejtësisë së lëvizjes në qytete, dhe jashtë tyre; ndërtimin e rrugëve dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, pajisjen me sinjalistikë; vendosjen e radarëve dhe kamerave të kontrollit të shpejtësisë në akse qendrore e në kryqëzime, si dhe pajisjen me aparaturo për matjen e alkoolit.

### Treguesi: Numri i pasagjerëve

Në vendin tonë është krijuar një klimë e favorshme për zhvillimin e transportit ajror në përgjithësi dhe aviacionit civil në veçanti. Si rezultat i optimizimit të elementeve të dobishëm të transportit ajror si shpejtësia dhe komoditeti i lëvizjes, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve përpunuese në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” të Tiranës, gjatë vitit 2008 është shënuar një rritje e numrit të pasagjerëve prej rreth 13.8% krahasuar

me vitin 2007. Në figurën 10 paraqitet ecuria e numrit të pasagjerëve në aeroportin e Tiranës për periudhën 2005-2008.



Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit

Një rol të rëndësishëm në këtë zhvillim ka edhe modernizimi i administrimit të trafikut ajror përmes zbatimit të Master Planit të Trafikut Ajror. Projekti i Modernizimit të Hapësirës Ajrore të zbatuar nga Lockheed Martin ka ndikuar në rritjen e standardeve të sigurisë dhe kapaciteteve të Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror (ANTA) sh.a, duke sjellë dhe rritjen e numrit të fluturimeve mbi/për në hapësirën tonë në vlerën 12%, krahasuar me vitin 2007.

Shoqëria koncesionare TIA filloi punën gjatë vitit 2008 për zgjerimin e terminalit të pasagjerëve me një sipërfaqe rreth 5000 m<sup>2</sup> dhe me një vlerë investimi prej 20 milionë euro, në mënyrë që t'u hapë rrugë rritjeve të parashikuara në statistikat e transportit ajror në vend, si dhe për të lehtësuar ngarkesën në infrastrukturën ekzistuese. Gjatë vitit 2008, është rritur edhe numri i shoqërive ajrore që operojnë në aeroportin Nënë Tereza me 2 shoqëri, duke arritur në 13 shoqëri ajrore.

Është eksploruar futja në skemën e operimit të tre aeroporteve lokale, si rezultat i studimit të kryer në vitin 2007. Bëhet fjalë për aeroportin e Kukësit (aktualisht i gatshëm për operim), Vlorës (parashikuar rehabilitimi i aerodromit ekzistues) dhe Sarandës (vlerësuar si prioritet me mundësinë e dhënies me koncension). Synimi është që të ngrihet dhe të zhvillohet transporti i brendshëm ajror, i vlerësuar tashmë si domosdoshmëri.


Është ratifikuar marrëveshja<sup>6</sup> shumëpalëshe me BE-në dhe shtetet e rajonit, Bosnje-Hercgovinën, Bullgarinë, Serbinë, Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Islandën, Norvegjinë, Rumaninë, dhe Misionin Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Europian. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje shumëpalëshe është porta drejt integritimit në tregun e vetëm evropian të aviacionit, që ndihmon në zhvillimin ekonomik të vendit dhe finalizohet me hyrjen me të drejta të plota të Shqipërisë në Qiellin e Vetëm Europian.

Politikat në vijim do të përqendrohen në zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, përafrimin legjislacionit shqiptar me atë evropian; përmirësimin e sistemit rregullator, krijimin e enteve të reja në përputhje me *acquis communautaire* në fushën e transportit ajror; anëtarësimin në struktura ndërkombëtare dhe njohje ligjore të konventave të aviacionit.

6 Ligji nr.9658, datë 18.12.2006

## Treguesi: Koha mesatare e qëndrimit të anijes në port (sipas porteve)

Politikat në fushën e transportit detar janë përqendruar në rehabilitimin e infrastrukturës dhe superstrukturës portuale, në Portin e Durrësit, Portin e Vlorës dhe në portet e tjera. Gjithashtu, është synuar ristrukturimi, si edhe privatizimi i shërbimeve tregtare, duke i orientuar portet drejt një ekonomie tregu funksionale. Koha mesatare e qëndrimit të anijeve për të gjitha portet e vendit paraqitet në ulje, si rezultat i rritjes së kapaciteteve përpunuese dhe efektivitetit në përpunimin e anijeve (shih figurën 11).



Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit, Telekomunikacionit

Për vitin 2008, vëmendja është përqendruar në rehabilitimin e infrastrukturës dhe superstrukturës së Portit të Durrësit dhe Portit të Vlorës mbi bazën e Master Planeve, duke realizuar projekte konkrete me fonde të buxhetit dhe të donatorëve. Gjithashtu, gjatë vitit 2008 është realizuar Master Plani për portin e Durrësit me financim të Komisionit evropian.

Në portin e Durrësit filloi gjatë vitit 2008 ndërtimi i Terminalit të Pasagjerëve nga kompania sllovene SCT. Gjithashtu është hartuar projekti i detajuar dhe procedura përkatëse e tenderimit për rehabilitimin e kalatave 7-8, që do të financohet nga BEI, BERZH-i, KE-ja dhe Qeveria Shqiptare, me një financim prej rreth 40 milionë euro. Ndërkohë që Autoriteti Portual ka kryer përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë me të ardhurat e veta.

Në portin e Vlorës, me financim të Kooperacionit Italian (prej 15.3 milionë euro), filloi procedura për tenderin dhe rivlerësimin e projektit për ndërtimin e një kalate të re për përpunimin e mallrave, një kalate për përpunimin e trakteve dhe superstrukturën e nevojshme. Gjithashtu, për kompletimin e infrastrukturës dhe superstrukturës në portet e Shëngjinit e Sarandës, u përfunduan projektet e detajuara dhe dokumentet e tenderit, për ndërtimin e kalatës së re. Për portin e Shëngjinit, financimi është siguruar nga programi IPA dhe Qeveria shqiptare me rreth 3,6 milionë euro dhe në Portin e Sarandës për ndërtimin e kalatës për anijet e pasagjerëve, me një financim prej rreth 5 nga Banka Botërore. Gjatë vitit 2008 kanë filluar punimet për ndërtimin e dy porteve private për karburantin dhe gazin, si Porti i Petroliferës në Vlorë dhe Porti i Porto Romanos në Durrës.

Gjatë vitit 2008, një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së shkallës së sigurisë në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit) duke përmirësuar në vazhdimësi legjislacionin kombëtar në përputhje me kërkesat e Kodit të Sigurisë në Porte dhe Anije, si dhe direktivave e rezolutave të komunitetit evropian për rritjen e standardeve të sigurisë.


Në vijim, do të punohet për ngritjen e Kontrollit Shtetëror Portual, strukturë e cila do të krijojë kushtet konkrete për të bërë hapa progresive në përmirësimin dhe rritjen e vazhdueshme të sigurisë së anijeve me flamur shqiptar dhe standardin teknik të tyre në përputhje me kërkesat e konventave ndërkombëtare.

### 3.1.2 ENERGIJETIKA

#### Treguesi: Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike (GWh) sipas burimit

Në sajë të transformimit rrënjësor të sektorit, gjatë vitit 2008 u shënuan rezultate të rëndësishme. U miratua Modeli<sup>7</sup> Shqiptar i tregut dhe Kuadri Rregullator, që hedh bazat për reformimin dhe liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke lejuar funksionimin e tregut në kushtet e ekzistencës së operatorëve privatë në gjenerimin, shpërndarjen dhe në furnizimin e energjisë elektrike.

Në figurën 12 paraqitet energjia e prodhuar sipas burimeve termo dhe hidroelektrike, energjia në rrjet dhe mosfurnizimi i saj. Nga grafiku, shihet qartë sasia e energjisë në rrjet, e cila është rritur në 6298 GWh për vitin 2008, ndërkohë që prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2008 nga burimet vendase ka qenë 3 850 GWh. Humbjet e energjisë elektrike, përfshirë ato teknike dhe joteknike, në rrjetin e shpërndarjes, rezultojnë me një vleftë prej 1,927 GWh ose me 32.74%, pra me një reduktim prej 2.66%, krahasuar me vitin 2007, ndërsa humbjet e përgjithshme të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe ato në transmetim, për vitin 2008, rezultojnë me 2,140 GWh ose me 34%, pra me një reduktim prej 2.4%, krahasuar me vitin 2007



Burimi: KESH dhe OSSH

Në kuadër të liberalizimit të prodhimit të energjisë, u nënshkruan 69 kontrata koncesioni për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve me investitorë privatë vendas edhe të huaj si: ndërtimin e Hec-it të Ashtës (fuqi të instaluar afro 48.2 MWh, investim në rreth 130 milionë euro); projekti i kaskadës së Devollit (fuqi të instaluar 319 MWh, energji elektrike vjetore 985 400 MWh, vlerë investimi 950 milionë euro), etj. Gjithashtu, është miratuar ndërtimi i një parku energjetik në Porto Romano në Durrës, një infrastrukturë e domosdoshme kjo për zhvillimin e qëndrueshëm industrial dhe nevojave në rritje të ekonomisë për lëndë energjetike. Në kuadrin e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe përfshirjen e energjive të rinovueshme, janë licencuar 7 parqe të energjisë me erë. Hapa konkrete janë ndërmarrë për licencimin e kompanive private për ndërtimin e një parku energjetik me erë me një fuqi të instaluar prej 500 MWh, si dhe një park tjetër i kombinuar energji ere dhe biomase në Shëngjin.

Hapa të rëndësishme janë hedhur në sektorin e energjisë hidrokarbure, ku gjatë vitit 2008 është kryer miratimi i një kuadri të plotë rregullator për hidrokarburet, sipas direktivave të BE-së. Ky kuadër përfshin ngritjen e kapaciteteve të entit rregullator përkatës dhe ka krijuar terrenin e përshtatshëm për rritjen e prodhimit të hidrokarbureve dhe të investimeve të huaja për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit. Gjatë vitit 2008 ka vazhduar zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit nga kompani ndërkombëtare serioze. Investimet e realizuara për kërkimin dhe nxjerrjen e naftës dhe gazit për vitin 2008 janë rritur krahasuar me vitin 2007, nga 83.97 milionë dollarë amerikanë në 129 milionë dollarë amerikanë. Ndërkohë prodhimi i naftës bruto për vitin 2008 ka qenë 578 mijë ton naftë.

7 VKM Nr.338, datë 19.3.2008, "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike"

Gjatë vitit 2008 kanë filluar punimet, pasi është finalizuar marrëveshja e koncesionit me shoqërinë “La Petrolifera Italo Albanese” sh.a., për terminalin e naftës në Gjirin e Vlorës. Gjithashtu, është duke u realizuar marrëveshja me shoqërinë “Romano Port” sh.a., për ndërtimin e pontilit të naftës në Porto Romano. Gjatë vitit 2008 u privatizua shoqëria ARMO dhe përfundoi nënshkrimi i kontratës me kompaninë fituese “Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group”. Më tej, është nënshkruar kontrata për ngritjen e rigazifikatorit në Seman të Fierit, investim prej 950 milionë euro nga grupi “Falcione”. Në lidhje me parkun energjetik të Semanit është nënshkruar kontrata e koncesionit me “Trans European Energy BV”, për projektin e terminalit të Gazit Natyror të Lëngshëm në Fier dhe linjën e gazsjellësit nëndetar Shqipëri–Itali, me një investim prej 850 milionë euro.


Në përmbushje të objektivit për të konkretizuar lidhjen e vendit tonë me rrjetet rajonale të naftës dhe gazit është dhënë mbështetje maksimale për projektet madhore të gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) dhe gazsjellësit Jonian Adriatik (IAP), ku është arritur:

- Gazsjellësi IAP dhe gazsjellësi TAP janë përfshirë si pjesë e rrjetit të gazit të Ballkanit perëndimor (“Energy Community Ring”).
- Është nënshkruar në Zagreb në 25.09.2007 Deklarata Ministeriale mes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kroacisë për ndërtimin e gazsjellësit Jonian-Adriatik për lidhjen e rrjetit të gazit të Kroacisë me Shqipërinë.
- Është ratifikuar “Konventa Tri Palëshe Shqipëri-Maqedoni-Bullgari për projektin trans-ballkanik AMBO”.

### Treguesi: Konsumi energjetik krahasuar me PBB-në

Intensiteti energjetik tregon efikasitetin energjetik të ekonomisë së një vendi dhe llogaritet si njësi energjie për njësi PBB-je. Një intensitet i lartë tregon një çmim ose kosto të lartë të shndërrimit të energjisë në PBB. Gjatë vitit 2008, në sajë të politikave të ndjekura, të nivelit më të ulët të humbjeve si në transmetim, ashtu edhe në shpërndarje, si edhe të rritjes së PBB-së, vihet re një ulje e intensitetit të energjisë. Në figurën 13 tregohet se kjo ulje është në masën rreth 10,7%.

Në krahasim me vitin 2007, vihet re një rritje prej 108.8 Ktoe të konsumit final të burimeve energjetike, sidomos në burimet e hidrokarbureve dhe të energjisë elektrike. Konsumi final i energjisë elektrike (KFEE) për vitin 2008, në degët e ekonomisë ka qenë në vlerën 4,748 GWh. Treguesi i konsumit të energjisë elektrike për frymë të popullsisë për vitin 2008 (kwh/banor), rezultojnë 1,987.3 kwh/banor<sup>8</sup>. Totali i Konsumit Final të Burimeve Energjetike (TKFBE) për vitin 2008 ka rezultuar në 1,820.7 Ktoe, ku peshën kryesore të konsumit e ka patur sektori i transportit me afro 45% të konsumit dhe sektori i banesave me 25% të totalit të konsumit.



Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

<sup>8</sup> Burimi ERE: Popullsia me 1 Janar 2008 sipas Instat rezultojnë 3.170.048 banorë dhe pesha specifike e energjisë elektrike mbi PBB, e shprehur në %, e cila për vitin 2008 rezultojnë 1.46%.



Bazuar në Bilancin Energjetik për vitin 2008, rezulton që Totali i Produkteve Primare Energjetike (TPPE) ka qenë në nivelin 2,118.6 Ktoe, ku peshën kryesore e kanë mbajtur hidrokarburet me 62.5%, energjia elektrike me 25.2% dhe drutë e zjarrit 10%. Vihet re rritje e prodhimit vendas të energjisë elektrike, që për vitin 2008 përbën 60% të konsumit të përgjithshëm, ndaj 51.0% që përbënte në vitin 2007. Është rritur pesha e prodhimit vendas në bilancin e tregut energjetik (me burime energjetike me bazë hidrokarbure) me ritme më të larta se rritja e konsumit të këtyre burimeve energjetike. Gjatë vitit 2008 prodhimi vendas me hidrokarbure ka një rritje nga 564 Ktoe në vitin 2007 në 578 Ktoe në vitin 2008. Kjo ka sjellë edhe rritje të ardhurave të shtetit shqiptar, si palë në marrëveshjet hidrokarbure.

Në krahasim me vitin 2007, vihet re një ulje fare e lehtë e vetëplotësimit të nevojave me burime energjetike. Nga 39.2% në vitin 2008 krahasuar me 40.6% në vitin 2007. Importet në vitin 2007 kanë qenë në nivelin e 59.3% dhe për vitin 2008 rezulton të jetë në 60.7% që ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së lehtë të importit me burime hidrokarbure. Për sa i përket importit të energjisë elektrike, ka një ulje nga 243.2 Ktoe në vitin 2007 në 209.3 Ktoe në vitin 2008 dhe kjo ulje ka ardhur si rrjedhojë e rritjes së gjenerimit në vend të energjisë elektrike në vitin 2008.

Për të rritur ofertën energjetike në vend si edhe kapacitetet e transmetimit të energjisë, gjatë vitit 2008 ka vijuar puna për zbatimin e projekteve të investimeve për ndërtimin e veprave të rëndësishme energjetike me financim nga buxheti i shtetit dhe me financim të huaj si: (i) ndërtimi i TEC-it të Vlorës, me një fuqi të instaluar 97 MW dhe kosto të financimit të huaj 92 milionë euro; (ii) ndërtimi i HEC-it të Kalivaçit me fuqi të instaluar 93 MW dhe kosto 129 milionë euro; (iii) ndërtimi i linjës së interkoneksionit Tiranë-Podgoricë, pjesë e linjës 400 kV Elbasan-Podgoricë, që do të rrisë kapacitet transmetuese të energjisë elektrike me vendet fqinje dhe sigurinë e furnizimit; (iv) ndërtimi i linjës së interkoneksionit Elbasan-Tiranë, pjesë e linjës 400 kV të Elbasan-Podgoricë, me kosto të financimit të huaj është rreth 13 milionë euro; (v) përgatitja e projektit të ndërtimit të nënstacionit 400 kV Tirana 2, me kosto të financimit të huaj prej rreth 24.5 milionë euro. Ndërtimi i këtij nënstacioni do të rrisë kapacitetet transformuese, të transmetimit dhe shkëmbimit të energjisë elektrike; (vi) procedura e tenderimit për ndërtimin e Qendrës së Re Kombëtare Dispeçer, me kosto të huaj 22 milionë euro. Qendra Dispeçer do të mundësojë një monitorim dhe drejtim bashkëkohor të sistemit energjetik dhe është një nyje e rëndësishme në bashkëveprimin me vendet e rajonit. Ndërkohë, për rritjen e sigurisë së digave të HEC-eve të kaskadës së lumenjve Drin dhe Mat, ka filluar puna me financim të siguruar nga Banka Botërore prej 37 milionë dollarë amerikanë dhe po punohet për të siguruar dhe bashkëfinancues të tjerë. Gjithashtu, ka përfunduar studimi “Për përcaktimin e kapacitetit hidroenergjetik të lumenjve kryesorë të Shqipërisë, si Vjosa, Drini dhe Semani”.

Në vijim, politikat energjetike do të orientohen drejt fuqizimit dhe modernizimit të mëtejshëm të sistemit energjetik, duke e integruar në atë evropian. Gjithashtu, në qendër të vëmendjes do të jenë investimet në sistemin e prodhimit, interkoneksionit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike bazuar në kombinimin e fondeve publike dhe ato private shqiptare e të huaja. Më tej, do të promovohet përdorimi eficient i energjisë në përputhje me standardet evropiane, duke përmirësuar kuadrin ligjor dhe duke ngritur mekanizmat institucionale që garantojnë kursimin e përdorimit të energjisë.

### 3.1.3 FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET


**Treguesi: Mundësia e furnizimit me ujë, shprehur në përqindjen e familjeve që raportojnë se kanë ujë të rrjedhshëm në banesë, sipas nivelit të të ardhurave.**

Situata e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka pësuar zhvillim të mëtejshëm, si rezultat i investimeve në rritje për sektorin, të cilat gjatë vitit 2008 janë rritur me afro 32% krahasuar me vitin 2007. Për vitin 2008 vlera totale e investimeve në sektor kap një shifër prej 7.5 miliardë lekë, nga të cilat 3.5 miliardë lekë nga buxheti i shtetit dhe 4 miliardë lekë nga financimet e huaja. Financimi nga buxheti i shtetit në vitin 2008 është rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2007, sidomos për përgatitjen e projekteve të zbatimit për zonat turistike dhe zonat problematike. Përmendim projektet e hartuara: Shirokë-Zogaj, Velipojë, Shëngjin, Golem, Ksamil, Divjakë, Kukës, Has, Laç, Mamurras, Vlorë, Sukth, Vlorë, Kukës, etj. Për vitin 2008, si rezultat i investimeve të përfunduara, është zgjeruar rrjeti i ujësjellësit (kryesor e shpërndarës) me 47 km ose afërsisht 1% e gjatësisë totale të rrjetit.

Përveç zonave turistike një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe zonave problematike. Kështu është siguruar

financimi i një numri të madh projektsh me financim të buxhetit të shtetit për zonat, Has, Bajram Curri, Pukë, Malësi e Madhe, Peqin, Sukth, Vorë, si dhe Ujësjellës Kanalizime në Laç, Mamurras, Kënetë-Durrës, Kodër Marlekaj-Lezhë. Gjithashtu, një numër i madh projektsh janë financuar në kuadër të Grantit Konkurrues, ku përmendim rreth 41 objekte me kontrata të lidhura dhe 110 objekte të reja me një vlerë totale rreth 4.4 miliardë lekë, të financuara dhe realizuar 1.3 miliardë lekë dhe të financuara për vitin 2008 me një vlerë 1 miliardë lekë.

E rëndësishme është edhe puna e bërë në aspektin e trajtimit të ujërave të përdoruara, me qëllim jo vetëm përmirësimin e shërbimit të kanalizimeve, por edhe për të dhënë impakt pozitiv në mbrojtjen e ambientit. Gjatë vitit 2008 janë përfunduar dhe vënë në shfrytëzim tre impiante trajtimi në qytetet e Kavajës, Pogradecit dhe Vlorës. Popullsia që përfiton si rezultat i këtyre investimeve është: 55 mijë në Pogradec, 146 mijë banorë në qytetin e Vlorës dhe 92 mijë banorë në qytetin e Kavajës. Gjatë vitit 2008 kanë filluar punimet për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura në qytetin e Korçës i cili do t'i shërbejë rreth 85 mijë banorëve. Janë në proces gjithashtu ndërtimi i Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Zeza të qyteteve të Durrësit, Sarandës, Lezhës. Popullsia që do të përfitojë është rreth 437 mijë banorë.



Burimi: INSTAT, LSMS 2008

Treguesi i shpërndarjes së familjeve sipas kuintileve 9 (sipas pesë klasave) jep përqindjen apo numrin e familjeve me ujë të pijshëm në banesë, raportuar kundrejt numrit total të banesave përkatësisht në secilin prej kuintilive. Kuintilet e të ardhurave llogariten duke e renditur treguesin e të ardhurave për çdo familje në rend rritës dhe duke krijuar më pas pesë klasa (kuintile), ku secila përfshin 20% të familjeve. Në kuintilin e parë bëjnë pjesë 20% të familjeve me të ardhurat më të ulëta, ndërsa në kuintilin e pestë bëjnë pjesë 20% të familjeve me të ardhurat më të larta. Ky tregues i matur përmes LSMS për vitin 2008 paraqitet sipas figurës 14, ku edhe për 218.796 familjet me të ardhura më të larta vetëm 77.6% deklarojnë se kanë ujë në banesë. Sipas LSMS, përqindja e familjeve që deklarojnë se kanë ujë në banesë është gjithsej 71.2%, ndërsa përqindja e familjeve që kanë ujë të mirë për t'u pirë është 75.1%.


Shërbimi i kanalizimeve, që gjithashtu është trajtuar me prioritet, tregon trend rritës. Gjatë vitit 2008 popullsia që përfiton nga shërbimi i sistemeve të ujësjellësit është rritur me 1.3% ose 33,124 banorë në krahasim me vitin 2007 dhe i vlerësuar ky tregues nëpërmjet lidhjeve në sistemet e ujësjellësit, është rritur me 19,733 lidhje nga të cilat 15,125 lidhje i përkasin klientëve familjarë.

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të sigurt në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur, si dhe sigurimi i shërbimit të kanalizimeve për të gjithë popullsinë e vendit si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale, mbetet një ndër objektivat strategjike të Qeverisë Shqiptare. Për periudhën në vijim, do të jenë në qendër të vëmendjes investimet në ndërtimin dhe rehabilitimin e ujësjellësve dhe rrjetit të kanalizimeve, krahas rritjes së kapaciteteve menaxhuese për sektorin.



## Treguesi: Cilësia e furnizimit me ujë, e shprehur në përqindjen e kampioneve që dalin negative në testin për E. Coli dhe mbetje klori, të marra brenda një viti nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve

Ndotja e ujit të pijshëm, mund të shfaqë komplikacione në shëndetin e njeriut. Me qëllim monitorimin e përditshëm analitik mikrobiologjik (E. Coli) dhe fiziko-kimik, duke përfshirë kontrollin e klorifikimit të ujit të pijshëm në sistemin ujësjellës, janë ngritur laboratorët mikrobiologjikë dhe fiziko-kimikë nëpër rrethe. Numri i pikave të kontrollit është i vendosur në bazë të numrit të popullsisë së çdo qyteti dhe ka arritur në rreth 500 pika kontrolli, të shtrira në të gjithë rrjetin ujësjellës të brendshëm. Përqindja e kampioneve të marra brenda një viti nga 54 ndërmarrjet e ujësjellësit që dalin negative në testin për E.Coli dhe mbetje klori është dhënë në grafikun e mëposhtëm:



Burimi: MPPTT, DP Ujësjellës dhe Kanalizimeve, Njësia për Monitorim dhe Standardizim


Siç paraqitet edhe figurën 15, cilësia e ujit e vlerësuar me pikë paraqet përmirësim për përmbajtjen e E.Coli, ndërkohë që nuk paraqet përmirësim për mbetjet e klorit. Kjo për shkak të problematikës së ujësjellësve në lidhje me amortizimet e rrjetit ujësjellës dhe kanalizimeve; vështirësitë për identifikimin e defekteve të mundshme që shfaqen në rrjete; ndërhyrjet në rrjetin ujësjellës nga persona të paautorizuar; ekzistencën e sistemeve të papërshtatshme të klorinimit të ujit; etj. Në këtë kontekst, kontrolli dhe monitorimi i sigurisë dhe cilësisë së ujit të pijshëm mbetet një sfidë kryesore e shërbimeve të shëndetit publik, për marrjen e masave në vazhdimësi. Nevojitet një koordinim më i mirë midis strukturave të pushtetit vendor, ndërmarrjeve të ujësjellësve dhe atyre të shëndetit publik, me qëllim sigurimin me ujë të pijshëm, cilësisht të pastër dhe të vazhdueshëm të popullatës.

### 3.1.4 MJEDISI

#### Treguesi: Përqendrimi mesatar vjetor në 4 qytete të 3 ndotësve të ajrit: PM10 (grimcat e imta); SO2 (dioksidi i sulfurit); dhe NO2 (dioksidi i azotit) Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Cilësia e ajrit ( $\mu\text{g}/\text{m}^3$ )

Në periudhën 2005-2008, janë arritur një sërë rezultatesh pozitive të paraqitura edhe nga organizmat ndërkombëtare. Shqipëria është renditur në vendin e 25 në botë (ndër 149 vende) për performancën e saj mjedisore. Në zbatimin e reformave dhe politikave mjedisore është patur parasysh ecuria dhe roli i tyre në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke ruajtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, si dhe duke promovuar vlerat mjedisore. Ndërmarrja e politikave për uljen e çlirimit të gazeve nga burimet kryesore ndotëse, si edhe forcimi i legjislacionit në këtë fushë përbëjnë një hap të rëndësishëm në përmirësimin dhe në ndryshimin e ndjeshëm të cilësisë së ajrit.

Figura 16. Përqëndrimi i gazrave të përzgjedhur ndotës



Burimi: Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve

Monitorimi i cilësisë së ajrit i kryer në zonat urbane më të populluara, ku janë matur 6 indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, (PM10, LNP, NO2, SO2, O3, Pb) tregon se Shqipëria është një vend me ajër përgjithësisht të pastër. Sipas treguesit të mësipërm, është marrë parasysh monitorimi i 3 ndotësve të ajrit në 4 qytetet më kryesore. Në bazë të të dhënave të monitorimit, ajri rezultoi i pastër për treguesit SO2, NO2, të cilët rezultojnë brenda normave të lejuara të standardit shqiptar dhe të BE-së, në të gjitha stacionet dhe qytetet e monitoruara. Në lidhje me gjendjen e pluhurave në ajrin urban, vihet re tendenca në ulje e përmbajtjes së tyre.

Gjatë vitit 2008, përmbajtja e pluhurave në ajrin urban PM10 (grimca nën 10 mikron) paraqet përmirësim të dukshëm në krahasim me vitin 2007, pasi në 4 stacione (nga 2 në 2007) përmbajtja e PM10 rezultoi brenda normave të standardit shqiptar dhe 2 prej tyre plotësojnë normën e BE-së. Në Tiranë, në stacionin e kryqëzimit M. Q. Atatürk, megjithëse tejkalohet norma, ka përmirësim të ndjeshëm, pasi përmbajtja e PM10 është ulur 3 herë në krahasim me vitin 2007. Bazuar në të dhënat e monitorimit, në Elbasan ka gjithashtu përmirësim progresiv të cilësisë së ajrit urban, pasi në stacionin në qendër të qytetit vlera e PM10 në 2008 rezultoi brenda normës shqiptare. Në Shkodër dhe Durrës përmbajtja e PM10 është pothuajse në të njëjtat nivele, si gjatë vitit 2007.

Në lidhje me forcimin e Sistemit të monitorimit të mjedisit vëmendje i është kushtuar rritjes së kapaciteteve për monitorimin dhe formulimin e politikave dhe masave për të parandaluar degradimin dhe ndotjen e mjedisit. Për këtë janë bërë punime rehabilituese në Rafinerinë e Naftës në Ballsh dhe synohet të reduktohet ndotja dhe rreziku në pikën e nxehtë mjedisore.

## 3.2 Ekonomia e tregut

Vazhdimi dhe konsolidimi i masave të ndërmarra gjatë vitit 2008 ka bërë që vendi të karakterizohet nga një rritje ekonomike e qëndrueshme rreth 7 – 8%, duke çuar në liri tregu të kombinuar me reforma ambicioze, inflacion të ulët dhe stabilitet makro-ekonomik.

Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e favorizuar nga konsolidimi i qëndrueshmërisë makro-ekonomike dhe nga efektet pozitive të një sërë reformash strukturore. Inflacioni mbetet brenda kufijve 2-4%, ndërkohë që kursi real i këmbimit është rreth ekuilibrit të tij. Pavarësisht nga lëvizjet e kërkesës dhe ofertës të gjeneruara respektivisht nga rritja e shpejtë e kredisë, dhe nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare të mallrave, është bërë e mundur mbajtja e ekuilibrave të brendshëm dhe të jashtëm të ekonomisë. Kryesisht është arritur një përmirësim dhe rritje e prodhimit industrial, atij bujqësor e të shërbimeve, rritje e eksporteve dhe e investimeve të huaja direkte.

Pozicioni i përgjithshëm fiskal mbetet i qëndrueshëm, duke pasqyruar një harmonizim të përshtatshëm me politikën e tjera makro-financiare dhe në veçanti me politikën monetare. Rritja e fondeve publike në vitin 2008, të orientuara kryesisht drejt projekteve publike në infrastrukturë, sjellin efekte pozitive në rritjen e produktivitetit e uljen e kostove të prodhimit dhe të tregtisë.

Ecuria tepër e mirë e të ardhurave fiskale, kohëzgjatja e maturimit të borxhit të brendshëm, suksesi në privatizimin e asetëve publike si dhe reduktimi sistematik i deficitit buxhetor të financuar me burime të brendshme, ka bërë që presionet e politikës fiskale mbi kërkesën e brendshme, mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve dhe mbi tregun e brendshëm financiar të jenë të moderuara.

Të ardhurat e buxhetit janë rritur në mënyrë progresive duke arritur në 26.8% të PPB në vitin 2008, krahasuar me 25.1% e PPB-së në vitin 2005, si pasojë e reformës fiskale, taksës së sheshtë, uljes së masës së sigurimeve shoqërore, etj. Reformat fiskale të ndërmarra, sikundër edhe implementimi i sistemeve elektronike për taksat, kanë bërë që sistemi tatimor në Shqipëri të jetë më lehtësues dhe nxitës për zhvillimin e biznesit krahasuar me vendet e rajonit si dhe kanë dhënë efekte pozitive në uljen e evazionit fiskal dhe luftën kundër korrupsionit. Nxitja e biznesit nëpërmjet politikave lehtësuese fiskale e administrative ka ndihmuar në performancën e tij. Në aspektin administrativ tatimor, zhvillimet më të rëndësishme lidhen me miratimin e ligjit të ri për procedurat tatimore. Ky ligj i ri ka përshtatur praktikën më të mira ndërkombëtare të procedurave tatimore me kushtet dhe rrethanat e vendit tonë, duke synuar reduktimin e informalitetit dhe përmirësimin e klimës për biznesin. Në dogana, është kompletuar zbatimi i plotë i sistemit doganor ASYCUDA WORLD, i cili ndihmon në modernizimin dhe thjeshtimin e procedurave.

Rritja e investimeve të huaja direkte është e pranishme në sektorin e energjisë, të industrisë së materialeve, të infrastrukturës, të sektorit të manifakturës, të sektorit bankar si dhe në atë të sigurimeve. Reformat e ndërmarra për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri janë mbështetur në: ngritjen dhe funksionimin e suksesshëm të QKR-së, miratimin e 6 parqeve industriale, implementimin e pagesës elektronike të taksave on-line, prokurimit elektronik, thjeshtimin e ndjeshëm të lejeve dhe licencave.

Privatizimi i suksesshëm i ARMO-s dhe stadi i avancuar në privatizimin e OSSH-së, privatizimi i AMC-së, përbëjnë reforma të suksesshme strukturore të qeverisë.

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë dhe rezultate janë arritur në lidhje me integrimin e tregut të Shqipërisë me BE-në, për shkak të politikave të hapjes dhe implementimit të suksesshëm të MSA dhe CEFTES, duke sjellë intensifikimin e shkëmbimeve tregtare midis vendeve të rajonit. Diversifikimi i eksporteve shqiptare gjatë vitit të fundit, si ne produkte ashtu edhe në tregje të reja, ka rritur vëllimin e tyre, duke bërë që edhe kërkesa e huaj të ketë një impakt të konsiderueshëm në rritjen ekonomike të vendit.

**TREGUESIT KRYESORE MAKRO-EKONOMIKE**

Treguesit	Njësia	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Popullsia	milion	3.08	3.10	3.12	3.13	3.15	3.16	3.17
Inflacioni (mesatar)	%	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9	3.4
Kursi i Këmbimit	Lekë/USD	140.2	121.9	102.8	99.9	98.1	90.4	83.9
	Lekë/Euro	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6	122.8
<b>Produkti</b>								
PBB	miliard Lekë	622.7	694.1	750.8	814.8	882.2	971.2	1085.7
Rritja reale e PBB-së	%	4.2	5.8	5.7	5.8	5.4	6.0	8.0
PBB për banor	mijë Lekë	201.3	223.1	240.1	259.9	280.1	307.2	342.7
<b>Financat Publike</b>								
Të ardhurat totale	% të PBB	24.8	24.1	24.6	25.1	26.0	25.9	26.8
Shpenzimet totale	% të PBB	30.9	29.0	29.6	28.5	29.3	29.4	32.4
Shpenzimet kapitale	% të PBB	6.1	4.5	5.1	4.7	5.8	5.9	8.6
Deficiti i përgjithshëm	% të PBB	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5
Borxhi publik total	% të PBB	62.8	58.8	56.5	57.4	56.1	53.2	54.9
Borxhi i brendshëm	% të PBB	41.9	40.5	39.3	40.2	39.6	38.0	36.9
Borxhi i jashtëm	% të PBB	21.0	18.4	17.2	17.3	16.5	15.2	18.0
<b>Bilanci i Pagesave</b>								
Bilanci tregtar	% të PBB	-26.0	-23.5	-21.7	-22.5	-23.1	-26.8	-27.5
Eksportet	% të PBB	7.4	7.9	8.3	8.1	8.8	10.0	10.4
Rritja e eksporteve	%	5.9	17.7	13.8	6.3	17.7	25.5	15.6
Importet	% të PBB	-33.4	-31.3	-30.0	-30.6	-31.9	-36.9	-37.9
Rritja e importeve	%	9.0	4.4	3.6	10.8	12.9	27.1	14.8
Transfertat	% të PBB	14.1	15.3	14.3	13.7	14.1	13.3	10.6
Bilanci i llogarisë korente	% të PBB	-9.5	-7.0	-5.8	-9.0	-6.6	-10.6	-14.9
Investimet e huaja direkte	% të PBB	3.0	3.1	4.6	3.2	3.5	6.0	6.7
Bilanci i pagesave	% të PBB	0.6	1.8	4.0	1.9	2.9	1.9	2.2


Burimi: Drejtoria e Makroekonomisë, Ministria e Financave

### 3.2.1 FINANCAT PUBLIKE

#### Treguesi: Inflacioni-bilanci i pagesave të dhëna nga politikat fiskale

Sipas BSH-së, inflacioni mesatar vjetor gjatë vitit 2008 shënoi vlerën 3.4%, rreth 0.4% më i lartë se në vitin 2007, si rezultat i rritjes së inflacionit bazë në nivelin 2.8% gjatë periudhës 2008, kundrejt 1.3% (në vitin 2007). Inflacioni vjetor gjatë vitit 2008 arriti 4.6% në muajin mars 2008, në 2.2 në fund të vitit 2008. Gjysma e parë e vitit 2008 rezultoi me norma të larta inflacioni falë ndikimit të rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe të naftës në tregun botëror. Çmimet në vend u ndikuan nga kufizimet në ofertën vendase të prodhimeve bujqësore të vitit të kaluar si dhe gjysmës së parë të vitit 2008 dhe nga rritja e çmimit të energjisë, në muajin mars'08. Kombinimi i këtyre zhvillimeve në tregun vendas me atë ndërkombëtare u reflektuan plotësisht në çmimet e konsumit, në kushtet e rritjes së vazhduar të kërkesës për këto produkte.

Figura 17. Ecuria e inflacionit gjatë viteve 2007-2008



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT


Ecuria e normës së inflacionit gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2008, pasqyroi efektin global të rënies të çmimeve të mallrave të përdorimit të gjerë (kryesisht atyre ushqimorë dhe karburanteve), si dhe një situatë të favorshme çmimesh për mallrat dhe shërbimet në tregun vendas, si rezultat i mbulimit të kërkesës për to me një ofertë gjithnjë në rritje. Në përgjithësi, pjesa e dytë e vitit 2008 është karakterizuar nga norma vjetore të inflacionit relativisht më të ulëta në të gjitha kategoritë që ndikuan në rritjen e lartë të çmimeve gjatë pjesës së parë të vitit.

Ulja e normës së inflacionit gjatë kësaj periudhe qe rrjedhojë e lehtësimit të presioneve inflacioniste të gjeneruara nga ambienti i jashtëm si dhe i kushteve monetare të përshtatshme për të plotësuar nevojat e ekonomisë. Gjithashtu, realizimi i shpenzimeve publike në përputhje me programin buxhetor, kontribuoi në mosgjenerimin e presioneve të mëtejshme inflacioniste. Në të njëjtën kohë, rivendosja e balancave nga ana e ofertës – rënia e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare dhe oferta vendase në treg për prodhimet bujqësore – krahas shtrëngimit të standardeve të kredihënies, dëshmuar se balancat makro-ekonomike në vend dhe kushtet monetare ishin të përshtatshme për të garantuar një normë inflacioni afër objektivit të synuar prej 3 përqind për vitin 2008, me një luhatshmëri prej  $\pm 1\%$ .

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave për vitin 2008, *bilanci i përgjithshëm i pagesave* regjistroi një rritje të mjeteve të rezervës valutore me 192 milionë euro, duke regjistruar një deficit të llogarisë korente prej 1,319 milionë euro, ose rreth -14.9 % të PBB-së. Në krahasim me vitin 2007, deficitin regjistroi një rritje prej rreth 489 milionë eurosh, nga 831 milionë euro në 2007. Deficiti i tregtisë së mallrave u thellua me 327 milionë euro gjatë vitit 2008, duke arritur në 2,431 milionë euro nga 2,104 milionë euro. Flukset hyrëse të kapitalit regjistruan vlerën 1,533 duke financuar plotësisht deficitin korent. Hyrjet në formën e investimeve të huaja direkte në ekonominë shqiptare (653.2 milionë euro), ishin një faktor dominues në rritjen e detyrimeve financiare të vendit. Këtë vit këto investime kanë hyrë kryesisht si investime në sektorin financiar dhe si kapital nga privatizimi.

## Treguesi: Raporti i borxhit të brendshëm ndaj PBB-së, krahasuar me vendet e Evropës Juglindore

Në planin ekonomik global, viti 2008 ishte një vit i të papriturave të mëdha, një vit me kthesa të rëndësishme ekonomike për shumë shtete, si të mëdha ashtu edhe të vogla dhe një vit ku gati të gjitha bankat qendrore në mbarë botën u ballafaquan me sfida të ndryshme, sidomos veçanërisht me ruajtjen e stabilitetit financiar. Efektet e krizës financiare globale u ndjenë pashmangshmërisht gati njësoj në çdo shtet të Evropës Perëndimore dhe asaj Lindore.



Burimi: Ministria e Financës

Në Shqipëri, stoku i borxhit publik në fund të vitit 2008 është vlerësuar në 54,64% e PBB-së. Në përbërjen e këtij stoku përfshihen borxhi me instrumenta financiare 36,73% e PBB si dhe borxhi me financime të huaja 17,91% e PBB. Përbërja e stokut të borxhit publik është: borxhi i brendshëm me instrumenta financiare, 67,22% dhe borxhi i kontraktuar për financimin e projekteve, 32,78%

Në figurën 18 paraqiten vlerat e borxhit të brendshëm të disa nga shteteve fqinje me Shqipërinë. Në vendin tonë, borxhi afatshkurtër në fund të vitit 2008 përbënte 55,99% të totalit të borxhit të brendshëm krahasuar me 62,84% në vitin 2007 ndërsa borxhi afatgjatë u rrit në 36,14% të totalit krahasuar me 32,9% një vit më parë.

Borxhi në vitin 2008 ka pësuar rritje në segmentin e borxhit të jashtëm me 2,9% krahasuar me një vit më parë, ndërsa borxhi i brendshëm është ulur me 0,90%. Kjo rritje është rezultat i ecursisë pozitive të disbursimeve për projektet me financim të huaj si dhe i investimeve të një niveli të lartë në infrastrukturën rrugore të vendit. Ky është një tregues pozitiv i përmirësimit të menaxhimit në zbatimin e projekteve të huaja, duke çuar në rritjen e performancës së realizimit dhe uljen e kostos së tyre, si rrjedhim i shkurtimeve të periudhës së implementimit të projekteve. Nëpërmjet borxhit të jashtëm janë investuar projekte parësore në arsim, infrastrukturë, energji, dhe ujësjellës-kanalizime

Politika e emetimeve gjatë vitit 2008 ka qenë në linjë me strategjinë e borxhit për vitet 2008-2010 e cila synon të ulë peshën specifike të instrumentave afatshkurtër dhe të rrisë peshën specifike të instrumentave afatgjatë. Kjo politikë synon që të minimizojë riskun e rifinancimit dhe të normave të interesit. Bankat vazhdojnë të jenë mbajtëset kryesore të portofolit të letrave me vlerë të qeverisë ndërkohë që pjesëmarrja e individëve në tregun primar të bonove dhe obligacioneve ka qenë në rritje, krahasuar me vitin 2007, duke theksuar një pjesëmarrje të lartë në ankandet e bonove të thesarit.

Përsa i përket shërbimit të borxhit (pa ripagesat), në fund të vitit 2008 ky tregues kapi nivelin 2.87% e PBB-së krahasuar me 2.62% në vitin 2007. Rritja e shërbimit të borxhit të jashtëm ka qenë rezultat i rritjes së disbursimeve për realizimin e financimit të veprave të rëndësishme publike, si dhe rritja e numrit të kredive të reja me interesa tregtare. Përsa i përket borxhit të brendshëm, shërbimi i tij është rritur si rezultat i rritjes së fitimit nga emetimet gjatë 2008 si dhe rritjes së peshës specifike të instrumentave afatgjatë, të cilat emetohen


me norma më të larta interesi. Në raport me eksportet, treguesi i interesave të borxhit për vitin 2008 është në nivelin 28.73% krahasuar me 26.21% në vitin 2007, ndërsa shërbimi i borxhit ( përfshirë ripagesat) është 32.63% krahasuar me 30.42%.

### 3.2.2 EKONOMIA

#### Treguesi: Investimet e huaja direkte për frymë, krahasuar me vendet e EJL (euro)

Fluksi neto i investimeve të huaja direkte (IHD) gjatë vitit 2008 ka pësuar një rritje të ndjeshme. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, nga 647.4 milionë dollarë në vitin 2007, në vitin 2008 fluksi neto i IHD-ve ka arritur në mbi 843 milionë dollarë, duke shënuar një rritje mëse 30%. Përsa i përket fluksit hyrës të IHD-ve në vend, rritja ka qenë akoma më e lartë (rreth 42%), duke arritur në shifrën 937 milionë dollarë. Në vitin 2008 fluksi hyrës ka arritur në 6.8 % të PBB, kurse në vitin 2007 ishte vetëm 6 %.

Në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore Shqipëria ka patur rritje ndërsa të gjitha vendet e tjera (përveç Serbisë dhe Malit të Zi) kanë një ulje të investimeve të huaja në vitin 2008 në krahasim me 2007.



Burimi: Raporti i Tranzicionit i BERZH, vitet 2003-2008

Investimet e huaja direkte për frymë janë rritur me rreth 35% dhe kanë arritur në 275 dollarë për frymë nga 204 dollarë që kanë qenë në 2007. Një rol të rëndësishëm në rritjen e fluksit ka patur përmirësimi i ndjeshëm i klimës së biznesit, aktivitetet promovuese, privatizimet në sektorët strategjikë, si edhe zbatimi i kontratave koncesionare në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Në lidhje me privatizimet kyçe për ekonominë, përmendim: (i) privatizimin e OSSH-së nga kompania çeke CEZ me një vlerë prej 102 milionë euro; (ii) privatizimi i aksioneve shtetërore të AMC me një çmim prej 48 milionë euro, ose 4 herë më e lartë sesa çmimi fillestar i shitjes së AMC-së; (iii) privatizimi i shoqërisë ARMO nga Refinery Associates of Texas, Anica Enterprises & Mercuria Energy Group prej 127,8 milion eurosh; (iv) privatizimi i Albtelekomit, duke rinegociuar thëllësisht kontratën dhe maksimizuar fitimin në 70 milionë dollarë amerikanë të ardhura në buxhet; (v) privatizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke sjellë të ardhura për shtetin për vitin 2008 në 1 miliardë lekë.

Me ndikim të rëndësishëm kanë qenë edhe kontratat koncesionare të lidhura sidomos në sektorin e energjetikës, ku përmendim HEC-et në kaskadën e lumit Devoll me vlerë investimi 950 milionë euro, hidrocentralin e Ashtës me investim në rreth 130 milionë euro; 28 projekte për HEC-e të vegjël, me vlerë investimi mbi 53 miliardë lekë, etj. Është përmirësuar ndjeshëm imazhi i Shqipërisë, ku rol ka luajtur edhe funksionimi i plotë i Agjencisë Shqiptare për Biznesin dhe Investimet Albinvest). Përmirësimi të ambientit rregullator për biznesin i ka shërbyer hartimi i legjislacionit përkatës, si: Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare; Ligji “Për




koncesionet”, Ligji për Zhvillimin e Zonave Ekonomike; Ligji për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë; Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit; Ligji për Lejet Licencat dhe Autorizimet në Republikën e Shqipërisë (QKL), etj.

Investimet e huaja direkte pritet të marrin hov edhe si rezultat i miratimit nga qeveria të 6 parqeve industriale, përkatësisht në Spitallë/Durrës, Shëngjin/Lezhë, Koplík/Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër, ku synohet thithja e investimeve për një vlerë rreth 55 milionë euro, si dhe krijimi i mbi 30,000 vendeve të reja pune.

### Treguesi: Shumëllojshmëria e eksporteve. Pjesa e katër sektorëve (tekstile, këpucë, metale dhe minerale) në totalin e eksporteve

Eksportet e mallrave kanë rezultuar me një rritje gjatë periudhës 2007-2008, ku viti 2008 paraqet një rritje 15.8% ndaj 2007, ndërsa rritja në vitin 2007 arriti në 25.5%. Treguesit e tregtisë së mallrave me jashtë të Shqipërisë, në vijueshmëri përgjatë viteve të fundit, kanë rezultuar me rritje, ku volumi i mallrave në vitin 2007 ka qenë me një rritje prej 25.8% ndaj 2006 dhe për 2008 me një rritje prej 16.5% kundrejt vitit 2007. Përbërja e volumit tregtar është thuajse e njëjtë për të dy vitet e fundit, përkatësisht 20.4% eksporte dhe 79.6% importe..



Burimi: METE

Të dhënat e figurës 20 tregojnë ecurinë e eksportit të katër sektorëve më të rëndësishëm në totalin e eksporteve për periudhën 2005-2008. Gjatë kësaj periudhe vërehet një rritje e peshës specifike edhe të eksporteve me origjinë të pastër të ekonomisë shqiptare, ku grupet “minerale, lëndë djegëse”, rezultojnë me rritje nga 15.4% në 2007 në 18.1% në 2008 dhe “materiale ndërtimi dhe metale” të cilat kanë përbërë 16.1% të totalit të eksporteve në vitin 2007 arritën në 20.3% të eksporteve për vitin 2008. Eksporti me material porositësi (fason), që përmbledh grupin “tekstile, artikuj tekstile-konfeksione”, “veshjet e këmbëve-këpucaria, lëkurët e artikujt prej saj”, vazhdojnë të dominojnë eksportet e mallrave edhe për periudhën 2007-2008, përkatësisht duke përbërë 50.5% të totalit të eksporteve në vitin 2007 dhe 44.9% në vitin 2008.


Tendencat në rritjen e eksporteve në 3 vitet e fundit sipas treguesve absolutë në euro, paraqitet me një rritje mesatare vjetore prej 21.3% duke arritur në fund të vitit 2008 në 916.4 milionë euro. Ndërsa vetëm eksportet “Made in Albania” të ekonomisë shqiptare rezultojnë me një rritje mesatare vjetore prej 35% gjatë 2005-2009, duke arritur në fund të vitit 2008 në 368 milionë euro ose 40% e totalit të eksporteve nga 29.6% që ka zënë në vitin 2005.

Në nxitjen e eksporteve ndikojnë politikat e ndjekura për mbështetjen e SME-ve, ku përmendim ngritjen dhe funksionimin e Fondit të Garantimit të Kredive për Eksport, në një vlerë prej 200 milionë lekë, i cili do të vazhdojë të përdoret për një periudhë kohore prej 6 vjetësh. Ndërkohë, rol ka luajtur edhe granti për rritjen e konkurrueshmërisë së SME-ve që menaxhohet nga Albinvest.



## Treguesi: Pengesat administrative. Renditja në raportin ‘Si të Bësh Biznes’ (sipas treguesve krahasuar me vendet e EJL-së)

Në figurën 21 tregohet renditja e Shqipërisë për periudhën 2006-2009 sipas Raportit “Të bësh Biznes” të Bankës Botërore, krahasuar me vendet e rajonit. Kjo anketë zhvillohet çdo vit në rreth 180 vende të botës dhe pasqyron ecurinë e reformave për krijimin e një klime të favorshme biznesi. Shihet ecuria mjaft pozitive e Shqipërisë, që për anketimin e kryer në vitin 2008 renditet në vendin e 86-të (nga 181 vende të analizuara) kundrejt vendit të 136-të që renditej një vit më parë, duke u ngjitur me 50 vende më sipër. Sipas raportit përparime të dukshme janë kryer në disa fusha, si p.sh. mbrojtja e investitorëve, hapja e një biznesi, licencimi i një biznesi, marrja e kredisë, tregtia ndërkuftare, punësimi në një biznes privat. Fushat ku paraqitemi më dobët janë: pagesa e taksave apo marrja e një leje ndërtimi. Qeveria ka ndërmarrë projekte të rëndësishme për dixhitalizimin e sistemit të tatim-taksave, krijimin e regjistrimit elektronik për lejet e ndërtimit, si edhe thjeshtimin e procedurave të lejeve të ndërtimit sipas projektligjit të ri të miratuar nga qeveria dhe të dërguar për miratim në parlament.



Burimi: “Të bësh Biznes”, Banka Botërore 2009

Në fushën e reduktimit të barrierave administrative në biznes dhe përmirësimit të sistemit të licencimit, ndikimin më të madh e ka patur funksionimi i plotë i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit QKR, e cila operon si shërbim-me-një ndalesë duke qenë pranë operatorëve ekonomikë. Kjo reformë ka bërë të mundur regjistrimin e biznesit në 1 ditë, me një ndalesë, me kosto minimale prej 100 lekë. Gjithashtu, vendi ka shënuar përparim në reduktimin e kohës për hapjen e një biznesi të ri në 5 hapa nga 10 hapa që nevojiteshin një vit më parë dhe vetëm 5 ditë nga 36 ditë që nevojiteshin në 2007, gjë e cila është shoqëruar edhe me reduktimin e koston së hapjes së një biznesi. Është thjeshtuar më tej sistemi dhe procedurat e licencimit, duke çuar në eliminimin drastik të numrit të licencave me 104 licenca më pak nga 166 licenca për vitin 2007. Në muajin korrik 2008 filloi procesi për ngritjen e Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) sipas modelit të zyrës me një ndalesë, duke synuar thjeshtëzimin dhe qartësimin e procedurave, standardeve dhe kriterëve për marrjen e licencës/lejes; rritjen e efikasitetit të procesimit dhe të transparencës nëpërmjet teknologjisë së informimit e komunikimit; përfshirjen e parimit të pranimit në heshtje.

Referuar raportit “Të bësh Biznes” të Bankës Botërore, në fushën e kreditimit të sektorit privat, Shqipëria renditet në vendin e 12-të në botë për lehtësirat në marrjen e kredisë. Gjatë vitit 2008, sipas Bankës së Shqipërisë, kreditimi i sektorit privat është rritur me rreth 35% në krahasim me vitin 2007. Portofoli i kredisë deri në fund të vitit 2008 ka arritur në 36% të GDP, me një rritje prej 7 pikë përqindje në krahasim me fundin e vitit 2007. Portofoli i kredisë në fund të vitit 2008 ka arritur në 43% të aktiveve. Sipas “Të bësh Biznes 2009”, për mbrojtjen e investitorëve Shqipëria renditet në vendin e 14-të nga pozicionimi në vendin e 168-të një vit më parë. Ky përmirësim i rëndësishëm ka ardhur si rezultat i reformës në fushën e legjislacionit tregtar, duke

hartuar dhe miratuar Ligjin<sup>9</sup> “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i cili siguron një kuadër ligjor bashkëkohor, të thjeshtë, të qartë dhe të përditësuar për shoqëritë tregtare.

### 3.2.3 MBROJTJA E KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

#### **Treguesi: Plotësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e konsumatorit**

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit ka synuar përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së. Vlen për t’u përmendur miratimi i ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si edhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, si dhe një sërë rregullash teknike për grupe të ndryshme produktesh, që kane si qëllim eliminimin e barrierave teknike në kuadër të lëvizjes së lirë të mallrave, duke siguruar në të njëjtën kohë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve.

Gjatë vitit 2008, është punuar edhe për krijimin e kuadrit të përshtatshëm institucional për mbrojtjen e konsumatorëve, si ngritja e Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve, me përfaqësues të ministrive të linjës të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve, organizatave jofitimprurëse dhe shoqatave të biznesit.

Në lidhje me sigurinë e produkteve industriale në treg, janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga Inspektoriati Qendror Teknik për shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut fillimisht të fokusuar në katër qytete kryesore (Tiranë, Durrës, Fier, Shkodër) dhe më tej të shtrira në qytetet kryesore në Jug të Shqipërisë, duke kontribuar në këtë mënyrë edhe për shndërrimin e këtij inspektoriati në një strukturë efikase të mbikëqyrjes së tregut sipas konceptit evropian. Në të njëjtën kohë, në lidhje me tërheqjen nga tregu të produkteve të rrezikshme janë koordinuar aktivitetet nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut në METE, me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Inspektoratin Qendror Teknik. Megjithatë, duhet patur parasysh se siguria e produkteve industriale për konsumatorët dhe mbikëqyrja e tregut janë koncepte relativisht të reja për realitetin shqiptar, si në aspektin ligjor edhe atë institucional, ende ka mjaft për të bërë që konsumatorët shqiptarë të ndjehen të mbrojtur dhe të sigurt. Në mbështetje të kësaj, për periudhën në vijim vëmendja do të përqendrohet veçanërisht në drejtim të implementimit të kuadrit ligjor.

Në lidhje me sigurinë ushqimore, janë zhvilluar mbi 33 mijë kontrole të ushtruara në 12 qarqet e vendit. Gjithashtu, janë hartuar dhe zbatuar programe kombëtare të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve e parazitëve në bimë, programe të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore; monitorimin e ujërave e molusqeve bivalve; vendosjen në shkallë kombëtare të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave e forcimit të karantinës veterinarë e fitosanitare; përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve. Është fuqizuar më tej rrjeti laboratorik dhe është punuar në drejtim të (i)ngritjes së nivelit profesional të stafit veterinar, (ii)shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe sigurisë ushqimore; (iii)vendosjes së sistemit të vetëkontrollit dhe gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore; (iv)ngritjes së sistemit RAPID ALERT dhe futjen e tij në rrjetin evropian si dhe (v)informimit në kohë të konsumatorit.

Më tej, është planifikuar të ngrihet brenda vitit 2009, me mbështetjen e projektit të BE-së, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit si institucioni i vetëm përgjegjës me të gjitha kompetencat dhe infrastrukturën e nevojshme për kontrollin e tregut dhe garantimin e sigurisë ushqimore në vend. Në periudhën në vijim prioritet do të mbeten laboratorët e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, si edhe identifikimi dhe regjistrimi i plotë i blegtorisë në vend.


### 3.2.4 TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

#### **Treguesi: Gadishmëria elektronike**

Mbi bazën e të dhënave mbi gatishmërinë e qeverisjes elektronike, në Anketën 2008 të OKB-së për Qeverisjen Elektronike (UN e-Government Survey 2008), Shqipëria renditet në vendin e 86-të ndër 182 vende të konsideruara në këtë raport, me një rritje prej 14 vendesh kundrejt vëzhgimit të kryer në vitin 2005. Në figurën


<sup>9</sup> Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008

22 jepet indeksi për qeverisjen elektronike për Shqipërinë për periudhën 2004-2008, krahasuar me vendet e tjera të Evropës juglindore për vitin 2008.



Burimi: Anкета 2008 e OKB-së për Qeverisjen Elektronike

Përmirësimi i nivelit të këtij treguesi ka ardhur si pasojë e disa politikave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare të tilla si: regjistrimi i biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, duke ulur kohën e nevojshme për regjistrim nga 42 ditë në një ditë; ligji i ri i prokurimeve publike që bëri të mundur zhvillimin e sistemit të prokurimit elektronik; reforma në sistemin e taksave, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve elektronike për taksat; pajisja me kabinate informatike e shkollave të mesme dhe të arsimit bazë. Prokurimet elektronike të zhvilluara në vitin 2008 përbëjnë 2% e totalit të vlerës së prokuruar, ndërsa për vitin 2009 synohet që të gjitha prokurimet publike të zhvillohen në rrugë elektronike. Kjo do të ndikojë në uljen e kostos së përgjithshme të prokurimeve, rritjen e transparencës dhe uljen e korrupsionit. Treguesi i gadishmërisë për qeverisjen elektronike llogaritet nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara, dhe përbëhet nga disa tregues të tjerë si treguesit e infrastrukturës, të gatishmërisë së të dhënave, të përdorimit të internetit, si dhe treguesi i edukimit.



Burimi: Anкета 2008 e OKB-së për qeverisjen elektronike

Ngritja e Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në vitin 2008 ka ndikuar së tepërmi në orientimin dhe koordinimin në nivel qendror të politikave publike për shoqërinë e informacionit. Gjatë vitit 2008 është punuar intensivisht për hartimin dhe konsultimin e Projekt-Strategjisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit.

Shqipëria ka bërë progres në procesin e përafrimit të legjislacionit dhe politikave me legjislacionin evropian në fushën e teknologjisë së informacionit. Kjo gjë dëshmohet me një numër aktesh ligjore të miratuara si: Ligji “Për nënshkrimin elektronik”, Ligji 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndryshimet në Ligjin “Për prokurimet publike”, Ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, reflektimi gjatë vitit 2008 në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të kërkesave të Konventës për Krimin Kibernetik, etj.

Në veçanti, Ligji “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” u miratua prej Parlamentit të Republikës së Shqipërisë më 19.05.2008, në përputhje të plotë me direktivat evropiane në fushën e komunikimeve elektronike. Miratimi i Ligjit “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” ka sjellë një liberalizim të plotë të tregut të komunikimeve elektronike. Vetëm në vitin e 2008 janë pajisur me autorizim nga AKEP apo kanë shtuar listën e shërbimeve që u ofrojnë konsumatorëve mbi 70 sipërmarrës.

### 3.3 Politika sociale

Në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor (HDI), Shqipëria konsiderohet si një vend me të ardhura mesatare prej 0.801, duke u renditur në vendin e 68-të nga 177 vende që marrin pjesë në këtë vlerësim (Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2007/2008 PNUD). Vendi ka potencial të lartë të disponueshëm të forcave të punës në moshën më produktive për punë dhe krijimi i vendeve të reja të punës përbën një prej sfidave më komplekse, e cila kërkon mbështetjen me politika stimuluese makro-ekonomike, një klimë të favorshme për zhvillimin e biznesit si dhe politika të shëndosha e të qëndrueshme arsimore.


Punësimi dhe politikat për nxitjen e tij dhe hapjen e vendeve të reja të punës kanë qenë ndër prioritet kryesore, por edhe më të vështira për t'u arritur, në kushtet e reformimit të thellë të ekonomisë, sidomos të sektorëve industrialë dhe prodhues. Hapja e vendeve të reja të punës është një fenomen mbarësektorial, që përfshin politika makro-ekonomike, politika të favorshme për biznesin, politika arsimore, sociale, etj., kështu që edhe masat e marra nga Qeveria kanë qenë mbarësektoriale. Në mbështetje të biznesit dhe zhvillimit të ekonomisë, që është indikator kryesor në zhvillimin e tregut të punës dhe hapjen e vendeve të reja të punës, janë hartuar dhe zbatuar politika fiskale ndër më të favorshmet.

Gjithashtu shndërrimi i politikave të punësimit nga politika pasive në politika aktive, rritja e nivelit të pagesave për të gjitha kategoritë, veçanërisht për ato në nevojë, dhe krijimi i kushteve dhe mundësive për një punësim të plotë dhe në përputhje me aftësitë profesionale të secilit ka çuar në zhvillimin e tregut.

#### 3.3.1 PUNËSIMI


##### Treguesi: Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave dhe gjinisë (%)

Niveli zyrtar i papunësisë në fund të vitit 2008 arriti në masën 13%, kundrejt 14.1% në vitin 2005, duke shënuar një ulje prej 1% në shkallën e papunësisë. Për vitin 2008, niveli i papunësisë për meshkujt është 12.45% dhe për femrat 13.54%. Në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit është bërë prezantimi i programeve të reja të nxitjes së punësimit. Nga aplikimi i këtyre programeve janë punësuar 6,235 punëkërkuar të papunë, nga të cilët 2,000 janë nga grupet e veçanta (si përfituesit e skemave të mbështetjes me të ardhura, femra mbi 35 vjeç, të papunë mbi 50 vjeç, romë, jetimë, punëkërkuar të papunë afatgjatë, të rinj 16-25 vjeç, persona me probleme sociale, persona të dalë të papunë si pasojë e ristrukturimit të ekonomisë, etj.). Në kuadër të reformimit të sistemit për kalimin nga politikat pasive në ato aktive janë punësuar rreth 35 mijë punëkërkuar të papunë nëpërmjet shërbimit të zyrave të punësimit, të këshillimit dhe ndërmjetësimit.



Burimi: INSTAT

Figura 25. Shkalla e papunësisë sipas gjinisë



Burimi: INSTAT

Siç edhe vihet re nga figurat 24 dhe 25, shkalla e papunësisë shënon një ritëm rënieje për të gjitha grupmoshat. Për sa i përket gjinisë, shkalla e papunësisë ka pësuar rënie të ndjeshme në 72,200 mijë për meshkujt (viti 2008), në krahasim me 79,000 (viti 2005), ndërsa për femrat kjo rënie ka arritur në 69,000 (viti 2008) në krahasim me 74,300 (viti 2005). Kështu, niveli i papunësisë për gratë është më i lartë dhe llogaritet rreth 16.1%, ndërsa tek burrat më i ulët, rreth 10.8%. Niveli i papunësisë po ashtu varion nga njëra zonë në tjetrën, ku bie në sy se në zonën e Tiranës niveli i papunësisë është më i ulëti, 7.1%, ndërsa në zonën veriore më i larti, 24%. Punësimi në Sektorin publik përbën rreth 18% të numrit të të punësuarve, ndërsa sektori privat jobujqësor arrin rreth 25% të të punësuarve gjithsej. Në krahasim me vitin 2005, kemi rritje të të punësuarve në sektorin privat jobujqësor me 24 mijë persona dhe ulje të punësimeve në sektorin shtetëror, si pasojë e ristrukturimit të ekonomisë shqiptare.

Ndërhyrja për përmirësimin e situatës në tregun e punës në zona të veçanta dhe për kategori të veçanta është bërë nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave efikase, mbështetur edhe me fondet përkatëse. Kështu është rritur fondi për programet e nxitjes së punësimit për kategori si gratë, të rinjtë dhe kategoritë në nevojë, dhe programe të tilla po zbatohen në të gjithë vendin, veçanërisht në zonën veriore. Mbështetja e politikave aktive në tregun e punës, është prioritet dhe për këtë fondet për zbatimin e këtyre politikave janë rritur nga viti në vit. Në vitin 2008 ky fond nga buxheti i shtetit arriti në masën 200 milionë lekë. Vetëm gjatë **vitit 2008** janë punësuar më shumë se 12 mijë persona, nga të cilët 43% e të punësuarve janë femra dhe 27% janë të rinj deri në 25 vjeç.


Në kuadrin e politikave për zbutjen e varfërisë gjatë vitit 2008 ka patur përmirësime edhe të politikave pasive në tregun e punës. Numri i personave që trajtohen me pagesë papunësie ka pësuar një rritje në krahasim me 2007 për shkak të privatizimit të ARMO-s dhe ALPETROL-it. Duke filluar nga data 01.01.2008 niveli bazë i pagesës së papunësisë u rrit me 14,2% në masën që u rrit dhe paga minimale në shkallë vendi.

Në drejtim të formimit profesional, gjatë vitit 2008 janë hapur 3 qendra të reja formimi profesional publik me fondet e buxhetit të shtetit në Fier, Gjirokastrë dhe Qendra e Lëvizshme për zonën verilindore. Në mbështetje të objektivit për zgjerimit sasior dhe cilësor të qendrave publike të formimit profesional në mbarë vendin, do të vazhdohet me ndërtimin dhe rikonstruksionin e tyre në disa qytete të vendit, si edhe me zbatimin e politikave për hapjen e vendeve të reja të punës. Tregu i punës dhe nevojat në rritje për njerëz të kualifikuar dhe për profesione të reja në përshtatje me zhvillimet e reja të ekonomisë, kanë bërë të domosdoshme rritjen e numrit dhe të cilësisë së trajnimeve, fuqizimin e aftësisë dhe riaftësisë.

### 3.3.2 BARAZIA GJINORE

#### Treguesi: Shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës, sipas përkufizimit standard dhe atij të zbutur

Për zbatimin e politikave gjinore, mjedisi institucional luan një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave të burrave dhe grave, sidomos në zbatimin e politikave që adresojnë pabarazitë gjinore dhe promovojnë barazinë. Për punësimin e grave janë zbatuar programe të nxitjes së punësimit që favorizojnë gratë e vajzat dhe janë lehtësuar tarifatat e sistemit të formimit profesional për gratë dhe vajzat në qendrat publike të formimit profesional. Gjithashtu, janë licencuar subjekte që ofrojnë kurse kryesisht për profesione që iu përshtaten kësaj kategorie dhe i aftësojnë ato.



Burimi: INSTAT

Në figura 26 vërehet se gjatë viteve të fundit papunësia e grave është ulur nga 74.300 gra e vajza të papuna në 69.500 të punësuar. Megjithatë niveli i papunësisë së grave është më i lartë se ai i burrave, përsëri vihet re një rritje e punësimit të grave në periudhën 2005-2008. Ky progres është i lidhur me përmirësimin e kuadrin ligjor dhe institucional. Këtu vlen të përmendet hartimi, miratimi dhe zbatimi i Ligjit Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Falë këtyre ndryshimeve është bërë e mundur: (i) sanksionimi i kuotës neutrale gjinore prej 30% në Kodin Zgjedhor; (ii) ngritja e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore; (iii) ngritja dhe fuqizimi i Drejtorisë së Politikave të Shansave të Barabarta në MPÇSSH me fokus çështjet gjinore dhe dhunën në familje; (iv) institucionalizimi i rrjetit të nëpunësve gjinorë për çështjet gjinore në çdo ministri linje dhe në nivel vendor.

Si rezultat, është rritur pjesëmarrja e gruas në administratën publike, akademike dhe pozicionet drejtuese të institucioneve, sidomos atyre arsimore. Për vitin 2008, pjesëmarrja e gruas si nëpunëse në shërbimin civil është 58.5%, nga 55.5% në vitin 2006. Është rritur përfaqësimi femëror në shërbimet diplomatike, nga 5% (deri në 2005), në 14% (ambasadore), 33.4% (sekretare e parë), 93.4% (sekretare e dytë). Gjithashtu, në sistemin parauniversitar publik, përqindja e grave të punësuar është rritur nga 67.2% për vitin 2005 në 70.9% në vitin 2008. Të dhënat tregojnë se femrat e punësuar në nivel qendror zënë një përqindje më të madhe të punësimit se në nivelin vendor (40% dhe 30% respektivisht). Aktivitetet ku femrat e zonës urbane zënë përqindjen më të madhe në punësim janë: 64% në arsim, 77% në shëndetësi 47% (viti 2007 krahasuar me 32.4% për vitin 2005) jashtë sektorit të bujqësisë. Në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010, do të konsolidohet më tej kuadri ligjor<sup>10</sup> dhe institucional që garanton barazinë gjinore, rrit përfaqësimin e grave në vendim-marrje duke bërë ndryshime në kodin elektoral, garanton fuqizimin

<sup>10</sup> Ligji për barazinë gjinore është miratuar në korrik 2008. Projekt-ligji përfshin arsimin, punësimin dhe pjesëmarrjen e grave në vendim marrje. Sipas ligjit për barazinë gjinore, 30% e posteve më të larta në vendim marrje duhet të zihen nga gratë.




ekonomik të grave, duke iu ofruar mundësi të bëhen sipërmarrëse. Gjithashtu nëpërmjet programeve të veçanta për punësimin e grave, shmanget pabarazia gjinore në arsim, ndërsa përmirësimi i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional mundëson mbrojtjen e grave nga trafikimi, etj.

### 3.3.3 MBROJTJA SOCIALE

#### Treguesi: Mbulimi dhe programimi i ndihmës ekonomike, përqindja e njerëzve në varfëri të skajshme që përfitojnë ndihmë.

Ndihma ekonomike (NE) është një program që mbështetet në testimin e të ardhurave, ofron garanci minimale dhe pagesa në formën e transfertave në të holla (cash) për familjet e varfëra pa të ardhura, ose me të ardhura të pamjaftueshme.



Burimi: MPÇSSHB

Figura 27 ilustron fondet e NE-së për familjet në nevojë për periudhën 2005-2008, numrin e familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike dhe masën mesatare mujore për familje. Për vitin 2008 masa mesatare mujore e ndihmës ekonomike për familje është mesatarisht 3,091 lekë, nga 2,275 lekë në vitin 2005. Për herë të parë, në korrik 2008, Ndihma Ekonomike u indeksua me 10%, një tjetër masë kjo që ndikon në zbutjen e mëtejshme të varfërisë.

Sipas burimeve të MPÇSSHB-së, numri i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike është 93,000, në vitin 2008 nga 110,000 që ishte në vitin 2007. Kjo tregon që gjatë vitit 2008, rreth 17 mijë familje në Shqipëri e kanë kapërcyer atë prag të të ardhurave të tyre, i cili është përcaktuar ligjërisht si kriter për përfitimin e ndihmës ekonomike. Këto të dhëna konfirmojnë efektin e politikave për reduktimin e varfërisë të përfshira në dokumentin strategjik të mbrojtjes sociale në Shqipëri të miratuar nga qeveria në fillim të vitit 2008.


Një ndër prioritet e qeverisë është edhe përmirësimi i sistemit të administrimit dhe kontrollit të ndihmës ekonomike, si një ndër format më të drejtpërdrejta të trajtimit të familjeve në nevojë. Për këtë arsye, gjatë viteve 2005-2009 janë fuqizuar mekanizmat e kontrollit të përdorimit të fondeve dhe monitorimi i prirjeve të varfërisë. Fondet e ndihmës ekonomike në vitin 2008 arritën në 3.45 miliardë lekë nga 2.6 miliardë, ose 34% më shumë se në vitin 2007. Për vitin 2009 janë bërë efektive 4.3 miliardë lekë, ndërsa për vitin 2010 fondet e ndihmës ekonomike parashikohen të arrijnë në 5.3 miliardë lekë. Alternimi i skemës së NE-së me punë dhe shërbime në komunitet përbën një alternativë të mirë për angazhimin e kësaj kategorie në zhvillimin e tregut, e cila duhet nxitur apo zbatuar në të gjitha rajonet e vendit.



### 3.3.4 PËRFSHIRJA SOCIALE

#### Treguesi: Shkalla e popullsisë në varfëri absolute

Gjatë viteve të fundit Shqipëria ka patur një ritëm të lartë rritjeje ekonomike prej 6-7% në vit e PBB-së reale, e cila është reflektuar edhe në uljen e shkallës së varfërisë. Në vitin 2005 rreth 18.5% e shqiptarëve jetonin në varfëri absolute, për vitin 2008 kjo shifër ka zbritur në 12.4%, bazuar në rezultatet e Anketës për Matjen e Standardeve të Jetesës (LSMS) për vitin 2008. Kjo do të thotë se, rreth 200,000 nga 575,000 të varfër në 2005-sën kanë dalë nga varfëria. Popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si persona që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore, është ulur në 1.2% për vitin 2008, krahasuar me 5% në 2002 dhe 3.5% në 2005. Reduktimi më i thellë i shkallës së varfërisë ka rezultuar në Shqipërinë qendrore dhe atë bregdetare, ndërsa vendet malore ende shfaqin një shkallë të lartë varfërie.



Burimi: INSTAT

Thellimi i varfërisë<sup>11</sup> ka rënë nga 5.7% në 2002 në 4.0% në 2005 në 2.3% në 2008. Ashpërsia e varfërisë, që nënkupton distancën e të varfërve nga linja e varfërisë dhe pabarazinë ndërmjet të varfërve, ka rënë në 0.7% për vitin 2008, nga 2% në vitin 2002 dhe 1.3% në 2005. Lufta kundër varfërisë ka dhënë rezultate veçanërisht pozitive për zonat rurale. Rezultatet e LSMS 2005 dhe 2008 për zonat rurale tregojnë se shkalla e varfërisë në këto zona është ulur nga 24.2% në vitin 2005 në 14.6% në vitin 2008. Ulje e shkallës së varfërisë është shënuar edhe në zonat urbane nga 11.2% në vitin 2005 në 10.1% në vitin 2008.

Përpos reduktimit të varfërisë absolute në zonat rurale të vendit (nga 24.2% në 14.6%) brenda këtij 4-vjeçari, një sërë investimesh publike të kryera në këto zona për përmirësimin e infrastrukturës, si dhe skemat e investimeve dhe subvencionimit në bujqësi, kanë çuar edhe në një përmirësim thelbësor të kushteve dhe cilësisë së jetesës në këto zona. Edhe për zonat malore, janë hartuar dhe zbatuar një numër i madh projektsh me fokus përmirësimin e infrastrukturës si edhe investime në sektorin e bujqësisë.

Politikat sociale për përfshirjen e grupeve në nevojë janë orientuar sipas dokumenteve strategjike të hartuara dhe kuadrit të nevojshëm ligjor të plotësuar. Politikat kryesore në këtë drejtim përcaktohen nga Strategjia Ndërsektoriale të Përfshirjes Sociale (SNPS), e miratuar në shkurt 2008, si pjesë përbërëse e SKZHI-së.

Në kuadrin e zbatimit të kësaj strategjie, gjatë vitit 2008 u krijua kuadri monitorues i SNPS-së. Ky kuadër identifikon aktorët kryesorë në zbatimin dhe monitorimin e SNPS-së, përgjegjësitë respektive, aktivitetet që do të monitorohen, mekanizmat e komunikimit ndërmjet aktorëve si dhe një grup treguesish të ndërmjetëm të mundshëm për t'u matur. Vënia në efikasitet të këtij kuadri ka të bëjë me: (i) rritjen e përgjegjësisë institucionale dhe në mënyrë të

11 Raporti i shumës së konsumit të të varfërve nga linja e varfërisë, minus konsumin për të gjithë të varfërit ndaj totalit të gjithë popullsisë, e cila shprehet si përqindje e linjës së varfërisë.

veçantë përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve të përfshira në SNPS, (ii) thellimin dhe zgjerimin e procesit pjesëmarrës gjatë monitorimit duke përfshirë të gjithë aktorët e interesit.

### Treguesi: Përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar

Në konsumin e popullsisë janë përfshirë konsumi për ushqim dhe pije jo-alkoolike (të blera dhe të konsumuara nga prodhimi vetjak), shpenzimet jo-ushqimore (veshmbathje, artikuj familjarë, etj.), shërbime (gaz, telefon, energji elektrike, etj.), shpenzime për arsim, shpenzime për kujdes personal, transport. Në konsum nuk përfshihen vlera mesatare e qerasë, shpenzimet për shëndetin dhe vlera e mallrave me afat të gjatë përdorimi.


Rezultatet e LSMS 2008 kanë nxjerrë se përqindja e konsumit të kuintilit më të varfër të popullsisë ndaj konsumit kombëtar, është 9.2% në krahasim me 10,9% sipas LSMS 2005.

Sipas LSMS, shpenzimet për arsim dhe përqindja e tij ndaj totalit në 2008, janë rritur përkatësisht me rreth 57% dhe 53% që nga viti 2005. Ndërsa, si përqindje ndaj totalit të konsumit për frymë, përqindja e konsumit për ushqim ka rënë me 2.2% në periudhën 2005-2008. Rritja në shpenzimet e arsimit dhe në përqindjen që zënë ndaj konsumit real për frymë në 2008 dhe ulja në shpenzimet për ushqim ndaj këtij totali tregojnë një cilësi më të lartë të nivelit të jetesës në Shqipëri, e cila lidhet me ndikimin pozitiv të ritmeve të larta të zhvillimit ekonomik vitet e fundit.

### 3.3.5 SIGURIMET SHOQËRORE

#### Treguesi: Përqindja e varësisë së sistemit - raporti midis numrit të përfituesve dhe kontribuesve

Sistemi i pensioneve në vend bazohet në parimin paguaj në vazhdimësi (pay-as-you-go), i cili financohet nga kontributet e personave që punojnë, të cilët paguajnë pensionet e gjeneratës në moshë pensioni. Rritja e numrit të kontribuesve në skemën e pensioneve dhe të të ardhurave ka ardhur si rezultat i uljes së normës së kontributeve, luftës kundër informalitetit në tregun e punës dhe reformës për rritjen e moshës së daljes në pension.



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Në figurën 29 paraqitet numri i të siguruarve në skemën e sigurimeve shoqërore gjatë periudhës katërvjeçare 2005-2008. Totali i numrit të të siguruarve në vitin 2008 është 14.2% më i lartë se në vitin 2005, ndërsa numri i kontribuesve në sektorin privat në qytet në vitin 2008 arrin në mbi 218 mijë persona ose 53.7% më shumë krahasuar me vitin 2005.

Norma e varësisë së sistemit ka ardhur duke u përmirësuar si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve dhe

zbatimit të reformës së rritjes graduale të moshës së daljes në pension. Ky tregues shkon nga 1.23:1 në vitin 2006 në 1.38:1 kontribues për pensionist pleqërie në vitin 2008. Në vitin 2008 mosha e daljes në pension për burrat ishte 62 vjeç dhe për gratë 57 vjeç. Në vitin 2012 bëhet 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë.

Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta për të gjitha degët e sigurimeve shoqërore në vitin 2008 janë rritur rreth 26% (viti 2008) në krahasim me vitin 2005, ndërsa transfertat në buxhetet familjare duke krahasuar po të njëjtat vite, janë rritur me pothuajse 36% (16233 milionë lekë). Ulja e ngarkesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 38.5% në 24.5%, ka favorizuar zhvillimin e biznesit dhe nxitjen e tyre në shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit. Brenda katër viteve të fundit përqindja e kontributit që paguan biznesi pothuajse është përgjysmuar (në vitin 2005 biznesi paguante 29% mbi pagë, ndërsa duke filluar nga muaji maj 2009 do të paguajë vetëm 15% mbi pagën).

Në fushën e sigurimeve shoqërore, me VKM nr. 1477, datë 12.11.2008, është kryer mbulimi i të gjithë të punësuarve me sigurim shoqëror, sipas të cilit sigurohen edhe punonjësit e shtëpisë me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Shpenzimet nga buxheti për skemat kompensuese të pensioneve janë rritur 3741 milionë lekë ose (90.5%) më shumë në vitin 2008 krahasuar me vitin 2005. Arritja më e rëndësishme e këtij sektori, si edhe ajo më e ndjeshme për të gjithë përfituesit, është rritja e vazhdueshme e pensioneve si në qytet ashtu edhe në fshat. Duke filluar nga viti 2006, është bërë realitet angazhimi që të ardhurat minimale të pensionistëve në fshat të jenë më të larta se 50 dollarë në muaj, dhe në qytet mbi 100 dollarë në muaj.

Pensionet minimale në qytet në vitin 2009 është rritur me 30.9% në krahasim me vitin 2005, ndërsa pensioni minimal në fshat është rritur me 85% për të njëjtën periudhë, pra pothuajse janë dyfishuar (nga 3,430 lekë në 2005 në 6,344 lekë në 2009). Pensionet maksimale të fshatit janë rritur me rreth 81%. Gjithashtu, pensionet minimale dhe maksimale të qytetit kanë shënuar një rritje prej rreth 31%. Diferenca mes pensioneve të qytetit dhe atyre të fshatit është ngushtuar nga 56% në vitin 2005 në 38% në vitin 2009 për pensionet minimale; dhe nga 73% në vitin 2005 në 62% për pensionet maksimale. Të ardhurat minimale në fshat dhe qytet (ku përfshihet pensioni minimal dhe kompensimet apo shtesat përkatëse) janë 7,234 lekë në muaj dhe 12,226 lekë në muaj përkatësisht. Po ashtu, të ardhurat maksimale në fshat dhe qytet janë 7,945 lekë në muaj dhe 21,052 lekë në muaj përkatësisht. Pensionit mujor, çdo vit i është shtuar një shpërblim vjetor prej 5,000 lekë për çdo pensionist, si në fshat edhe në qytet, me një kosto vjetore prej rreth 30 milionë dollarë.

Sistemi i pensioneve në Shqipëri është në proces reformimi. Aktualisht, është një sistem që ka vetëm dy shtylla: shtylla e parë PAYG, ku paguhen "përfitime të përcaktuara" në bazë të formulave që bazohen në pagat e punonjësve, vitet e shërbimit, dhe financohen nga kontributet e atyre që paguajnë sot dhe shtylla e dytë me kontribute të përcaktuara vullnetare (e cila ende është pak e zhvilluar). Reforma parashikon që të shndërrohet në një sistem me tre shtylla: një kombinim i PAYG, i përmirësuar me një shtyllë të dytë me kontribute të përcaktuara, të detyrueshme, të cilat do të investohen në bazë të rregullave të përcaktuara qartësisht, si dhe shtylla e tretë e sigurimeve private që duhet të stimulohet për t'u zgjeruar dhe përmirësuar. Qeveria në bashkëpunim me Bankën Botërore, nëpërmjet një diskutimi të gjerë politik me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, po përgatit detajet dhe masat që do të ndërmerren në lidhje me këtë reformë. Po kështu, po punohet për hartimin e një projektligji të ri për mbikëqyrjen e fondeve të sigurimeve si dhe për rregullat për raportimin e treguesve ekonomik-financiarë të kompanive ekzistuese në treg.

### **Treguesi: Norma e zëvendësimit (raporti midis pagës dhe pensionit)**

Masa e pensioneve varet nga periudha kontributive dhe paga mbi të cilën janë paguar kontributet, por pensioni maksimal është kufizuar me dyfishin e pensionit minimal. Kufizimi i vendosur për pensionin maksimal sjell si pasojë një shkallë të ulët zëvendësimi për personat që kontribuojnë me paga të larta duke evidentuar problemin e një lidhjeje të dobët midis kontributeve që paguhen dhe pensionit që përfitohet. Ky është një nga problemet për t'u zgjidhur në procesin e reformimit të sistemit. Zgjidhja e këtij problemi besojmë që do të përmirësojë edhe pagesat e kontributeve dhe deklarinimin real të pagave mbi të cilat paguhen kontributet.

Përfitimet përgjithësisht duhet të mbulojnë një shkallë të caktuar të të ardhurave neto në vitet e fundit të punës. Sipas konventave ndërkombëtare shkalla e zëvendësimit nuk duhet të jetë nën 40%, por një sistem vlerësohet i mirë kur jep mbi 55% në mënyrë që bashkë me skemat suplementare të japë rreth 70 – 75%.

Aktualisht raporti i zëvendësimit pension mesatar/pagë mesatare në Shqipëri shkon në 46-47%, ndërsa po t'i

referohemi dy skajeve, raportit të pensionit minimal me pagën minimale dhe pensionit maksimal me pagën maksimale, kemi rezultate krejt të ndryshme. Norma e zëvendësimit pensioni minimal/pagë minimale është 75% ndërsa pensioni maksimal zë rreth 26% të pagës maksimale mbi të cilën derdhen kontributet.

### 3.3.6 SHËNDETËSIA


#### Treguesi: Shkaqet e vdekjeve sipas grup-sëmundjeve për 100,000 banorë (sipas gjinisë)

Njohja e situatës shëndetësore të vendit nëpërmjet treguesve statistikorë të shëndetësisë është pjesë e vlerësimit të sistemit të shërbimit shëndetësor për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të tij. Situata shëndetësore paraqitet me probleme për shkak të periudhës së vështirë të tranzicionit, megjithatë treguesit kryesorë janë në rrugën e përmirësimit të tyre si në shërbimin shëndetësor parësor edhe në atë spitalor. Niveli i disa treguesve të rëndësishëm, si jetëgjatësia, vdekshmëria dhe sëmundshmëria kronike janë të krahasueshme me vendet zhvilluara, ndërsa tregues si vdekshmëria foshnjore, vdekshmëria amtare dhe sëmundshmëria akute infektive janë të krahasueshme me ato të vendeve në zhvillim.

Tregues në rritje mbeten një grup sëmundjesh të popullatës si: sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes, gastrointestinal, infektive, urogenital, qarkullimit të gjakut dhe insultet cerebrale. Statistikat tregojnë se një pjesë relativisht e lartë e vdekjeve dhe sëmundjeve në Shqipëri vijnë si pasojë e: duhan-pirjes, abuzimit me alkool, pakujdesisë në rrugë, përdorimit të drogave ilegale, mënyrës së të ushqyerit dhe stresit si një fenomen i ri i shoqërisë moderne. Inaktiviteti fizik paraqet një risk potencial për hipertensionin, sëmundjet e artereve koronare të zemrës, etj.

Popullsia shqiptare është e re dhe rezulton që mosha mesatare e saj është 29 vjeç. Sipas projeksioneve të popullsisë jetëgjatësia mesatare është 74 vjeç. Sipas të dhënave, jetëgjatësia për meshkujt është 72,5 vjeç, ndërsa jetëgjatësia për femrat është 77.5 vjeç

Sipas të dhënave rezulton se sëmundjet që prekin më shumë në vendin tonë janë: sëmundjet e qarkullimit të gjakut, ato të frymëmarrjes, të aparatit tretës dhe infeksionet.



Burimi: INSTAT

Shkaqet e vdekjeve janë analizuar nga INSTAT mbi bazën e skedës së vdekjes në përputhje me Klasifikimin Standard Kombëtar ICD-9. Sipas INSTAT-it, struktura e vdekshmërisë së përgjithshme për vitet 2002-2006 ka mbetur pothuaj e pandryshuar.

**Vdekjet nga sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut zënë vendin e parë** në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme. Vdekjet më të larta janë në sëmundjet e enëve të gjakut të trurit me tendencë në rritje te femrat dhe të sëmundjeve iskemike të zemrës ku 64% të vdekjeve janë meshkuj.

**Vdekjet nga tumoret zënë vendin e dytë** në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme, veçanërisht në tumoret malinj të aparatit tretës, të frymëmarrjes dhe urogenitale e theksuar në moshat mbi 50 vjeç. Tumoret malinj të aparatit tretës janë dy herë më shumë tek meshkujt se tek femrat. Tumoret malinj të aparatit të frymëmarrjes janë 3 herë më shumë tek meshkujt, tumoret malinj të kockave dhe të gjirit janë 3 herë më shumë tek femrat se tek meshkujt, tumoret malinj të organeve urogenitale janë 2 herë më shumë tek meshkujt se tek femrat.

**Vdekjet nga dëmtime traumatike, helmime dhe aksidentet zënë vendin e tretë** në strukturën e vdekshmërisë së përgjithshme. Në këtë grup 88% e vdekjeve kanë ardhur nga aksidentet dhe 13% nga traumat dhe helmimet. Aksidentet në përgjithësi janë 77% tek meshkujt dhe 13% tek femrat. Aksidentet e qarkullimit rrugor janë 3.6 herë më të larta tek meshkujt sesa tek femrat. Vrasjet janë 5 herë më të larta tek meshkujt se tek femrat ndërsa tek vetvrasjet vihet re një tendencë në rritje tek femrat.

**Vdekjet nga sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes zënë vendin e katërt** në strukturën e përgjithshme të shkaqeve të vdekjeve për 100,000 banorë. Si dinamikë, vdekjet nga ky grup-sëmundjesh ka ardhur duke u ulur.

Për të përmirësuar shëndetin e popullatës dhe si rrjedhim edhe këta tregues, Ministria e Shëndetësisë ka instaluar një mekanizëm stimulum për mjekët e përgjithshëm për të ndjekur në mënyrë periodike të sëmurët kronikë. Pjesë e pagesës së bonusit prej 5% të buxhetit të qendrës shëndetësore mbështetet në performancën e mjekëve për ndjekjen e këtyre të sëmurëve. Hapa me rëndësi janë hedhur në drejtim të realizimit të transplantit të veshkave në Spitalin Universitar “Nënë Tereza”. Ndërkohë janë marrë masa për depistimin e kancerit të gjirit dhe të qafës së mitrës, si formë e parandalimit dytësor, përmes instalimit të aparaturave dixhitale të mamografisë dhe ekografisë në poliklinikat e katër qyteteve kryesore: Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Vlorë. Është hartuar projekt-strategjia për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve tumorale dhe janë ndërmarrë masa për parandalimin parësor të kancerit të mushkërive, kryesisht përmes përpjekjeve për të kufizuar përdorimin e duhanit.

Reforma e nisur në sistemin shëndetësor jep drejtimin e duhur të zhvillimit të sektorit, duke përcaktuar qartë rrugët që do të çojnë në përmirësimin e këtij sistemi në përputhje edhe me ndryshimet ekonomike, shoqërore të vendit. Është hartuar drafti i Strategjisë Sektoriale të Sistemit Shëndetësor dhe është finalizuar kostoja financiare që nevojitet për zbatimin e saj. Për vitin 2008, pati një rritje të buxhetit për shëndetësinë në masën 8.7% duke përfaqësuar 2.9% të GDP-së, krahasuar me 2007.


Orientimi kryesor i reformës spitalore është decentralizimi i kompetencave dhe buxhetit nga qendra në rrethe. Për këtë, përgatitja e protokolleve detyrimisht të zbatueshme njësoj në të gjithë vendin si edhe unifikimi i të gjitha diagnozave të sëmundjeve do të përbëjë një hap të rëndësishëm në vitin e ardhshëm. Për çdo sëmundje do të ketë një protokoll mjekimi për të gjitha spitalet në vend. Në bazë të këtyre protokolleve do të ketë edhe çmime të unifikuara, dhe mjekimi do të kushtojë njësoj në çdo spital të vendit.

### **Treguesi: Shkalla e vdekshmërisë foshnjore dhe shkalla e vdekshmërisë amtare**

Të gjitha burimet e të dhënave flasin për përmirësime inkurajuese të vdekshmërisë foshnjore për dhjetëvjeçarin e fundit, por po të krahasohet me vende të tjera të Evropës, ky tregues mbetet në nivele të larta. Megjithatë, krahasuar me Turqinë dhe Maqedoninë paraqitet në nivele më të mira.

Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e vdekshmërisë foshnjore dhe amtare për periudhën 2000-2008, bazuar në të dhënat e Ministrisë së Shëndetësisë. Siç tregohet edhe nga grafiku, prirja është për ulje të këtij treguesi, ku për vitin 2008 të dhënat tregojnë një vdekshmëri foshnjore prej 11.1/1000 lindje gjallë. Kjo tregon një progres krahasuar me vitin 2007, ku paraqitej 12/1000 lindje gjallë. Kjo prirje në rënie flet për një rritje të nivelit të shërbimit mjekësor, të nivelit profesional të mjekëve dhe përmirësim të teknologjisë së aplikuar.

Figura 31. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore dhe amtare 2000-2008



Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Një nga treguesit më domethënës të shëndetit të nënës është vdekshmëria amtare ecuria e së cilës tregon një ulje të nivelit të saj nga viti në vit. Megjithatë për vitin 2008 kjo shifër paraqitet shqetësuese, pasi arrin në shifrën 20.9/1000, karahasuar me vitin 2007 kur niveli ishte ulur në 14.5/1000. Nga studimi i UNICEF MICS i kryer në 2006, doli se 97.1% e grave kanë marrë kujdes gjatë shtatzënisë nga një personel i aftë mjekësor dhe 43% e tyre e fillojnë këtë vizitë në tremujorin e parë.


Këto të dhëna duhet të orientojnë drejt politikave për përmirësimin e mëtejshëm të kujdesit gjatë shtatzënisë dhe shëndetit riprodhues në përgjithësi. Duhet të punohet më shumë në drejtim të kujdesit për gruan shtatzënë dhe kujdesit për gruan pas lindjes, duke rritur cilësinë e shërbimit spitalor dhe atij të shërbimit parësor.

### 3.3.7 ARSIMI PARAUNIVERSITAR

#### Treguesi: Shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm: Numri i studentëve që ndjekin klasat 9-12 në krahasim me popullsinë e grup-moshës përkatëse (14-17-vjeç) (sipas gjinisë)

Arsimi është në qendër të vëmendjes të politikave prioritare të qeverisë dhe ka njohur mjaft përmirësime gjatë periudhës 2007-2008. Gjatë viteve 2007-2008 është punuar për përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH) dhe rajonal (DAR dhe ZA), decentralizimin e shërbimit arsimor dhe rritjen e autonomisë së shkollave, është konturuar dhe pritet të zbatohet reforma në fushën e personelit shkollor e cila synon kufizimin e rolit të DAR-eve në emërimet e personelit shkollor dhe përfshirjen e komunitetit shkollor dhe lokal në vendim-marrjet shkollore duke zgjeruar autonominë shkollore dhe duke përafruar atë me vendet e tjera të rajonit. Po ashtu ka vazhduar puna për aktualizimin e reformës për strukturën e re të sistemit të arsimit të mesëm, mbi bazën e strukturës së arsimit të detyruar 9-vjeçar.

Figura 32. Tregues të arsimit parauniversitar 2003-2009



Burimi: MASH



Financimi për sektorin e arsimit është rritur dukshëm dhe shpenzimet publike për arsimin në vitin 2008 kanë arritur në 3.7% të PPB-së. Rritja e treguesve në arsim ka ardhur si rezultat i zbatimit të një sërë reformash lidhur me fuqizimin e kapacitetit politikëbërës, menaxhues e vendimmarrës, përmirësimin cilësor të procesit mësimor, ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe fuqizimin dhe shtrirjen e arsimit profesional.

Një tregues i rëndësishëm është shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm, ecuria e të cilit është paraqitur në grafikun më sipër. Për vitin shkollor 2007-2008, ky tregues u paraqit në nivelin 58.6%, duke shënuar një rritje prej 1.2% krahasuar me nivelin 57.4% për vitin shkollor 2006-2007. Ndërsa shkalla bruto e regjistrimit për vitin shkollor 2007-2008 arriti në 71.7% me një rritje prej 3.4% krahasuar me një vit më parë. Me thellimin e mëtejshëm të reformave tashmë të nisura synohet që shkalla neto e regjistrimit të jetë në një rritje minimale prej 2.5% për 2008-2009. Synimi strategjik është që në vitin 2013 shkalla neto e regjistrimit në arsimin e mesëm të rritet deri në 76%, ndërsa përqindja e tërheqjes në arsimin e mesëm të jetë në masën 86%.

Tërheqja e nxënësve që përfundojnë arsimin 9-vjeçar në shkollën e mesme është 81% për vitin shkollor 2007-2008, nga 80% që ka qenë në vitin shkollor 2005-2006. Niveli i braktisjes në arsimin bazë (klasa 1-4), për vitin 2007-2008 ka qenë 0.89%, kurse për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar rezultoi në shifrat 0.94%. Për vitin shkollor 2007-2008, niveli i nxënësve që fillojnë shkollën e mesme (të përgjithshme dhe profesionale) dhe që e mbarojnë atë është 66%. Për vitin 2008, tërheqja e fëmijëve 5-6 vjeç në vitin parapërgatitor para frekuentimit të arsimit bazë, është në nivelin 63%.

Politikat që janë ndjekur gjatë kësaj periudhe kanë synuar gjithashtu rritjen e përqindjes së nxënësve që frekuentojnë arsimin profesional. Gjatë kësaj periudhe është përgatitur dhe drafti i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në përshtatje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Gjithashtu, janë përmirësuar programet e reja mësimore për të gjitha llojet e shkollave tekniko-profesionale, janë ofruar lehtësira për nxënësit që do të ndjekin këtë lloj arsimimi, etj.

Në vitin 2008 vazhdoi gjerësisht zbatimi i projektit “TIK Shkolla” që synon pajisjen e të gjitha shkollave të sistemit arsimor parauniversitar me laboratorë të informatikës, duke ngritur 1,200 kabinete interneti në 2008, si dhe ngritjen e kapaciteteve e ofrimin e trajnimeve për personelin mësimor dhe mirëmbajtës.

Procesi i ri i iniciuar në 2006, Matura Shtetërore, vazhdon të pasurohet çdo vit me elementë të rinj që i shërbejnë konsolidimit dhe rritjes së transparencës të këtij procesi. Shërbimi Psikologjik Shkollor, i pilotuar për një periudhë 3-vjeçare, në 2008, u shtri edhe në zonat rurale të vendit, duke rritur kështu cilësinë e shërbimit arsimor. Përdorimi i tekstit alternativ ka vazhduar dhe në 2007-2008, duke krijuar kushtet për nxjerrjen përfundimtare të tregimit të teksteve nga MASH dhe shkolla në tregun e lirë, ku autoritetet zyrtare të arsimit kontrollojnë vetëm përmbajtjen e teksteve, ndërsa konkurrimi në treg nxit çmimet e ulëta të teksteve për nxënësit.


Në vijim të mbështetjes të sektorit të arsimit profesional do të synohet forcimi i sistemit të AFP-së, si dhe zbatimi i politikave për nxitjen e formimit dhe zhvillimit profesional në përgjigje të kërkesave të tregut. Do të vijohet me përmirësimin e programeve mësimore të AFP-së, do të jepen bursa për nxënësit që do të vazhdojnë këto shkolla, pavarësisht kritereve ekonomike.

### 3.3.8 ARSIMI I LARTË

#### **Treguesi: Numri i studentëve në arsimin e lartë, sipas statusit me kohë të plotë / të pjesshme**

Periudha 2007-2008 ka synuar zbatimin e një sërë masash lidhur me: (i) reformimin e kurrikulës në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë, për të qenë të njëjta në programe studimi të ngjashme në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në modularizimin e lëndëve; (ii) futjen e krediteve si masë për punën e studentëve; (iii) rritjen e mundësive të mobilitetit të studentëve; (iv) organizimin e formave të studimit me kohë të pjesshme apo në distancë, të orientuar drejt të mësuarit gjatë gjithë jetës. Në këtë kuadër u miratua në vitin 2008 ligji për arsimin e lartë dhe Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë (SKALA) (2008-2013), që orientojnë reformat dhe drejtimin strategjik të sektorit. Gjithashtu, filloi puna për hartimin e planeve individuale të zhvillimit strategjik institucional të universiteteve për një periudhë trivjeçare, në përputhje me SKALA-n.

Figura 33. Numri i studentëve në arsimin e lartë 2006-2008



Burimi: MASH

Numri i studentëve të regjistruar në Arsimin e Lartë është 90,202 nga 86,178 studentë që ishte një vit më parë. Në arsimin publik numri i studentëve ka qenë më i ulët se vitin e kaluar duke arritur shifrën prej 80,696 studentë të regjistruar nga 81,102 që ishte një vit më parë. Në arsimin jopublik numri i studentëve të regjistruar është rritur në 9,506 nga 5,761 të një viti më parë. Numri i studentëve të arsimit publik në sistemin me kohë të plotë në këtë periudhë është rritur në 62,289 nga 58,916 të një viti më parë. Për vitin 2008-2009 numri i studentëve parashikohet të arrijë në 115,000.

Numri i studentëve në arsimin e lartë është rritur në sajë të politikave të ndërmarra për nxitjen e të rinjve për t'u arsimuar, shtimin e kapaciteteve të universiteteve, si dhe shtimin e programeve të reja të studimit, duke i bërë ato më tërheqëse për ta si dhe më të përshtatshme me tregun e punës. Rritja e numrit të studentëve është mbështetur edhe me rritjen e numrit të pedagogëve, si dhe integrimin e instituteve kërkimore shkencore në universitete, duke rritur kështu kapacitetet akademike, laboratorike e shkencore. Për arsimin e lartë, me fillimin e zbatimit të procesit të Bolonjës filloi ristrukturimi i programeve të studimit me përpjekjet për t'i organizuar ato me cikle.

Në vitin akademik 2008–2009 filloi cikli II i studimeve me programe të reja studimore në përputhje me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë. Janë hapur struktura të reja në arsimin e lartë publik për vitin 2008: FASTIP në Universitetin e Durrësit, si një formë e re e të ofruarit të studimeve të lidhura me praktikën; u ngrit dhe APRIAL si strukturë për pranimet në universitet, bazuar në sistemin Meritë–Preferencë; në UPT (Universitetin Politeknik të Tiranës) në vitin akademik 2007-2008, u hapën dy fakultete të reja dhe u ngritën dy institute IGJEO dhe INEUM. Në vitin 2008 u hapën dhe dy filiale të reja: Filiali i UT në Kukës dhe filiali i UBT në Lushnjë.

Zgjerimi i sistemit të arsimit të lartë, përmirësimi i procedurave të pranimit në universitete, thithja e një numri sa më të lartë të maturantëve në universitete nëpërmjet zgjerimit të infrastrukturës dhe shtimit të ofertave në programe të ndryshme studimi dhe në koherencë me tregun e punës, do të vazhdojnë të përbëjnë prioritetet e zhvillimit në të ardhmen për arsimin e lartë.



## 3.4 Zhvillimi urban, rural dhe rajonal

Politikat për zhvillimin urban kanë konsistuar në përmirësimin e kuadrit ligjor për planifikimin urban, si edhe përgatitjen dhe miratimin e planeve zhvilluese të qyteteve, veprave industriale, zonave turistike etj.

Në lidhje me turizmin, rritja e numrit të turistëve dhe e të ardhurave nga turizmi kanë ardhur si pasojë e investimeve në infrastrukturën e zonave turistike, sidomos në rrugë, ujë e kanalizime. Gjithashtu, promovimi i imazhit turistik të vendit ka synuar konsolidimin e pozicionit të Shqipërisë në tregun turistik evropian dhe më gjerë. Janë inkurajuar fuqishëm produktet e reja të turizmit, si turizmi rural që përfshin ekoturizmin, agroturizmin, turizmin sportiv malor, dhe atë kulturor. Politikat në lidhje me trashëgiminë kulturore janë orientuar duke e trajtuar këtë fushë në funksion të turizmit. Investime të rëndësishme janë kryer për rehabilitimin e bërtamave dhe objekteve urbane me vlerë turistike dhe muzeale.

Për zhvillimin rural është nxitur konsolidimi i fermave nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të shoqatave të fermerëve, futjes së teknologjisë bujqësore, si edhe forcimit të sistemit të marketingut dhe nivelit të arsimit teknik të operatorëve të fermave, krijimin e mundësive për hyrje në treg të fermerëve, vazhdimin të politikës së rritjes së zhvillimit si mënyra më efektive për të ulur varfërinë në zonat rurale. Investime të rëndësishme janë kryer në segmentet e rrugëve sekondare dhe lokale, si edhe është krijuar një sistem i përshtatshëm për menaxhimin e aseteve të rrugëve dhe për përcaktimin e investimeve prioritare.

Zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e eksporteve ka ardhur si pasojë e rritjes së prodhimit bujqësor dhe agroindustrial në mënyrë të ndjeshme. Investimet për teknologjinë agropërpunuese kanë ardhur në rritje, duke rritur nivelin dhe cilësinë e teknologjisë së përdorur. Investimet më të mëdha janë duke u bërë në industrinë e përpunimit të qumështit. Në dy vitet e fundit shkalla e tregtimit të prodhimeve bujqësore është rritur ndjeshëm. Vëllimi i importeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale është zvogëluar me rreth 15% për këtë vit, ndërkohë që vëllimi i eksporteve bujqësore është rritur me 30%. Politikat elastike dhe ndjekja e konjunkturave të çmimeve në tregun rajonal dhe ndërkombëtar ka çuar në adaptimin e instrumenteve që ndihmojnë në realizimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore.

### 3.4.1 PLANIFIKIMI HAPËSINOR

#### **Treguesi: Përqindja e bashkive të pajisura me një plan urban sipas ligjit të urbanistikës**

Në qendër të vëmendjes gjatë vitit 2008 ka qenë finalizimi i ligjit për planifikimin territorial, i cili synon ta orientojë sektorin drejt një qasjeje moderne dhe të orientuar nga tregu, si edhe të zhvillojë një sistem kontrolli të zhvillimit që do të lehtësojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2008 janë kryer një varg konsultimesh dhe drafti është rishikuar disa herë, para se të miratohej në Këshillin e Ministrave dhe të paraqitej në Parlament në shkurt të vitit 2009. Nëse fillon të zbatohet, ligji i ri i planifikimit të territorit do të ofrojë një kuadër ligjor dhe institucional për harmonizimin hapësinor të interesave publike dhe private, përmes një orientimi efektiv të zhvilluesve dhe investitorëve privatë, duke kryer njëkohësisht koordinimin horizontal të kompetencave dhe atë vertikal të niveleve vendimmarrëse.

Ligji i ri synon të sjellë në të njëjtën linjë përgjegjësitë për planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit me legjislacionin për decentralizimin, ndarjen e kompetencave midis pushtetit qendror dhe atij vendor. Disa kompetenca të lidhura me planifikimin dhe menaxhimin e tokës urbane, do të transferohen në nivel vendor, me qëllim përdorimin sa më efikas të instrumenteve të planifikimit dhe mekanizmave të kontrollit. Ligji i ri pritet të institucionalizojë edhe pjesëmarrjen dhe konsultimin publik, si edhe më tepër transparencë në procesin e planifikimit dhe të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për vitin 2008 janë miratuar në shkallë vendi studime urbanistike rajonale dhe pjesore, të cilat kanë të bëjnë me investime në ngritjen e burimeve të reja energjetike, nxitjen e zhvillimit të turizmit, ngritjen e veprave industriale me investim privat, pastrimin mjedisor të vatrave të nxehta mjedisore, si dhe rishikime (rivlerësime) të studimeve të mëparshme. Në tabelën më poshtë janë përmbledhur vendimet e dhëna nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit për vitin 2008, ku spikasin sidomos miratimet e studimeve lidhur me ngritjen e veprave të reja me energji të rinovueshme, si dhe objektet industriale.

Në periudhën në vijim, mbetet plotësimi me aktet përkatëse nënligjore të ligjit për planifikimin e territorit<sup>12</sup>, si hap themelor për orientimin e sektorit. Gjithashtu, në vijim të zbatimit të ligjit duhet të ngrihet Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit dhe duhet të fillojë hartimi i një Plani Kombëtar për Zhvillimin e territorit, si një domosdoshmëri për orientimin e zhvillimit urban të integruar dhe të qëndrueshëm për të gjithë vendin. Ndërkohë, pajisja me plane zhvillimore e të gjitha rajoneve të vendit, si dhe pajisja e qyteteve me plane rregulluese urbane, të vendit duhet të përshpejtohet për t'i paraprirë zhvillimit, sidomos të rajoneve me potencial ekonomik.

Miratuar nga KKRTRSH	Vendndodhja
Detyra projektimi për planet rregulluese:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kuçova dhe Berati (plani i përgjithshëm) në kuadër të projektit LAMP (fonde të buxhetit, të Bankës Botërore, Qeverisë Japoneze dhe Qeverisë Suedeze);</li> <li>Fieri (plani i qendrës së qytetit).</li> </ul>
Studime urbanistike pjesore, detyra projektimi/masterplane dhe sheshe të ndërtimit për vepra energjetike:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Hidrocentrali i Kalivaçit mbi lumin Vjosë;</li> <li>Central me biomasë të lëngshme 140 KW, në komunën Shëngjin, në Qarkun e Lezhës;</li> <li>Dy centrale me erë 234 KW në malin e Rrençit dhe Kakariqit, në komunën Balldre të Qarkut Lezhë;</li> <li>Parqet Eolike dhe linja e interkoneksionit, në Qarkun e Vlorës;</li> <li>Stacioni i konvertimit të energjisë elektrike, në komunën Kallmet të Qarkut Lezhë.</li> </ul>
Studime dhe leje për shesh ndërtimi për objekte industriale dhe biznese:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fabrika e çimentos, në Balldre–Lezhë (investitor “FASSA &amp; BERBERI”);</li> <li>Fabrika e çimentos Krujë (investitor “ANTEA CEMENT sh.a”);</li> <li>Impianti i bluarjes së klinkerit, në Salmone–Xhafzotaj (investitor “Shqipëria Cement Company”);</li> <li>Fabrika e çimentos “Colacem Albania”, në komunën Balldre të Qarkut Lezhë;</li> <li>Uzina e petëzimit LA CELIK–VEGA, në fshatin Laç të Qarkut Lezhë;</li> <li>Qendër tregtare në fshatin Katund i Ri, Komuna Kashar të Qarkut Tiranë (investitor “MEGATEK”);</li> <li>Qendra tregtare “EUROMAX Distribution Center Nr.1”, në fshatin Katund i Ri të komunës Kashar, Qarku Tiranë.</li> </ul>
Studime pjesore për spitale dhe sheshe ndërtimi për rehabilitim mjedisor:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Leje shesh-ndërtimi për Spitalin privat “HYGEIA” në Tiranë;</li> <li>Vendhedhje e mbetjeve urbane të qytetit Bajram Curri;</li> <li>Vendgrumbullimi i mbetjeve të rrezikshme në Uzinën e Metalurgjisë së Bakrit, në Rubik;</li> <li>Në fshatin Marinëz, komuna Kuman në Qarkun Fier: <ul style="list-style-type: none"> <li>Impianti i dekantimit të naftës CFT;</li> <li>Gropa ekologjike për depozitimin e rërës, pas trajtimit të naftës;</li> <li>Gropa ekologjike për depozitimin e dherave të kontaminuara të puseve të naftës.</li> </ul> </li> </ul>
Studime urbanistike pjesore, detyra projektimi, plane zhvillimi, ndryshime në planet ekzistuese, për investime në fushën e turizmit:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kompleksi turistik me sip. 59.090 m<sup>2</sup> në zonën turistike të Gjirit të Lalzit;</li> <li>Plani i Zhvillimit të Bregdetit të Jugut në kuadër të projektit të Bankës Botërore;</li> <li>Studimi i zonës turistike Radhimë–Orikum;</li> <li>Faza e dytë e fshatit turistik të shoqërisë “MAK-ALBANIA”, në Golem;</li> <li>Kompleksi rezidencial prej 56.200 m<sup>2</sup> në zonën turistike Velipojë;</li> <li>Ndryshim i studimit urbanistik për zonën prej 0.19 ha nga Hotel Turizmi deri tek Kanali i Çukës, Sarandë.</li> </ul>
Kufij të zonave informale:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për Qarqet e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Elbasanit, Kavajës, Vlorës, Korçës; zonën Lazarat në Qarkun e Gjirokastrës.</li> </ul>
Studime urbanistike për objekte të tjera:	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qendra e mbyllur e pritjes së emigrantëve të parregullt, në fshatin Karrec në Maminas–Durrës (investitor Ministria e Brendshme);</li> <li>Godina e Emisionit Monetar, në Qesarakë të komunës Dajt (investitor Banka e Shqipërisë);</li> <li>Rruga paralele e superstradës Tiranë-Vorë, ura e Limuthit.</li> </ul>

12 Ligji nr. 10119 “Për planifikimin e territorit”, datë 23.04.2009

### 3.4.2 ZHVILLIMI RAJONAL

#### **Treguesi: Niveli i zhvillimit ekonomik-shoqëror**

Gjatë vitit 2008 në qendër të vëmendjes ka qenë hartimi i draft-ligjit “Për zhvillimin rajonal në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton objektivat, parimet, instrumentet dhe kuadrin institucional për menaxhimin e zhvillimit rajonal.

Draft-ligji është konsultuar me një numër të gjerë aktorësh të interesit dhe do të finalizohet në kuadër të zbatimit të projektit “Mbështetje e integruar për decentralizimin”, me financim të Komisionit Evropian (CARDS 2005). Projekti do të menaxhohet nga PNUD-i, në bashkëpunim me METE-n, dhe në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Integritimit, Ministrinë e Brendshme, përfaqësuesit e qarqeve dhe Komisionin Evropian. Gjatë vitit 2008 është punuar për përgatitjen e projektit final dhe procesit të selektimit të konsulencës teknike. Ky projekt do të përgatisë Dokumentin për Politikën e Zhvillimit, në kuadër të të cilit do të bëhet edhe vlerësimi i draft-ligjit për zhvillimin rajonal, për kuadrin rregullator dhe institucional për zbatimin e tij. Duhet theksuar se miratimi i ligjit për zhvillimin rajonal përbën kusht për vijimin e mëtejshëm me zbatimin e programit dhe ngritjen e strukturave në nivel qendror dhe rajonal (qarqe) për menaxhimin e politikave të zhvillimit rajonal, ndërtimin e partneriteteve dhe të kapaciteteve për bashkëpunim të decentralizuar.

Në përputhje me të dhënat e Strategjisë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rajonal (SNZHR), treguesit e zhvillimit ekonomik-shoqëror të qarqeve dhe indekset e klasifikimit të zonave të pafavorizuara përlogariten çdo pesë vjet, që do të thotë se rivlerësimi i zonave të pafavorizuara të përcaktuara në SNZHR do të bëhet në vitin e pestë të zbatimit të programit, në të cilin do të rishikohet edhe harta kombëtare e këtyre zonave të pafavorizuara të përcaktuara në SNZHR.


Për sa i takon treguesve ekonomik-shoqëror në planin rajonal, bashkitë dhe komunat klasifikohen në bazë të indeksit të nivelit të varfërisë dhe indeksit të zhvillimit njerëzor të përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Rajonal. Aktualisht varfëria në zonat rurale është 50% më e lartë se në zonat urbane; për Tiranën indeksi i PBB-së është 0.772 krahasuar me 0,252 në zonat rurale, ndërsa indeksi i zhvillimit njerëzor për Tiranën (HDI) është 0,830 krahasuar me 0,632 në zonat rurale. Në planin rajonal ka pabarazi të theksuara: papunësia në Kukës është tri herë më e lartë se në Tiranë, garantimi i ujit të pijshëm në Vlorë është 2,5 herë më i lartë se në Dibër, garantimi i shërbimeve shëndetsore në Kukës është 2,5 herë më i ulët se në Tiranë, në arsimin e detyrueshëm numri i nxënësve që përsërisin klasën në Kukës është dhjetë herë më i lartë se në Tiranë.

### 3.4.3 ZHVILLIMI RURAL

#### **Treguesi: Madhësia mesatare e njërive ekonomike bujqësore (ha) krahasuar me vendet e rajonit**

Në Shqipëri bujqësia është e sunduar nga ferma me sipërfaqe të vogël dhe të copëzuara në mesatarisht 3.9 parcela për fermë, me një madhësi mesatare prej 0.25 hektarësh. Madhësia mesatare e fermës në vitin 2008 është 1.2 ha kundrejt 1.14 ha në vitin 2007. Madhësia e fermës nga viti 2007 deri në vitin 2008 ka patur një rrije prej 11.1%. Parcelizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe ka bërë që përdorimi në shkallë të gjerë i mekanikës bujqësore të jetë i vështirë. Rreth 70% e fermave janë kryesisht në zonat malore, të cilat prodhojnë për vetëkonsum, ndërsa vetëm 30% e fermave janë të orientuara në treg më pranë zonave urbane dhe në tokat më pjellore. Referuar periudhës kohore për madhësinë e fermës bujqësore në Shqipëri mund të gjykohet se në vite ka patur një evoluim të lehtë me tendencë në rritje, çka përgjithësisht tregon një trend pozitiv. Kjo tregon një prirje të fermerëve për të bashkuar forcat e mjetet për realizimin e prodhimit, por tregon gjithashtu edhe prirjen e disa fermerëve për të blerë apo marrë në përdorim mjete prodhimi nga fermat më të vogla, të cilat janë inaktive ose dhe të braktisura. Në krahasim me vendet e Ballkanit, madhësia e fermës në Shqipëri është më e vogël, dhe dominohet nga ferma të cilat janë kryesisht familjare.

Figura 34. Madhësia mesatare e njësive ekonomike bujqësore të vendeve të rajonit



Burimi: MBUMK

Në Bullgari, toka bujqësore zë 6.2 milion ha, ku 77% është tokë arë dhe 23.5 kullota. Nga kjo sipërfaqe, 60% e tokës është private dhe vetëm 40% është shtetërore. 29% e kullotave janë pronë private, nga këto 33% janë pronë e kooperativave; dhe 71% janë kullota shtetërore. Madhësia mesatare e fermës është 2 ha e shpërndarë në 4-5 parcela.

Në Rumani, totali i tokës bujqësore është 14 791 000 ha, dhe përfaqëson 63% të territorit të vendit. Gjatë reformës së tokës rreth 9,400,000 ha e tokës u privatizua, me rreth 1,300,000 ha në zonat malore, pra kanë mbetur pronë shtetërore 4,091,000 ha. Madhësia mesatare e fermës është 2.28 ha e shpërndarë në 3-4 parcela. Madhësitë e fermave me më pak se 1 ha zënë 45%, ato me 1-2 ha 24% dhe fermat me më shumë se 2 ha zënë 31% të totalit të tokës bujqësore.

Rreth 80% e tokës bujqësore në Serbi është e privatizuar dhe numërohen rreth 778,891 ferma, nga të cilat 12% janë nën 2 ha të tokës arë dhe 25% të tokës arë e zënë fermat me mbi 10 ha, të shpërndara në 2-3 parcela. Madhësia mesatare e fermave është 3.68 ha.

Në kuadrin e reformës së tokës, në kuptimin sasior ka përfunduar ndarja e tokës bujqësore. Aktualisht pronësia mbi tokën përfshin 80% pronë private dhe 20% pronë shtetërore. Ndarja e tokës ka arritur në 561 mijë hektarë, që përbën 98.6% të fondit të tokës të parashikuar për ndarje prej 569 mijë hektarësh. Procesi i dhënies së titujve të pronësisë, ose dhënia e “aktit të marrjes së tokës në pronësi”, si sipërfaqe, ka arritur në 542 mijë hektarë ose 97.2% e të gjithë sipërfaqes që realisht është ndarë. Janë evidentuar sipërfaqet e tokave shtetërore disponibël dhe janë kaluar në Agjencinë e Kompensimit dhe Kthimit të Pronave (AKKP), rreth 17 335 ha për krijimin e fondit të kompensimit fizik të subjekteve të shpronësuar. Mbrojtja e tokës përbën një proces të rëndësishëm të reformës.

Për herë të parë, është përgatitur “Kartela e Fermës”, me të dhënat kryesore të marra për mbi 300 mijë ferma në shkallë vendi, informacion i cili është kompjuterizuar dhe përdoret për qëllime të ndryshme si për përfitimin e TVSH-së së rimbursueshme prej 6% nga fermerët e formalizuar.

Në sajë të politikave të ndërmarra është nxitur konsolidimi i fermave nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të shoqatave të fermerëve, futjes së teknologjisë bujqësore, si edhe forcimit të sistemit të marketingut dhe nivelit të arsimit teknik të operatorëve të fermave, krijimit të mundësive për hyrje në treg të fermerëve, vazhdimet të politikës së rritjes së zhvillimit si mënyra më efektive për të ulur varfërinë në zonat rurale. Përpjekjet kryesore do të ndërmerren në kreditimin e fermerëve duke i nxitur ata të rrisin madhësinë e fermave, të cilat do të lehtësojnë dhe do të krijojnë mundësi në marrjen e kredive. Synimi është që në vitin 2013 madhësia mesatare e fermës të arrijë 1.8 ha.

## Treguesi: Numri i kilometrave të rrugëve rurale që janë ndërtuar


Vendi ynë zotëron një inventar rrugësh rurale prej 12 mijë km, nga të cilat 4,980 km janë rrugë rurale me karakter komunal dhe 4,471 km janë rrugë me karakter rajonal. Kontributi i këtij rrjeti rrugësh në zhvillimin e bujqësisë dhe rëndësia që ka bujqësia për PBB-në për zhvillimin ekonomik të vendit dhe uljen e varfërisë, nënvizon rëndësinë që ka përmirësimi sa më i shpejtë i rrjetit të rrugëve sekondare dhe lokale.

Gjatë viteve të fundit me prioritet janë parë seksionet e rrugëve sekondare dhe lokale në rrjetin rrugor; krijimi i një sistemi të përshtatshëm për menaxhimin e aseteve të rrugëve për përcaktimin e investimeve prioritare për rrugët sekondare dhe lokale; përgatitja së bashku me përfaqësuesit e komunitetit lokal e projekteve inxhinierike të detajuara për 5 vite. Janë konsideruar me përparësi rrugët në nivel qarku, duke filluar me ndërhyrjet në zonat bujqësore. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FZSH) është një nga zbatuesit kryesorë të rrugëve rurale, në një projekt, i cili ndihmon në përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat përkatëse, duke bërë të mundur integrimin e tyre në jetën sociale dhe ekonomike.

Gjatë periudhës 2005-2009 vetëm nga projekti i rrugëve rurale janë ndërtuar 597.07 km. Investimet publike për zhvillimin rural dhe bujqësor janë rritur me 14%, dhe janë në rritje nga viti në vit. Në total, për periudhën 2005-2009, investimet arrijnë në 110 miliardë lekë, afërsisht 1,2 miliardë dollarë, 3,2 herë më shumë se i gjithë investimi prej 33 miliardë lekësh, që u bë në fshat, gjatë viteve 2002-2004. Gjatë 2005-2009 janë ndërtuar 1,607 km rrugë, me një investim prej 57 miliardë lekësh.

Investimet, në rrugët e fshatrave, janë rritur nga 500 milionë lekë, që ishin në vitin 2004, në 7 miliardë lekë në vitin 2008, pra 14 herë.

Figura 35. Numri i kilometrave të rrugëve të shtruara rurale 2005-2009



Burimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

### 3.4.4 BUJQËSIA

#### Treguesi: Prodhimtaria në bujqësi dhe në agropërpunim


Sektori i bujqësisë dhe ushqimit u plotësua me disa prej ligjeve më të rëndësishme që përputhin standardet e Shqipërisë me ato të BE-së, akte nënligjore, rregullore dhe direktiva në përputhje me standardet e BE-së dhe MSA-në, duke siguruar një shtrat ligjor, mbi të cilin garantohen standarde të përputhura me ato evropiane në procesin e prodhimit, përpunimit e tregtimit të produkteve ushqimore që gjenerohen nga bujqësia.

Prodhimi bujqësor bruto është rritur me rreth 6.5 miliardë lekë, 4.5% në krahasim me vitin 2005; pemëtaria me rreth 23% dhe prodhimi blegtoral me rreth 5.2%. Prodhimi agroindustrial u rrit me rreth 9 miliardë lekë ose rreth 19%. Rritje më të madhe kanë shënuar prodhimi i frutave me 33.3%; dhe mishit me 19.4%.

Nga viti në vit ka ardhur duke u rritur pjesa e investimeve që shkon për teknologji kundrejt asaj pjese të investimeve që shkon për objektet ndërtimore, çka tregon se krahas përmirësimit sasior të investimeve, ka

filluar edhe një përmirësim cilësor i tyre, duke rritur nivelin teknologjik të industrisë, me të gjitha rrjedhojat pozitive të këtij fenomeni. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit vihet re një rritje e burimeve të financimit të siguruara nga vetë investitorët dhe nga kreditë bankare të vendit. Investimet më të mëdha janë duke u bërë në industrinë e përpunimit të qumështit, ndërsa investimet në prodhimin e miellit dhe bukës së bashku kanë pësuar rënie.

Prodhimi bujqësor, blegtoral dhe agroindustrial është rritur në mënyrë të ndjeshme sikurse paraqitet në figurën 36:



Burimi: Anketa 2008 e OKB-së për qeverisjen elektronike

Vlera e prodhimit të industrisë ushqimore rezulton të jetë 18% e vlerës së prodhimit të përgjithshëm agroushqimor (sipas INSTAT). Për sa i përket numrit të bizneseve agropërpunuese, industria e bukës dhe embëlsirave është në vendin e parë me 966 fabrika, ose 47% e totalit, e ndjekur nga industria e përpunimit të qumështit me rreth 362 fabrika e baxho ose 18% dhe nga industria e miellit me 272 sipërmarrje ose 13% e totalit. Bazuar në disa tregues, sipërmarrjet agroushqimore janë shumë të vogla dhe pjesa më e madhe e tyre nuk i arrijnë standardet e sigurisë së BE-së, si rrjedhim ato nuk kanë mundësi për t'u paraqitur në tregun e huaj, veçanërisht atë të BE-së. Në 2008 u prodhuan 312 mijë ton grurë, ose 20 përqind më shumë se në 2007. Në 6 mujorin e parë 2008, Shqipëria prodhoi 270 mijë ton perime, nga të cilat 62 mijë ton në sera. Ndërsa prodhimi i agroindustrisë në këtë 6-mujor u rrit me 12% krahasuar me 2007-tën.


Të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore janë rreth 220 mijë lekë për fermë, 58% e kësaj shume përftohet nga produktet blegtorale. Rreth 43% e fermave marrin rreth 55 mijë lekë të ardhura dhe vetëm 13% e fermave marrin mesatarisht mbi 400 mijë lekë të ardhura. Të ardhurat nga shitja e produkteve bimore për fermë janë rreth 92 mijë lekë në vit. 75% e fermerëve realizojnë të ardhura nën 44 mijë lekë në vit, kurse 35% realizojnë nga shitja më pak se 10 mijë lekë në vit. Për rritjen e shkallës së konkurrueshmërisë së industrisë së përpunimit të ushqimeve në Shqipëri nevojiten investime për të mbështetur politikatat përkatëse të zhvillimit. Industria ushqimore, si një degë e rëndësishme e ekonomisë shqiptare ka shënuar zhvillim të dukshëm dhe të qëndrueshëm gjatë viteve të fundit.

### Treguesi: Vëllimi i eksporteve në bujqësi dhe agroindustri

Sipas të dhënave nga INSTAT-i, produktet bujqësore, për grupet “Peshk dhe kafshë guaskore të nënujshme”, janë rritur në 2008 me 70.4% më shumë se në vitin paraardhës. Në grupin e “Farëra vajore, bimë industriale dhe medicinale, ushqim për kafshët”, në vitin 2008 rritja ka qenë në nivelin e 17.2%. Vlera e eksportit në grupet “Ushqimet e përgatitura prej mishi, peshku, molusqe, etj.,” është ulur me 3.3% në vitin 2008 krahasuar me një vit më parë. Grupi “Pije, alkool dhe uthull” ka pësuar një rënie drastike prej 86.2% në 2008 krahasuar me vitin



2007. Për grupin “Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit”, vlera e eksportit ka patur ulje në vitin 2008 me 64.9% krahasuar me vitin 2007.



Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Zhvillimi i bujqësisë dhe rritja e eksporteve ka ardhur si pasojë e rritjes së prodhimit vit pas viti për plotësimin e nevojave të vendit me ushqime.

Shumica e ushqimeve prodhohen në vend në masën mbi 80 përqind dhe eksporti në secilin nga dy vitet e fundit është rritur me nga 25 përqind. Për vitin 2007 në të gjitha llojet e perimeve së bashku, prodhimi i brendshëm ishte 671 mijë ton, importi 17 mijë ton. Prodhimi i gjithë llojeve të frutave së bashku ishte 148 mijë ton, ose dy herë më i madh se pesë vite më parë, ndërsa importi 90 mijë ton. Rreth 80 përqind të pjesës dërmuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale, konsumatorët e marrin nga prodhimi vendas.

Në dy vitet e fundit shkalla e tregtimit të prodhimeve bujqësore është rritur ndjeshëm. Vëllimi i importeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale është zvogëluar me rreth 15% për këtë vit, ndërkohë që vëllimi i eksporteve bujqësore është rritur me 30%. Politikat elastike dhe ndjekja e konjunkturave të çmimeve në tregun rajonal dhe ndërkombëtar ka çuar në adaptimin e instrumenteve që ndihmojnë realizimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore.


Gjithashtu për të ardhmen do të synohet ndërmarrja e një politike që mbështet rritjen e tregtueshmërisë së prodhimit bujqësor në Shqipëri dhe që zhvillon këtë sektor. Rritja e shkallës së tregtueshmërisë së prodhimeve bujqësore është instrumenti për ta nxjerrë nga vetëizolimi dhe nga kushtet e vetëmjaftueshmërisë ushqimore, në të cilat janë vënë familjet fermere dhe fermat e vogla bujqësore.

### 3.4.5 TURIZMI


#### Treguesi: Numri i turistëve sipas rajoneve të origjinës

Në figurën 38 dallohet qartë rritja e numrit të turistëve gjatë vitit 2008, ku numri total i vizitorëve arriti në 2.5 milion<sup>13</sup>, duke përfshirë këtu edhe emigrantët jorezidentë në Shqipëri, nga të cilët 1.33 milionë ishin vizitorë të huaj. Ndërkohë, periudha janar-gusht 2009 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ka patur një rritje në numrin e vizitorëve të huaj me 42.5%.

<sup>13</sup> Duke përfshirë këtu edhe emigrantët jorezidentë në Shqipëri sipas përcaktimeve të OBT-së, numri i turistëve për vitin 2008 arriti në 2.5 milion vizitorë, duke përfshirë këtu edhe emigrantët jorezidentë në Shqipëri sipas përcaktimeve të OBT-së.



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Shtetet pranë Shqipërisë kanë gjeneruar dhe numrin më të lartë të vizitorëve, siç është Kosova me 32%, Maqedonia me 24%, Mali i Zi 14%, por edhe Italia 9%, Serbia 7%, Britania e Madhe 6%, Greqia 6%. Vlen të përmendim dhe vizitorët nga shtete të tjera evropiane si Gjermania, Austria dhe Franca.

Të ardhurat gjithsej nga turizmi për vitin 2008 janë 1,170 milionë euro me një rritje prej 16.7% krahasuar me vitin 2007, kur të ardhurat ishin 1,002 milionë euro. Kontributi i turizmit në ekonominë shqiptare për vitin 2008 është aktualisht 11% e PBB-së, ndërsa numri i të punësuarve në sektor për 2008-ën është rreth 138,000 vetë. Fondet e buxhetit të shtetit në administrim të MTKRS-së për turizmin janë rritur nga viti në vit. Në buxhetin e vitit 2008 kanë qenë akorduar 16,400 milionë lekë dhe për vitin 2009 u akorduan 17,000 milionë lekë, kryesisht për sinjalistikën rrugore dhe aktivitete të promovimit.

Promovimi i imazhit turistik të vendit ka synuar konsolidimin e pozicionit të Shqipërisë në tregun turistik evropian dhe më gjerë. Gjatë viteve të fundit janë shfaqur spote publicitare në rrjetin e njohur televiziv CNN dhe EURONEWS para fillimit të sezonit turistik, si edhe në vendet e rajonit, në Kosovë dhe Maqedoni. Në drejtim të promovimit të imazhit turistik kanë ndikuar edhe prezantimi në vitin 2008 i Guidës Turistike mbi Shqipërinë, hartimi i paketave turistike për 10 turet e mëdha të Shqipërisë dhe 11 itineraret kulturore dhe natyrore në Bregdetin e Jugut. Shqipëria është paraqitur në mënyrë dinjitoze në Panairin e Turizmit në Berlin dhe në Londër.

Janë inkurajuar me forcë produktet e reja të turizmit, si turizmi rural që përfshin ekoturizmin, agroturizmin, turizmin sportiv malor, dhe atë kulturor. Ka filluar të zbatohet projekti i 40 Haneve, që ka të bëjë me zhvillimin



e turizmit rural dhe që konsiston në mbështetjen për përmirësimin e kushteve, promovimin dhe krijimin e paketave të përshtatshme turistike për shtëpi karakteristike me arkitekturë të veçantë, sidomos për zonën e Alpeve shqiptare. Vëmendje i është kushtuar turizmit kulturor nëpërmjet restaurimit të monumenteve të kulturës, ku vlera totale e investimeve vetëm nga buxheti i shtetit për vitin 2008 ishte 305 milionë lekë, ndërsa për vitin 2009 rreth 170 milionë lekë. Për vitin 2008, numri i vizitorëve të parqeve arkeologjike kombëtare dhe muzeve ishte 159,000 vetë, që kanë sjellë 32.2 milion lekë të ardhura.

Politikat në lidhje me trashëgiminë kulturore janë orientuar duke e trajtuar këtë fushë në funksion të turizmit. Investime të rëndësishme janë kryer për rehabilitimin e bërthamave dhe objekteve urbane me vlerë turistike dhe muzeale, si p.sh. Restaurimi në Gjirokastrë i Qendrës Historike dhe Qafës së Pazarit, Hanit të Zagorisë, Shtëpisë së Çabenjve, Shtëpisë së Ismail Kadaresë, Kalasë së Gjirokastrës. Investimi në total ka qenë 2 milionë euro, me fonde nga buxheti i shtetit (43 milionë lekë) dhe UNESCO. Janë dhënë fonde nga Komisioni Europian për projektet e restaurimit të Kalasë së Tiranës, Krujës, Himarës, Kalasë së Beratit dhe Lezhës. Gjithashtu, qytetet-muze të Gjirokastrës dhe Beratit janë shpallur kryevepra të pasurisë kulturore botërore të njerëzimit të mbrojtura nga UNESCO.

Politikat për turizmin do të orientohen drejt investimeve infrastrukturore në funksion të zhvillimit të potencialeve turistike, me qëllim që të gjitha zonat turistike të vendit, bregdetare, malore e kulturore të jenë të pajisura me infrastrukturë dhe të jenë të lidhura me rrjetin kombëtar. Në këtë aspekt, zonat turistike do të zhvillohen mbi bazën e planeve të përgjithshme dhe/ose tematike.

Veç zhvillimit të turizmit bregdetar, vëmendje do t'i kushtohet turizmit kulturor, që është turizëm me të ardhura më të mëdha, si dhe atij natyror dhe të interesit të veçantë, gjë që do të sjellë shtrirje më të madhe të sezonit turistik. Për këtë do të kryhen investimet në zonat natyrore dhe kulturore, si edhe do të rriten financimet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aseteve dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit për zonat me interes kulturor dhe natyror.

Në vijim, do të synohet thithja e investitorëve me emër në fushën e turizmit dhe operatorëve të suksesshëm ndërkombëtar për të ndërtuar resorte me shumë shërbime e argëtime që ofrojnë një produkt turistik kompleks. Ndërkohë, në funksion të zhvillimit të sektorit të turizmit do të nxiten dhe stimulohen bizneset përmes formalizimit dhe krijimit të lehtësirave fiskale.

Gjithashtu, do të përmirësohet menaxhimi i informacionit mbi të dhënat statistikore, sipas standardeve ndërkombëtare, në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, si dhe do të punohet më tej për rritjen e imazhit pozitiv të vendit, për të krijuar profilin turistik të vendit, të qartë e të dallueshëm nga vendet fqinjë.

# shtojca 1 Tabela e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale dhe statusi i tyre deri në fund të tetorit 2009

Strategji sektoriale		Miratuar me VKM	Në fazë përfundimi
•	Bujqësia dhe ushqimi	X	
•	Mbrojtja	X	
•	Zhvillimi i biznesit dhe investimeve të huaja (përfshin edhe industrinë jo-ushqimore, industrinë minerare)	X	
•	Energjetika		X
•	Arsimi parauniversitar (arsimi bazë, dytësor, i mesëm, profesional)	X	
•	Arsimi i lartë	X	
•	Financat (përfshirë tatimet dhe doganat)	X	
•	Sigurimet shoqërore		X
•	Marrëdhëniet me jashtë		X
•	Shëndetësia		X
•	Rendi publik	X	
•	Drejtësia		X
•	Punësimi	X	
•	Mbrojtja sociale	X	
•	Planifikimi hapësinor (përfshirë strehimin)		X
•	Furnizimi me ujë dhe kanalizimet		X
•	Transporti	X	
•	Turizmi	X	
•	Kultura		X
•	Sporti		X
•	Statistikat	X	
Aneksi 1	Strategji ndërsektoriale	Miratuar me VKM	Në fazë përfundimi
•	Decentralizimi		X
•	Zhvillimi rajonal	X	
•	Zhvillimi rural	X	
•	Shoqëria e informacionit	X	
•	Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë		X
•	Përfshirja sociale	X	
•	Lufta kundër korrupsionit dhe qeverisja transparente	X	
•	Mjedisi	X	
•	Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut	X	
•	Migracioni	X	
•	Barazia gjinore dhe parandalimi i dhunës në familje	X	
•	Menaxhimi i integruar i kufijve	X	
•	Rinia	X	
•	Lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe terrorizmit	X	
•	Reforma në administratën publike	X	
•	Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore, trafikut të fëmijëve	X	
•	Strategjia e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit	X	

# shtojca II: Raport mbi Rishikimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit

## HYRJE

Shqipëria ka treguar vullnet të fortë politik në drejtim të arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), duke i përshtatur ato sipas nevojave të vendit në nivel kombëtar. Procesi i përcaktimit të synimeve nisi në vitet 2002-2003, me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë në korrik të vitit 2003 të rezolutës në mbështetje të OZHM-ve, duke inkurajuar Qeverinë, shoqërinë civile dhe institucione të tjera të punojnë së bashku për arritjen e këtyre objektivave. Objektivat specifike dhe treguesit përkatës për Shqipërinë u përcaktuan në vitin 2005, përmes një procesi të gjerë konsultimi të zhvilluar nga qeveria e atëhershme, me institucionet qendrore, grupet e interesit, shoqërinë civile, dhe komunitetin e donatorëve. Parlamenti shqiptar ka kërkuar vazhdimisht përditësime mbi OZHM-të dhe seanca më e fundit, në maj 2006, shqyrtoi natyrën plotësuese të OZHM-ve dhe Integrimin në Bashkimin Evropian (BE).

Në vitin 2007, u rishikua kuadri i monitorimit të OZHM-ve dhe në listën e OZHM-ve u përfshinë edhe katër synime të tjera. Vendimi për rishikimin e listës u mor nga vendet anëtare në Samitin Botëror 2005 (rezoluta e adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme A/RES/60/1), si dhe u mbështet nga raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (paragrafi 24, A/61/1) me rekomandimet e “Inter-Agency and Expert Group on MDG Indicators” (IAEG). Kjo listë hyri në fuqi në 15 janar 2008.

Tetë OZHM-të për Shqipërinë, së bashku me një objektiv të nëntë për Mirëqeverisjen, krijojnë një kompleks angazhimesh kombëtare drejt secilit prej prioritetëve të zhvillimit të vendit. Me përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Shqipëria i ka harmonizuar OZHM-të me agjendën e Bashkimit Evropian dhe strategji të tjera sektoriale e ndërsektoriale në një sistem planifikimi të integruar. SKZHI-ja përfaqëson dokumentin e parë strategjik të qeverisë që njeh përgjegjësinë e plotë për monitorimin e progresit drejt arritjes së OZHM-ve. Objektivat specifike dhe treguesit e OZHM-ve janë përfshirë gjithashtu edhe në strategjitë sektoriale e ndërsektoriale të përgatitura në kuadër të SKZHI-së.

Raportimi dhe monitorimi i progresit të OZHM-ve është një proces i rëndësishëm që ndihmon në rinovimin e angazhimeve politike mbi bazën e objektivave të zhvillimit, si dhe në çështje që lidhen me prioritete specifike të OZHM-ve në strategjitë kombëtare, sektoriale e ndërsektoriale. Raporti Vjetor i Progresit 2005, si dhe Raporti i Progresit të SKZHI-së 2006-2007, të përgatitura nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave, kanë përfshirë si pjesë të tyre raportimin mbi progresin e OZHM-ve përkatësisht për vitin 2005 dhe harkun kohor 2006 – 2007.

Pjesa e raportimit mbi OZHM-të, e hartuar me mbështetjen e PNUD-it, bën një vlerësim të përgjithshëm nëse do t'i arrijë Shqipëria të gjitha synimet deri në vitin 2015. Vlerësimi bazohet në një analizë të prirjeve gjatë dhjetëvjeçarit të fundit për treguesit që lidhen me secilin prej objektivave si dhe në statusin e mjedisit aktual mbështetës. Sipas këtij vlerësimi konstatohet se Shqipëria është në rrugë të mbarë për arritjen e OZHM-ve dhe është duke përmbushur disa nga objektivat e përcaktuara në nivel global e kombëtar. Gjithashtu, rezulton se disa tregues mund t'i arrijnë synimet e caktuara para vitit 2015, ndërsa disa të tjerë janë shumë ambiciozë dhe të paarrtshëm për vitin 2015. Në këto raporte rekomandohet që të merret parasysh miratimi i objektivave specifike më ambicioze (të ashtuquajturat OZHM-plus) nga Qeveria Shqiptare.

Në shtator të vitit 2008, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) ndërmori nismën për organizimin e procesit të rishikimit të OZHM-ve. Në këtë nismë DEBASKON-i u mbështet nga përfaqësues të Kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore dhe DFID-së në Shqipëri, me të cilët u diskutua paraprakisht mbi përcaktimin dhe arritjen e objektivave më ambicioze të OZHM-ve, mbështetur në platformën ekzistuese dhe duke e ngritur këtë platformë në një nivel më të lartë. Duhet theksuar se për herë të parë që nga koha e përcaktimit të OZHM-ve në Shqipëri, Qeveria ka marrë një rol aktiv e nismëtar lidhur me rishikimin e OZHM-ve dhe përdorimin e tyre si një instrument për mirësimin e përgjegjshmërisë së qeverisjes.

## QËLLIMI I RISHIKIMIT TË OZHM-VE

Procesi i rishikimit të objektivave specifike dhe treguesve të OZHM-ve ka si qëllim që: (i) OZHM-të të pasqyrojnë më mirë stadin më të avancuar të zhvillimit ekonomik-shoqëror dhe aspiratën e vendit për t'u anëtarësuar në BE, në një të ardhme të afërt; (ii) ngritjen e një sistemi monitorimi funksionues për OZHM-të, duke ndarë përgjegjësitë institucionale midis institucioneve dhe aktorëve të tjerë.

Nisur nga niveli i zhvillimit ekonomik-shoqëror, Shqipëria ka akoma nevojë të monitorojë një nivel të mirëqenies bazike siç përkufizohet nga OZHM-të. Bazuar në monitorimin e deritanishëm, varfëria absolute, megjithëse në rënie të ndjeshme, ende përbën një sfidë për vendin. Gjithashtu, regjistrimi në arsimin bazë ka ende mjaft për të bërë për të qenë i përgjithshëm; vdekshmëria e fëmijëve dhe e nënave është akoma shqetësuese; niveli i popullsisë që e ka të garantuar ujin e pijshëm është ende larg madje edhe nga niveli i vendeve fqinje me Shqipërinë. Në këto rrethana, ndjehet nevoja e monitorimit të mirëqenies bazike, sipas kuadrit të OZHM-ve. Nga ana tjetër, Shqipëria ka paraqitur kërkesën dhe aspiron të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (BE) në një periudhë afatshkurtër deri në afatmesme. Kjo do të thotë se vendi duhet të përdorë gradualisht sistemin e treguesve të përfshirjes sociale të BE-së. Për rrjedhojë, është logjike që sistemi i objektivave dhe treguesve të OZHM-ve të monitorohet paralelisht për disa vite me sistemin e treguesve të përfshirjes sociale. Mbështetur në këto argumente, sistemi i rishikuar i objektivave dhe treguesve pasqyron njëherazi nivelin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit dhe aspiratën e shqiptarëve për t'u anëtarësuar në BE.

## METODOLOGJIA DHE PROCESI

Procesi i rishikimit të OZHM-ve u udhëhoq nga DEBASKON-i, me mbështetjen e PNUD-it, dhe u zhvillua në disa faza në periudhën mars-qershor 2009. Për zhvillimin e procesit të rishikimit të objektivave dhe treguesve të OZHM-ve, u ngritën 7 grupe pune, dhe konkretisht: (i) reduktimi i varfërisë, (ii) arsimi, (iii) shëndetësia, (iv) barazia gjinore, (v) mjedisi, (vi) partneriteti global, dhe (vii) qeverisja. Në këto grupe pune morën pjesë ministri të linjës, përfaqësues të institucioneve publike me ekspertizë dhe eksperiencë në përgatitjen dhe monitorimin e strategjive, organizata jofitimprurëse, si edhe u përfshinë në mënyrë aktive agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Gjatë procesit të rishikimit të objektivave ekzistuese, përcaktimit të objektivave të reja dhe identifikimit të treguesve të rinj, grupet e punës: (i) zhvilluan një proces konsultimi me grupet e interesit, (ii) pasqyruan ambicien politike e sociale të qeverisë dhe aktorëve të tjerë jashtë-qeveritarë, (iii) morën në konsideratë objektivat dhe nivelin e treguesve të BE-së dhe vendeve të rajonit, (iv) morën në konsideratë trendin e vërejtur në vite, (v) morën parasysh alokimet financiare të deriatëhershme dhe të pritshme, si dhe (vi) pasqyruan rekomandimet e Raportit të Progresit të SKZHI-së 2006-2007, veçanërisht të Raportit mbi Progresin e OZHM-ve.

Në këtë proces, grupet e punës u orientuan në mënyrë të tillë që të përcaktonin tregues, të cilët të ishin njëherazi në përputhje me treguesit globalë të OZHM-ve, treguesit e Përfshirjes Sociale të BE-së, duke qenë njëkohësisht tregues realistë dhe të arritshëm nga institucionet shqiptare. Procesi përfshiu disa etapa diskutimi: (i) rishikimi i objektivave të përgjithshme, objektivave specifike dhe treguesve; (ii) rishikimi i nivelit të treguesve, duke pasqyruar aspiratën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE; (iii) përcaktimi i përgjegjësisë institucionale për përcaktimin e nivelit, si dhe për monitorimin e treguesve dhe niveleve të synuara prej tyre; (iv) përcaktimi i burimit të informacionit.

## OZHM 1: Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe zbutja e riskut të përjashtimit social

Përmirësimet për OZHM 1, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### 1. Është ndryshuar formulimi i Objektivit të përgjithshëm dhe objektivave specifike

Ndryshimi më i rëndësishëm lidhur me objektivin e përgjithshëm është përfshirë në formulimin e zbutjes së riskut të përjashtimit social, sipas logjikës evropiane. Kjo reflektohet edhe në përfshirjen si objektiv i veçantë specifik i “Përafrimit të modelit të shpërndarjes së të ardhurave me modelin evropian”. Nga ana tjetër, objektivat ekzistuese specifike, janë bërë më ambicioze.

### 2. Niveli i synuar i treguesve është bërë më ambicioz

Kjo është e vërtetë për shumicën e treguesve, por veçanërisht për pjesën e varfërisë absolute, hendekun e varfërisë, kequshqyerjen e fëmijëve deri në 5 vjeç, etj.

### 3. Janë përfshirë tregues të rinj

Treguesit e rinj monitorojnë varfërinë relative (përjashtimin social) dhe dimensione të tjera të kequshqyerjes së fëmijëve deri në 5 vjeç.

### 4. Janë hequr disa tregues që ishin pjesë e sistemit të mëparshëm të monitorimit

Treguesit që monitorojnë teknologjinë e informacionit dhe komunikimit janë transferuar tek OZHM 8. Nga ana tjetër, sistemi është “lehtësuar” nga treguesi i Investimeve të Huaja Direkte dhe treguesi i përdorimit të energjisë.

Sistemi i monitorimit për OZHM-të, në mënyrë të përmbledhur, paraqitet në pasqyrën që vijon:

## OZHM1: Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe zbutja e riskut të përjashtimit social

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015 raporti 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli i synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
1.1. Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe reduktimi 3 herë i varfërisë absolute mes 2002 dhe 2015	1.1.1. Përqindja e popullsisë nën nivelin e varfërisë absolute (Përqindja e popullsisë nën vijën kombëtare të varfërisë absolute )	Total	LSMS, çdo tre vjet, BHS	INSTAT	%	13	12.4	8	MPÇSSHB
		F			%	Np	12.9	8.2	
		M			%	Np	11.9	7.6	
	1.1.2. Përqindja e popullsisë nën nivelin e varfërisë ekstreme	Total			%	0	1.2	0	
		F			%	0	1.3	0	
		M			%	0	1	0	
	1.1.3. Hendeku i varfërisë	Total			%	3	2.3	1.2	
1.1.4. Përqindja e kuantilit më të varfër në konsumin kombëtar	Total	%	6.3	9.2%	>10				
1.1.5. <sup>1</sup> Pjesa e fëmijëve nën 5 vjeç nën peshë	Total	%	8	5	3	MSH			
1.1.6. Pjesa e fëmijëve deri në 5 me raport të pafavorshëm peshe për gjatësi	Total	%	np	9	6				
1.1.7. Pjesa e fëmijëve me raport të pafavorshëm gjatësi për moshë (stunting)	Total	%	np	19	17				

1.2. Ulja e nivelit të papunësisë drejt nivelit aktual të BE-së, nga 2002 - 2015	1.2.1. Shkalla e papunësisë	Total	LFS, Të dhëna	INSTAT	%	7	13	9	MPÇSSHB
		F			%	np	13.54	9	
		M			%	np	12.45	9	
1.3. Përmirësimi i shpërndarjes në mënyrë të tillë që modeli i shpërndarjes t'i përfarohet modelit evropian nga 2008 - 2015	1.3.1. Shkalla e varfërisë relative	Total	BHS	INSTAT	%	np	15.6	15	
		F			np	16.1	15		
		M			np	15	15		
	1.3.2. Shkalla e varfërisë relative para transfertave	Total	BHS		np	nd	np		
		F			np	nd	np		
		M			np	nd	np		
	1.3.3. Hendeku i varfërisë relative	Total	BHS		%	np	3.14	3	
		F			np	3.31	3		
		M			np	2.97	3		
	1.3.4. Raporti i kuantileve ekstreme	Total	BHS		%	np	4.1	4	
	1.3.5. Kohezioni rajonal (Shpërndarja e papunësisë me të dhëna sipas qarqeve)	Total	LFS		%	np	nd	11.1 (BE07)	

Shënim: BE=Bashkimi Evropian, F=Femra, M=Meshkuj, LSMS=Living Standards Measurement Survey (Vëzhgimi i Matjes së Nivelit të Jetesës), HBS=Household Budget Survey (Vëzhgimi i Buxhetit të Familjes), DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), LFS=Labor Force Survey (Vëzhgimi i Forcave të Punës), INSTAT=Instituti i Statistikave, MPÇSSHB=Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, MSH=Ministria e Shëndetsisë

np=nuk është përcaktuar, nd=nuk disponohet

## **OZHM 2: Sigurimi i arsimit bazë me cilësi të lartë për të gjithë**

Përmirësimet për OZHM 2, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### *1. Janë riformuluar objektivat specifike ekzistuese*

Objektivi i frekuentimit të përgjithshëm të arsimit bazë dhe objektivi i financimit të arsimit bazë janë rishikuar për të pasqyruar detyrimin ligjor të arsimit 9 vjeçar të detyrueshëm. Nga ana tjetër, objektivi i financimit të sistemit arsimor është formuluar që t'i përafrohet vendeve të reja anëtare të BE-së; kjo e bën objektivin më realist.

### *2. Niveli i synuar i treguesve është bërë më ambicioz*

Duke qenë se në pjesën dërrmuese synohen nivele maksimale të treguesve të frekuentimit dhe përfundimit të arsimit bazë, më ambicioze janë bërë sidomos treguesit e financimit të arsimit bazë.

### *3. Janë shtuar tregues të rinj*

Tregues të shtuar janë tregues të regjistrimit në arsimin parashkollor, tregues të regjistrimit bruto në arsimin bazë dhe tregues të cilësisë në arsim. Treguesit e shtuar të cilësisë në arsim janë tregues të statusit të cilësisë në arsim dhe jo tregues të standardit të shërbimit, të cilët edhe pse shumë të rëndësishëm duhet të ndiqen në nivel sektori. Sipas kësaj logjike janë evituar tregues të shtuar tregues të vlerësimit të jashtëm (nota e provimit të lirimimit dhe pikët sipas sistemit PISA).

### *4. Janë hequr tregues të papërshtatshëm*

Nisur nga lëvizjet dinamike migratore të viteve të fundit, treguesi i përqindjes së nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë klasën e fundit, nuk e pasqyron situatën si duhet. Për këtë arsye, ai është përjashtuar nga sistemi i monitorimit.

**OZHM 2: Sigurimi i arsimit bazë me cilësi të lartë për të gjithë**

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015, raporti 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli i synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
2.1. Të sigurohet frekuentimi përgjithshëm i arsimit bazë (9 vjeçar) deri në vitin 2015	2.1.1. Përqindja e regjistrimit të arsimit parashkollor nga 5-6 vjeçare	Total	Të dhëna admin, çdo vit	MASH/ INSTAT	%	100	49.6	70	
		F			%	100	48.8	70	
		M			%	100	50.2	70	
	2.1.2. Regjistrimi neto në arsimin bazë	Total	Të dhëna admin, çdo vit		%	100	89.3	96	
		F			%	100	89.9	96	
		M			%	100	89.1	96	
		R			%	100	nd	96	
		U			%	100	nd	96	
	2.1.3. Regjistrimi bruto në arsimin bazë	Total	Të dhëna admin, çdo vit		%	100	94.3	100	
		F			%	100	nd	100	
		M			%	100	nd	100	
		R			%	100	nd	100	
		U			%	100	nd	100	
	2.1.4. Përqindja e nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë klasën e fundit të ciklit ulët (1-5)	Total	Të dhëna admin, çdo vit		%	100	93 (07)	100	
		F			%	100	95 (07)	100	
		M			%	100	91 (07)	100	
		R			%	100	83 (07)	100	
		U			%	100	100 (07)	100	
	2.1.5. Pjesa e popullsisë në moshën 15-24 që di shkrim e këndim	Total	LSMS (HBS, DHS)		%	100	98.8	100	
		F			%	100	99.1	100	
M		%		100	98.5	100			
R		%		100	98.6	100			
U		%		100	99.1	100			
2.1.6. Vitet mesatare të shkollimit	Total	LSMS (HBS, DHS)	vite	>13.5	11.2	14			
	R		vite	np	nd	np			
	U		vite	np	nd	np			
2.1.7. Frekuentimi neto (net attendance)	Total	Të dhëna admin, çdo vit	%	100	92 (07)	np			
2.2. Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë në arsim për t'ju përafëruar vendeve të OECD-së	2.2.1. Nota mesatare e provimit të liritimit në gjuhë/letërsi	Total	Të dhëna admin, çdo vit	MASH		np	6.24 (07)	np	
	2.2.2. Nota mesatare e provimit të liritimit në matematikë	Total				np	nd	np	
	2.2.2. PISA	Total				np	nd	np	
2.3. rritja e financimit për arsimin bazë deri në nivelin e vendeve të reja anëtare të BE-së	2.3.1. Pjesa e buxhetit për arsimin bazë dhe parashkollor	Total	Të dhëna admin, çdo vit	MASH	%	np	58	52%	
	2.3.2. Pjesa e PBB-së për arsimin	Total	Të dhëna admin, çdo vit	MASH	%	np	3.5	5	
	2.3.3. Shpenzime publike për nxënës në arsimin bazë dhe parashkollor (Lek)	Total			lekë	np	42,000	72,000	
		Para-shkollor			lekë	np	30,000	50,400	
	Bazë	lekë	np	44,000	72,000				

Shënim: OECD=Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, PISA=Programme for International Student Assessment (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve), PBB=Prodheri i Brendshëm Bruto, F=Femra, M=Meshkuj, R=Rural, U=Urban, LSMS=Living Standards Measurement Survey (Vëzhgimi i Matjes së Nivelit të Jetesës), HBS=Household Budget Survey (Vëzhgimi i Buxhetit të Familjes), DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), INSTAT=Instituti i Statistikave, MASH=Ministria e Arsimit dhe Shkencës  
np=nuk është përcaktuar, nd=nuk disponohet,



### **OZHM 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje**

Përmirësimet për OZHM 3, mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. *Janë shtuar objektivat specifike*

Objektivat specifike të shtuara janë ato që kanë të bëjnë me eliminimin e dhunës në familje dhe eliminimin e dallimeve gjinore në punësim dhe në pagesë. Objektivat e përfshira në sistemin e monitorimit janë objektiva që synojnë të përmirësojnë situatën gjinore në Shqipëri. Ato janë objektiva që reflektojnë problematikën ekzistuese. Për këto arsye, ato konsiderohen si objektiva të rëndësishme të Strategjisë për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje.

2. *Janë shtuar tregues të rinj*

Treguesit e rinj masin progresin drejt pakësimit të dhunës me karakter gjinor dhe eliminimin e pabarazive gjinore në punësim dhe në pagesë

3. *Niveli i synuar i treguesve është ambicioz*

Niveli i treguesve të pritshëm për vitin 2015, për treguesit ekzistues dhe për ata të shtuar është mjaft ambicioz

Objektivat specifike janë riformuluar sipas propozimit të MPCSSH-B-së dhe UNIFEM-it, si dhe treguesit janë sistemuar për t'iu përgjigjur objektivave specifike të riformuluara.

**OZHM 3: Nxitja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendim marrje**

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015 ,raporti 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
3.1. Eliminimi i pabarazisë gjinore në arsimin bazë (arsimi 1-9 vjet) deri në vitin 2015	3.1.1. Raporti vajza/djem në arsimin bazë (9 vjeçar)	Total	MASH, çdo vit	MASH, INSTAT	%	1	0.92	1	MASH
		R			%	1	0.94	1	
		U			%	1	0.92	1	
	3.1.2. Raporti femra/meshkuj të moshës 15–24 vjeç që dinë shkrim e këndim	Total	LSMS (HBS, DHS)	INSTAT	nr	1	1	1	
		R			nr	1	0.9	1	
		U			nr	1	1.1	1	
3.2. Eliminimi i pabarazisë gjinore në organet e zgjedhura, pozicionet vendim-marrëse në qeverinë qendrore dhe lokale, dhe në pushtetin gjyqësor	3.2.1. Pjesa e vendeve në parlamentin shqiptar të mbajtura nga femrat	Total	Parlamenti, çdo 4 vjet	MPÇSHB INSTAT	%	30	7.1	30	
		Total			Të dhëna admin. çdo vit	%	30	14.2 dhe 25	30
	3.2.2. Pjesa e femrave ministre dhe zëvendësministre	Total	MB, çdo 4 vjet		%	30	0-16	30	
		Total			DAP, çdo vit	%	np	43	50
	3.2.3. Pjesa e femrave në organet e zgjedhura te pushtetit vendor	Total	MD, çdo vit		%	np	nd	np	
		Total			MD, çdo vit	%	np	nd	np
3.3. Pjesa e buxhetit e alokuar për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës kundër grave dhe fëmijëve rritet me 50% mes 2009 e 2015	3.3.1. Pjesa e buxhetit që alokohet për barazinë gjinore	Nivel qendror	MF çdo vit	%	np	nd	np		
		Nivel lokal		%	np	nd	np		
	3.3.2. Pjesa e buxhetit për parandalimin e dhunës me baze gjinore	Nivel qendror	MF çdo vit	%	np	nd	np		
		Nivel lokal		%	np	nd	np		
	3.3.3. Numri i rasteve të regjistruara të dhunës me bazë gjinore	Total	MB Vëzhgime INSTAT	Nr	np	nd	np		
		F		Nr	np	nd	np		
M		Nr		np	nd	np			
3.4. Eliminimi i pabarazisë gjinore në punësim duke reduktuar varësinë e grave nga punësimi informal, duke ngushtuar raportin gjinor të pagave dhe duke ngushtuar diskriminimin në punësim	3.4.1. Raporti femra/meshkuj në punësim	Total	LFS	INSTAT	Nr	np	0.72	np	
	3.4.2. Pjesa e femrave e punësuar në administratën publike	Total	Të dhëna admin	MPÇSHB	%	np	58	>50	
	3.4.3. Pjesa e femrave të punësuar me pagë në sektorin jo-bujqësor	Total	LFS	INSTAT	%	50	32	50	
	3.4.4. Raporti i diferencës në pagë së femrave ndaj meshkujve	Total	LFS	INSTAT	%	np	19.15	np	

Shënim:LFS=Labor Force Survey, INSTAT=Instituti i Statistikave, MPÇSHB=Ministria e Punës , Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta, MASH=Ministria e Arsimit dhe Shkencës, MB=Ministria e Brendshme, MF=Ministria e Financave, DAP=Departamenti i Administratës Publike, MD=Ministria e Drejtësisë np=nuk është përcaktuar, nd=nuk disponohet,

#### OZHM 4: Reduktimi i vdekshmërisë së fëmijëve

Sistemi i monitorimit për OZHM 4, mund të përmblihet si më poshtë:

#### OZHM 4: Reduktimi i vdekshmërisë së fëmijëve

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Synimi në raportin e 2004	Niveli i treguesit me 2008, ose në vitin me të afërt	Niveli i rishikuar i treguesit	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
4.1. Reduktimi i shkallës së vdekshmërisë së fëmijëve nën moshën pesëvjeçare në 10/1000, deri në 2015	4.1.1. Niveli i vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje të gjalla	Total	DHS, Të dhëna admin, çdo vit	INSTAT/MSH	Për mijë	10	11.1	10	MSH
	4.1.2. Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve nën pesë vjeç për 1000 fëmijë	Total			Për mijë	10	12.4	10	
	4.1.3. Vaksinimi kundër fruthit për fëmijët deri në 1 vit	Total			%	>95	>95	>95	

Shënim: DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), INSTAT=Instituti i Statistikave, MSH=Ministria e Shëndetësisë

Siç mund të vërehet nga të dhënat e pasqyrës, objektivi specifik, treguesit dhe nivelet e synuara për vitin 2015 janë afërsisht të njëjta me ato të sistemit ekzistues të monitorimit. Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve prej 10/1000 është mjaft ambicioz, duke patur parasysh që niveli aktual i vdekshmërisë prej 12/1000 është i nënraportuar.

## OZHM 5: Përmirësimi i shëndetit të nënës

Përmirësimet për OZHM 3, mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. *Janë riformuluar objektivat specifike ekzistuese*

Objektivi specifik i përmirësimit të shëndetit të nënës është riformuluar për të qenë më ambicioz dhe për të reflektuar aspiratën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE.

2. *Niveli i synuar i treguesve është bërë më ambicioz, ose më realist*

Niveli i synuar i treguesit të vdekshmërisë së nënës është zvogëluar në 8 për 100 mijë lindje të gjalla.

3. *Treguesit ekzistues janë disagreguar për në zona rurale e urbane*

Duke qenë se niveli i vdekshmërisë së nënës në zonat rurale tenton të jetë më i lartë se në zonat urbane, treguesi është dizagreguar në zona rurale e urbane.

## OZHM 5: Përmirësimi i shëndetit të nënës

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015 raporti 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
5.1. Reduktimi i vdekshmërisë së nënës në 8/100 mijë deri në vitin 2015	5.1.1. Përqindja e vdekshmërisë së nënës për 100 mijë lindje të gjalla	Total	DHS, të dhëna admin	INSTAT/MSH	për 100 mije	11	20.9	11	MSH
	5.1.2. Përqindja e vizitave mjekësore të kryera gjatë periudhës së shtatzënisë	Total			%	70	54.4	> 70	
	5.1.3. Përqindja e lindjeve të pritura nga personeli mjekësor i kualifikuar	Total			%	>98	>98	>99	

Shënim: R=Rural, U=Urban, DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), INSTAT=Instituti i Statistikave, MSH=Ministria e Shëndetësisë,

nd=nuk disponohet, np=nuk është përcaktuar

## OZHM 6: Luftimi i HIV/AIDS, dhe Tuberkulozit

Përmirësimet për OZHM 3, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### 1. Janë shtuar tregues të rinj dhe treguesit ekzistues janë disagreguar

Treguesit e shtuar synojnë të monitorojnë grupet me risk përfshirë gratë e reja shtatzëna dhe personat që marrin drogë. Nga ana tjetër, treguesi i numrit të personave të prekur nga HIV/AIDS është disagreguar sipas gjinisë dhe grupmoshës më të rrezikuar.

## OZHM 6: Luftimi i HIV/AIDS dhe Tuberkulozit

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Synimi në raportin e 2004	Niveli i treguesit me 2008, ose në vitin me të afërt	Niveli i rishikuar i treguesit	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
6.1. Deri në 2015, të ndalet dhe të fillojë përmbysja e trendit të përhapjes së virusit të HIV/AIDS	6.1.1. Numri i personave të prekur me HIV/AIDS	Total	DHS, të dhëna administrative	INSTAT/MSH	nr	np	350	np	MSH
		Femra			nr		107		
		Meshkuj			nr		243		
		Fëmije 0-5 vjeç			nr		12		
		6-14 vjeç			nr		5		
		15-19 vjeç			nr		4		
		mbi 19 vjeç			nr		329		
	6.1.2. Pjesa e grave shtatzëna të moshës 15-24 vjeç të infektuar me HIV	Total			%	np	nd	np	
	6.1.3. Pjesa e popullsisë me infeksion të avancuar të HIV dhe që marrin mjekim antiretroviral	Total			%	100	120 të rritur 15 fëmijë	100	
	6.1.4. Pjesa e popullsisë së moshës 15-24 me njohuri të plota e korrekte mbi HIV/AIDS	Total			%	100	nd	100	
6.1.5. Numri i personave që marrin drogë	Total	Nr	np	nd	np				
6.2. Të ndalet dhe të eliminohet vdekshmëria nga tuberkulozi	6.2.1. Norma e deklarimit të TBC <sup>2</sup>	Total	%	100	100	100			
	6.2.2. Pjesa e rasteve të TBC të zbuluara e kuruara nën trajtim observator direkt afat shkurtër (Mbulimi me DOTS)	Total	%	100	44.2 (2007)	100			
	6.2.3. Norma e vdekshmërisë nga TBC	Total	Për 100 mije	2.5	0.5 (2008)	<2.5			

Shënim: DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), INSTAT=Instituti i Statistikave, MSH=Ministria e Shëndetësisë, TBC=Tuberkulozi, nd=nuk disponohet, np=nuk është përcaktuar

## OZHM 7: Sigurimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Mjedisor

Përmirësimet për OZHM 7, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### 1. Janë shtuar tregues të rinj

Janë shtuar disa tregues që kanë të bëjnë me ndotjen e ajrit dhe burimet natyrore të rrezikuara. Treguesit janë zgjedhur të tillë që të monitorojnë politikat e qeverisë lidhur me mjedisin si dhe të jenë në pajtim me treguesit globalë të mjedisit.

### 2. Treguesit ekzistues janë disagreguar

Treguesit për ujin e pijshëm të garantuar dhe për sistemet e kanalizimeve janë disagreguar sipas zonave rurale dhe urbane.

### 3. Niveli i synuar i treguesve është bërë më ambicioz, ose më realist

Niveli i synuar i sipërfaqeve të mbrojtura si dhe niveli i synuar i pjesës së popullsisë që furnizohet me ujë të pastër është bërë më ambicioz. Ndërkaq, treguesit e furnizimit me ujë dhe aksesit në rrjetin e ujërave të zeza janë bërë më realistë.

Janë pasqyruar të dhënat e Ministrisë së Mjedisit në pasqyrën përkatëse

## OZHM 7: Sigurimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Mjedisor

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Disagregimi	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Synimi në raportin e 2004	Niveli i treguesit me 2008, ose në vitin me të afërt	Niveli i rishikuar i treguesit	Përgjegjësia institucionale
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
7.1. Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe përmbyjsja e trendit të humbjes së burimeve mjedisore	7.1.1. Sipërfaqja e tokës dhe ujërave të mbrojtura	Total	Çdo vit, Të dhëna Admin	MMPAU	%	11.4	11.42	14 (2014)	MMPAU
	7.1.2. Përqindja e sipërfaqes së mbuluar me pyje.	Total			000ha	1045	1040	1041.5	
	7.1.3. Emetimi i CO <sub>2</sub>	Total			000 ton	np	9200	13000	
	7.1.4. Konsumi i substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit	Total			ton	np	0	0	
	7.1.5. Pjesa e rezervave të peshkimit në kufij të sigurt biologjike	Total			ton	np	7132	39000	
	7.1.6. Pjesa e burimeve totale të ujit të përdorura	Total			%	np	nd	np	
	7.1.7. Numri i specieve të kërcënuara me zhdukje	Total			Nr	np	936	np	
7.2. Përmirësimi i statusit në furnizimin me ujin e pijshëm dhe kushtet sanitare për t'iu përafuar statusit të BE-së	7.2.1. Pjesa e popullsisë që deklaron se përdor ujë të sigurt	Total	LSMS, HBS	INSTAT	%	np	75	98	MPPTT
		R			%	np	82.1	98	
		U			%	np	69	90	
	7.2.2. Përqindja e popullsisë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve të shkarkimit të ujërave të zeza ose sistemet septike.	Total			%	np	86.3	90	
		U			%	np	98.6	100	

Shënim: PBB=Prodhimi i Brendshëm Bruto, R=Rural, U=Urban, DHS=Demographic Health Survey (Vëzhgimi i Shëndetit të Popullsisë), INSTAT=Instituti i Statistikave, MPPTT=Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit, HBS=Household Budget Survey, MMPAU=Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, np=nuk është përcaktuar, nd=nuk disponohet

## OZHM 8: Zhvillimi i Partneritetit Global për Zhvillim

Përmirësimet për OZHM 8, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### 1. Janë shtuar objektivat specifike

Është shtuar objektivi specifik 8.2. që ka të bëjë me aksesin në tregjet e vendeve të zhvilluara dhe me menaxhimin e borxhit

### 2. Janë riformuluar objektivat specifike ekzistuese

Objektivi i parë specifik është riformuluar për të theksuar krijimin e një partneriteti qeveri-donator për rritjen e efektivitetit të ndihmës. Nga ana tjetër, aksesin në teknologjinë e informimit dhe komunikimit (TIK) është transferuar prej OZHM 1 në OZHM 8, si dhe është riformuluar ai për të shprehur aspiratën e vendit për t'iu përafuar standardit evropian të aksesit në TIK.

### 3. Niveli i synuar i treguesve është bërë më ambicioz, ose më realist

Treguesi i aksesit në internet dhe treguesi i aksesit në telefoninë e lëvizshme janë bërë më ambiciozë, ndërsa treguesi i aksesit në telefoninë fikse është bërë më realist.

### 4. Janë shtuar tregues të rinj

Treguesit e objektivit specifik 8.1. janë tregues të rinj, të zgjedhur nga Deklarata e Parisit mbi efektivitetin e ndihmës, ndërsa treguesit e objektivit specifik 8.2. janë tregues të rinj të listës së treguesve globalë të OZHM-ve.

Sipas propozimit të Ministrisë së Financave është hequr treguesi 8.2.4. Lehtësimi i borxheve në iniciativat HIPC për shkak se Shqipëria nuk bën pjesë në vendet HIPC. Propozimi i METE-s dhe Ministrisë së Mbrojtjes për monitorimin e përvitshëm të treguesve 8.1.1. Ndihma e raportuar në buxhet, dhe 8.1.2. Përmirësimi i parashikueshmërisë së pagesës (in-year predictability) është të hiqen këta tregues për shkak të pamundësisë për t'iu mbledhur të dhënat. Raportet mbështetur në angazhimet e deklaratës së Parisit bëhen në çdo dy vjet nga DEBASKON e trajtojnë këtë informacion, por të dhënat janë të pamjaftueshme.

## OZHM 8: Zhvillimi i Partneritetit Global për Zhvillim

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015 raportit 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli i synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
8.1. Sigurimi i partneritetit me komunitetin e donatorëve për të rritur efektivitetin e ndihmës	8.1.1. Ndihma e raportuar në buxhet	Çdo dy vjet	DEBASKON	%	np	32 (07)	>85	DEBASKON
	8.1.2. Përmirësimi i parashikueshmërisë së pagesës (in-year predictability)			np	49(07)	>74		
	8.1.3. Planifikimi i bazuar tek metoda e programit			%	np	5 (07)	>66	
	8.1.4. Numri i strategjive sektoriale e ndërsektoriale që janë pajisur me tregues të rezultatit (outcomes) të matur në mënyrë sasiore	Çdo vit		%	np	15 (40%)	100	
	8.1.5. Pjesa e ODA bilaterale totale të vendeve donatore OECD/DAC që shkon për sektorët e shërbimeve sociale bazë (arsim bazë, kujdes shëndetësor parësor, ushqim, ujë të pijshëm e kanalizime)	Çdo vit		%	np	nd	np	
8.2. Përmirësimi i aksesit në tregjet e vendeve të zhvilluara për ta bërë borxhin e jashtëm të menaxhueshëm në periudhë afatgjatë	8.2.1. Pjesa e ODA e destinuar për rritjen e kapaciteteve tregtare të vendeve në zhvillim	MF, Çdo vit	MF	%	np	nd	np	MF
	8.2.2. Shërbimi i borxhit, në % të eksportit të mallrave e shërbimeve	MF, Çdo vit	MF	%	np	3.1	np	

8.3. Përmirësimi aksesit në TIK sipas standardit të vendeve të reja anëtare të BE-së	8.3.1. Numri i telefonave fikse për 100 banorë	Të dhëna admin, çdo vit	MPPTT/ AKSHI	%	58	10.29	20	MPPTT
	8.3.2. Numri i telefonave celularë për 100 banorë			%	78	95	110	
	8.3.3. Numri i përdoruesve të internetit për 100 banorë		MPPTT/ INSTAT	%	35	14.9 (06)	35	AKSHI

Shënim:BE=Bashkimi Evropian, ODA=Oficial Development Assistance (Asistenca Zyrtare për Zhvillim), OECD=Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, DAC, HIPC=Highly Indepted Poor Contry (Vend i Varfër me Nivel të Lartë Borxhi), TIK=Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, METE=Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, MF=Ministria e Financave, DEBASKON=Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, INSTAT=Instituti i Statistikave, MPPTT=Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit, AKSHI=Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit



## **OZHM 9: Përmirësimi i qeverisjes për gjithë qytetarët dhe veçanërisht për grupet në nevojë**

Përmirësimet për OZHM 9, mund të përmbliidhen si më poshtë:

### *1. Janë shtuar objektivat specifike*

Transparenca përmes përdorimit të potencialeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shihet si një mënyrë efikase për përmirësimin rrënjësor të qeverisjes. Në këtë kuadër është shtuar një objektivi i ri specifik, ai i *Implementimit të qeverisjes elektronike sipas standardeve evropiane*. Ky objektivi pritet të realizohet duke konsideruar të dy anët e “tregut”, ofertës, ose ofrimin e shërbimeve publike on-line, dhe kërkesës, ose përmirësimin e gatishmërisë së qytetarëve për të përdorur shërbimin e ofruar.

Qeverisja duhet të rezultojë në përmirësimin e aksesit në shërbime për gjithë qytetarët, e sidomos për grupet më në nevojë. Kontrolli i korrupsionit pritet të ndikojë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në përmirësimin e aksesit në shërbime për grupet shoqërore më në nevojë. Duke qenë se varfëria ka një “fytyrë” më shumë rurale, vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të qeverisjes në zonat rurale. Objektivi: *Garantimi i aksesit në shërbime dhe burime për grupet në nevojë sipas standardeve më të përparuara*, pritet të motivojë politika për përmirësimin e aksesit në shërbime për grupet më pak të favorizuara.

### *2. Janë shtuar tregues të rinj*

Treguesit e rinj të shtuar lidhen me objektivat e reja të shtuara të përshkruara më sipër. Përmirësimi i treguesve të shtuar (shih treguesit nga 9.2.1. në 9.3.8.), ose i treguesve të ashtuquajtur “tregues të nivelit të dytë”, pritet të ndikojë në përmirësimin e gjashtë treguesve standard të ndjekur nga Instituti i Bankës Botërore. Nga ana tjetër, duhet theksuar se treguesit e rinj janë tregues “të ndjeshëm” ndaj politikave afatshkurtëra të qeverisë dhe për këtë arsye, ata pritet të motivojnë politika aktive. Për më tepër, treguesit e shtuar janë si rregull pa kosto: ata ndiqen nga UNPAN (UN Public Administration Network), Transparency International dhe IFAD.

### *3. Janë përcaktuar synime ambicioze por realiste për objektivat dhe treguesit e shtuar*

Niveli i treguesve për frekuencën e korrupsionit është përcaktuar në nivelin e mesatares së vendeve të BE-së për vitin 2007, ndërsa synimet për aksesin në burime në zonat rurale janë përcaktuar bazuar në mesataren e 5 vendeve më të përparuara që kanë akses në fondet e IFAD.

## OZHM 9: Përmirësimi i qeverisjes për gjithë qytetarët dhe veçanërisht për grupet në nevojë

Objektivi specifik	Treguesi i rishikuar	Burimi dhe periodiciteti	Përgjegjësia institucionale	Njësia	Niveli i synuar për 2015 raporti 2004	Niveli i treguesit më 2008, ose në vitin më të afërt	Niveli i synuar i rishikuar i treguesit për 2015	Përgjegjësia institucionale
9.1. Qeverisja në Shqipëri përafrohet me standardet evropiane deri në vitin 2015	9.1.1. Pjesëmarrja dhe llogaridhënia	Çdo vit, WBI	WBI	Pikë	81	50.0	81	DEBASKON
	9.1.2. Stabiliteti politik			Pikë	71	34.6	71	
	9.1.3. Efektiviteti i qeverisjes			Pikë	76	43.1	76	
	9.1.4. Cilësia rregullatore			Pikë	83	55.8	83	
	9.1.5. Shteti Ligjor			Pikë	74	28.1	74	
	9.1.6. Kontrolli i korrupsionit			Pikë	73	36.7	73	
9.2. Implementimi i qeverisjes elektronike sipas standardeve evropiane	9.2.1. Disponibiliteti i shërbimeve elektronike on-line	Çdo vit	AKSHI	Nr	np	50% e 20 shërbimeve bazë ofrohen në nivelin 1 dhe 2	Niveli mesatar i vendeve të BE	AKSHI
	9.2.2. Indeksi i gatishmërisë së qeverisjes elektronike	Çdo vit	UNPAN	Nr renditja	np	0.467 (08), vendi 82	Renditje mesatare	
9.3. Garantimi i aksesit në shërbime dhe burime për gjithë qytetarët dhe sidomos për grupet në nevojë sipas standardeve më të përparuara	9.3.1. Frekuenca e korrupsionit në sistemin gjyqësor	Çdo vit	TI	pikë (1-5) 5: më keq	np	3.8	3.1	MD
	9.3.2. Frekuenca e korrupsionit në shërbimet shëndetësore			pikë	np	4.2	3.0	MSH
	9.3.3. Frekuenca e korrupsionit në polici			pikë	np	3.7	3.0	MB
	9.3.4. Frekuenca e korrupsionit në shërbimet e furnizimit me energji dhe ujë			pikë	np	3.7	2.6	MPPTT
	9.3.5. Aksesit në burimet e tokës	Çdo vit	IFAD	Pikë(1-6) 6: më mirë	np	4.4	5.0	MBUMK
	9.3.6. Aksesit në burimet e ujit			Pikë	np	3.9	4.6	
	9.3.7. Burimet publike për zhvillimin rural			Pikë	np	4.7	4.9	
	9.3.8. Llogaridhënia, transparenca dhe korrupsioni në zonat rurale			Pikë	np	4.2	4.4	

Shënim: WBI=World Bank Institute (Instituti i Bankës Botërore), DEBASKON=Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj, MD=Ministria e Drejtësisë, MB=Ministria e Brendshme, MSH=Ministria e Shëndetësisë, MBUMK=Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, IFAD=International Food and Agricultural Development, TI=Transparency International (Transparenca Ndërkombëtare), AKSHI=Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit

- 1 Treguesit 1.1.5;1.1.6;1.1.7 nuk mblidhen periodikisht nga Ministria e Shëndetësisë. Në lidhje me këto 3 tregues, MSH disponon të dhëna nga ADHS për vitet 2002 – 2007. Metodologjia e përdorur në këtë studim është e ndryshme nga ajo e përdorur në studime të mëparshme të kryera si LSMS, MICS.
- 2 Sipas të dhënave administrative të MSH, incidenca për 100 mijë banorë për vitin 2008 është 13.4 raste në total.



DEPARTAMENTI I BASHKËRENDIMIT  
TË STRATEGJIVE DHE KOORDINIMIT  
TË NDIHMËS SË HUAJ  
KËSHILLI I MINISTRAVE

Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr.1, Tirane

Tel: + 355 4 2277 357

Fax: + 355 4 2226 354

[koordinimi@km.gov.al](mailto:koordinimi@km.gov.al)

[www.dsd.gov.al](http://www.dsd.gov.al)

**skzhi** 

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim